FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 42

Tiranë – E enjte, 7 mars 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 20/2024, datë 22.2.2024	Për ratifikimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit.....	4661
Dekret i Presidentit nr. 90, datë 1.3.2024	Për shpallje ligji.....	4686
Dekret i Presidentit nr. 91, datë 4.3.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	4686
Dekret i Presidentit nr. 92, datë 4.3.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	4687
Dekret i Presidentit nr. 93, datë 4.3.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	4687
Dekret i Presidentit nr. 94, datë 4.3.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	4687
Dekret i Presidentit nr. 95, datë 4.3.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	4688
Dekret i Presidentit nr. 96, datë 4.3.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	4688
Dekret i Presidentit nr. 97, datë 4.3.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	4688
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 136, datë 6.3.2024	Për emërimin në detyrë të kryetarit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë.....	4689
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 4, datë 28.2.2024	Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2023–2024.....	4689

Udhëzim i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 64, datë 20.2.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 27.6.2022, "Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimdhënësve të kulturës profesionale në arsimin dhe formimin profesional".....	4690
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 42, datë 22.2.2024	Për përcaktimin e drejtorisë që duhet të përmbushë rolin e autoritetit menaxhues e të drejtuesit të autoritetit menaxhues, si dhe delegimi i të drejtave të nënshkrimit.....	4693
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 45, datë 28.2.2024	Për përcaktimin e Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin e Politikave (ONMP), të drejtuesit dhe përgjegjësisë së nënshkrimit për zbatimin përmes menaxhimit indirekt të programit vjetor IPA III.....	4694
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 46, datë 28.2.2024	Për përcaktimin e Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin e Politikave (ONMP), të drejtuesit dhe përgjegjësisë së nënshkrimit për zbatimin përmes menaxhimit indirekt të programit vjetor IPA III.....	4695
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 3120, datë 28.2.2024	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes me Italinë.....	4696
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 30.1.2024	Me objekt shfuqizimin e ligjit nr. 38/2021, datë 23.3.2021, "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë 'Bechtel International Inc.' për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës", si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Shfuqizimin e vendimit nr. 485, datë 30.7.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kontratës së fazës së parë 'Kontratë për shërbime teknike – projekti hidroenergjetik i Skavicës' ndërmjet KESH sh.a. dhe 'Bechtel Limited'", si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 38/2021, datë 23.3.2021, "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë 'Bechtel International Inc.', për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës" dhe të vendimit nr. 485, datë 30.7.2021, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kontratës së fazës së parë 'Kontratë për shërbime teknike – projekti hidroenergjetik i Skavicës' ndërmjet KESH sh.a. dhe 'Bechtel Limited'" derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi.....	4696
Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2023-2241 (312), datë 16.11.2023	Me objekt parashtrimin e qëndrimit për mosmarrëveshjen e kompetencës.....	4718

Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 5, datë 26.2.2024	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	4739
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 6, datë 26.2.2024	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	4807
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 256/5, datë 4.3.2024	Për disa shtresa dhe ndryshime në VKM-në nr. 535, datë 13.9.2023, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit 'Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura Himarë dhe largimi i ujërave të trajtuara në det për Itun Himarë'".....	4809

LIGJ
Nr. 20/2024

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE PËR FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E MIGRACIONIT

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokolli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 22.2.2024.

Shpallur me dekretin nr. 90, datë 1.3.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

PROTOKOLL
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE, PËR FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E MIGRACIONIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Italiane, në vijim të referuara si "Palët",

duke pasur parasysh Traktatin e Miqësisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Republikës Italiane dhe Republikës së Shqipërisë, nënshkruar në Romë, më 13 tetor 1995;

duke pasur parasysh protokollin ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës Italiane dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë, për forcimin e bashkëpunimit dypalësh në luftën kundër terrorizmit dhe trafikimit të qenieve njerëzore, nënshkruar në Tiranë, më 3 nëntor 2017;

duke marrë parasysh interesin e palëve për të nxitur një bashkëpunim në rritje dypalësh në të gjithë sektorët, edhe në atë të perspektives për anëtarësim të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian;

duke e konsideruar të nevojshëm intensifikimin e bashkëpunimit në menaxhimin e flukseve migratore dhe duke pasur parasysh afërsinë gjeografike dhe të përbashkëtat e interesave e të aspiratave ndërmjet palëve;

të ndërgjegjshëm për problematikat që sjell migracioni i paligjshëm;

duke pohuar respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe, në veçanti, ato në fushën e migracionit;

të bindur për aktet që duhen marrë për të parandaluar lëvizjet e parregullta migratore dhe trafikimin e qenieve njerëzore dhe, në të njëjtën kohë, sigurimin e mbrojtjen e të drejtave të njeriut;

kane rënë dakord, si më poshtë:

Neni 1

Në kuptim të këtij protokolli, me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

a) "Pala shqiptare", Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë;

b) "Pala italiane", Qeveria e Republikës Italiane;

c) "Zona", pronat e paluajtshme në pronësi të shtetit, të përcaktuara në aneksin 1, bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje;

ç) "Migrantë", shtetasit e vendeve të treta dhe ata pa shtetësi për të cilët duhet vërtetuar apo është vërtetuar ekzistenca e kushteve për hyrje, qëndrim ose banim në territorin e Republikës Italiane;

d) "Personel italian", personeli, edhe ai që nuk zotëron shtetësinë italiane, i dërguar nga pala italiane në Shqipëri për të garantuar realizimin e veprimtarive të parashikuara nga ky protokoll.

Neni 2

Ky protokoll ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit dypalësh ndërmjet palëve për menaxhimin e flukseve migratore nga vendet e treta, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe atë evropiane.

Neni 3

1. Pala shqiptare i njeh palës italiane të drejtën për përdorimin e zonave, sipas kushteve të përcaktuara në këtë protokoll.

2. Zonat jepen pa kundërshpërblim për të gjithë kohëzgjatjen e këtij protokolli, në përputhje me sa është parashikuar në nenin 13.

Neni 4

1. Pala italiane mund të krijojë në zonat e përcaktuara strukturat e përmendura në aneksin 1. Palët bien dakord se numri i përgjithshëm i migrantëve të pranishëm njëkohësisht në territorin shqiptar, në zbatim të këtij protokolli, nuk mund të jetë më i lartë se 3 000 (tri mijë) veta.

2. Strukturat e përmendura në pikën 1 menaxhohen nga autoritetet kompetente të palës italiane, sipas legjislacionit përkatës italian dhe evropian. Mosmarrëveshjet e lindura ndërmjet këtyre autoriteteve dhe subjekteve, që do të akomodohen në strukturat e sipërpërmendura, i nënshtrohen ekskluzivisht juridiksionit italian.

3. Autoritetet kompetente shqiptare lejojnë hyrjen dhe qëndrimin në territorin shqiptar të migrantëve të strehuar në strukturat e përmendura në pikën 1, me qëllimin e vetëm të kryerjes së procedurave kufitare apo të riatdhesimit, të parashikuara nga legjislacioni italian e evropian dhe për kohën rreptësisht të nevojshme për të.

Në rast se, për çdo arsye, e drejta e qëndrimit në struktura nuk gjen zbatim, pala italiane i transferon menjëherë migrantët nga territori shqiptar. Transferimet për dhe nga këto struktura janë përgjegjësi e autoriteteve kompetente italiane.

4. Hyrja e migrantëve në ujërat territoriale dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë do të kryhet ekskluzivisht me mjetet e autoriteteve kompetente italiane. Në momentin e mbërritjes në territorin shqiptar, autoritetet kompetente të secilës prej palëve do të vijojnë veçmas me përmbushjen e kritereve të parashikuara nga dispozitat ligjore kombëtare përkatëse, si edhe duke iu përmbajtur kushteve të këtij protokolli.

5. Shpenzimet për përshtatjen e një apo më shumë strukturave të hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të emigranteve do të mbulohen tërësisht nga pala italiane.

6. Lidhur me strukturat e parashikuara nga pika 1, pala italiane angazhohet të krijojë strukturat shëndetësore, me qëllim që të garantojë shërbimet shëndetësore të nevojshme.

7. Në rast konstatimi të migrantëve që janë mbartës të sëmundjeve infektive, autoritetet kompetente të palës italiane do t'u përmbahen normave të karantinimit dhe trajtimit të tyre, sipas protokolleve shëndetësore përkatëse.

8. Në rast nevojash shëndetësore, të cilat autoritetet italiane nuk mund t'i plotësojnë brenda kuadrit të strukturave të përmendura në pikën 1, autoritetet shqiptare do të bashkëpunojnë me autoritetet italiane përgjegjëse të këtyre strukturave për të siguruar kujdesin mjekësor thelbësor dhe të domosdoshëm ndaj personave të strehuar në këto struktura.

9. Kostot për shërbimet shëndetësore, që do të ofrohen nga pala shqiptare, do të paguhen nga pala italiane, në përputhje me pikën 1, të nenit 10, të këtij protokolli.

Neni 5

1. Strukturat e përmendura në aneksin 1 do të ndërtohen dhe do të menaxhohen, në përputhje me legjislacionin përkatës italian, pa pasur nevojë për leje ndërtimi apo formalitete të tjera të ngjashme, të kërkuara nga legjislacioni shqiptar. Pala italiane ka vetëm detyrimin për t'u njoftuar paraprakisht autoriteteve shqiptare projektin dhe dokumentacionin lidhur me qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e strukturave.

2. Pala italiane angazhohet të ndërtojë, gjithashtu, strukturat e dedikuara për personelin shqiptar, që do të ruajë perimetrin e jashtëm të zonave, në funksion të zbatimit të detyrimeve sipas pikës 2, të nenit 6, të këtij protokolli.

3. Pala shqiptare lehtëson ofrimin e shërbimeve të nevojshme për funksionimin e strukturave të përmendura në aneksin 1, për të cilat do të zbatohen kushte jo më pak të favorshme se ato që zbatohen për struktura të ngjashme. Kostot e nevojshme për

sigurimin e këtyre shërbimeve mbulohen tërësisht nga pala italiane.

4. Shpenzimet e bëra nga pala italiane për ndërtimin e strukturave të përmendura në aneksin 1 përjashtohen nga taksat dhe detyrimet doganore indirekte. Pala italiane nuk kërkon përjashtime nga taksat ose pagesat e tjera, pavarësisht se si janë të emërtuara, të cilat përfaqësojnë tarifa për përdorimin e shërbimeve publike.

5. Për nevojat e ndërtimit e të menaxhimit të strukturave të përmendura në nenin 4, autoritetet kompetente të palës italiane përjashtohen nga kufizimet ose kontrollet e monedhës dhe mund të transferojnë lirisht monedha, pavarësisht parashikimeve të dispozitave në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

6. Pala shqiptare angazhohet të lehtësoje kryerjen e praktikave doganore për materialet dhe pajisjet e kërkuara nga pala italiane, me qëllim realizimin e veprimtarive, sipas këtij protokolli.

Neni 6

1. Autoritetet kompetente të palëve do të bashkëpunojnë për ruajtjen e sigurisë së zonave.

2. Autoritetet kompetente të palës shqiptare sigurojnë ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike në perimetrin e jashtëm të zonave dhe gjatë transportit tokësor drejt dhe nga të njëjtat zona, që kryhet në territorin shqiptar.

3. Autoritetet kompetente të palës italiane sigurojnë ruajtjen e rendit dhe të sigurisë brenda zonave. Autoritetet kompetente të palës shqiptare mund të hyjnë në zonë, me pëlqimin e shprehur të drejtuesit të strukturës. Përjashtimisht, autoritetet e palës shqiptare mund të hyjnë, duke njoftuar drejtuesin e strukturës së palës italiane, në rast zjarri, rreziku tjetër serioz dhe të afërt që kërkon ndërhyrje të menjëhershme.

4. Për zbatimin e detyrave të ndërsjella që lidhen me sigurinë, secila palë ngre një njësi përgjegjëse për mbarëvajtjen, koordinimin dhe mbikëqyrjen e çështjeve të sigurisë.

5. Autoritetet kompetente italiane do të marrin masat e nevojshme për të siguruar qëndrimin e migrantëve brenda zonave, duke mos lejuar daljen e paautorizuar të tyre në pjesën tjetër të territorit të Republikës së Shqipërisë, si gjatë kohëzgjatjes së procedurave administrative, ashtu edhe në përfundim të tyre, cilido qoftë rezultati përfundimtar.

6. Në rast daljeje të paautorizuar të migrantëve nga zonat, autoritetet shqiptare do t'i shoqërojnë ata po pranë këtyre strukturave. Kostot që burojnë nga zbatimi i kësaj pikë do të mbulohen nga pala italiane, në përputhje me sa është parashikuar nga pika 1, e nenit 10, të këtij protokolli.

7. Autoritetet kompetente të palës italiane do të përballojnë çdo shpenzim të nevojshëm për akomodimin dhe trajtimin e subjekteve që do të strehohen në strukturat e përmendura në aneksin 1, duke përfshirë ushqimin, kujdesin shëndetësor (përfshirë rastet kur për këtë kërkohet asistenca e autoriteteve shqiptare) dhe çdo shërbim tjetër që do të vlerësohet i nevojshëm prej pallës italiane, duke u kujdesur që ky trajtim të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sipas së drejtës ndërkombëtare.

8. Dokumentet zyrtare të mbajtura në çfarëdolloj cilësie nga autoritetet italiane dhe nga personeli italian përjashtohen nga sekuestrimi ose masa të tjera të ngjashme nga autoritetet shqiptare.

Neni 7

1. Pala italiane njofton, paraprakisht, nëpërmjet kanaleve diplomatike, emrat e personelit italian.

2. Personeli italian, i cili hyn dhe qëndron në Shqipëri për qëllimet e përcaktuara në këtë protokoll, përjashtohet nga pajisja me viza, leja e qëndrimit dhe formalitetet e tjera të kërkuara nga legjislacioni shqiptar për migracionin. Personelit italian, i cili qëndron në territorin shqiptar për me shumë se 90 ditë, i lëshohet, pa pagesë dhe me një kërkesë të thjeshtë, një dokument identifikimi ("leje unike").

3. Kushtet e punës së stafit italian rregullohen ekskluzivisht nga legjislacioni italian.

Pagat e marra nga personeli italian përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat dhe kontributet për dhënien e asistencës sociale të parashikuar nga legjislacioni përkatës shqiptar, me përjashtim të rasteve kur personeli është shtetas shqiptar rezident në Republikën e Shqipërisë.

4. Për fjalët e thëna ose të shkruara dhe për veprimet e kryera në ushtrimin e funksioneve të tyre, personeli italian nuk i nënshtrohet juridiksionit shqiptar edhe pas përfundimit të ushtrimit të funksioneve të lartpërmendura në territorin

shqiptar. Komunikimet e personelit në fjalë me autoritetet kompetente italiane nuk u nënshtrohen kufizimeve nga autoritetet shqiptare.

5. Përjashtimisht nga sa është përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, personeli italian është përgjegjës, sipas legjislacionit shqiptar, nëse gjatë qëndrimit sipas këtij protokolli kryen jashtë shërbimit vepra penale të parashikuara nga legjislacioni shqiptar, që cenojnë të drejtat e shtetasve shqiptarë apo të shtetit shqiptar.

6. Pa cenuar pikën 4, personeli italian gëzon imunitet nga çdo formë ndalimi në Shqipëri, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 5, në të cilin çështja do të trajtohet sipas legjislacionit procedural penal shqiptar dhe marrëveshjeve dypalëshe në fuqi. Në rastet e parashikuara në pikën 5, për zbatimin e masave të sigurimit personal ndaj personelit italian, autoritetet shqiptare duhet të njoftojnë menjëherë autoritetet italiane.

7. Për trajtimet mjekësore urgjente, personeli italian mund të trajtohet në institucionet e kujdesit shëndetësor shqiptar. Shpenzimet e nevojshme për këtë trajtim do të përballohen nga vetë personi ose nga pala italiane, në përputhje me parashikimet e këtij protokolli.

8. Pa cenuar dispozitat e këtij neni, personeli italian ka detyrimin të respektojë ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe të mos ndërhyje në punët e saj të brendshme.

9. Pala italiane do t'u vendose në dispozicion autoriteteve shqiptare listën emërore të personave të autorizuar për të mbajtur armë gjatë ushtrimit të detyrës së bashku me dispozitat përkatëse të marrjes e të dorëzimit të armës nga këta persona.

10. Personeli i përmendur në pikën 9 nuk ka të drejtë të mbajë armë në territorin shqiptar jashtë shërbimit. Në kuptim të kësaj pike, shërbimi përfshin edhe shoqërimin e migrantëve nga dhe për në zona. Pala italiane angazhohet të marrë masa për garantimin e sigurisë për ruajtjen e armatimeve e të municioneve, të përdorura sipas këtij protokolli.

Neni 8

1. Hyrja në territorin shqiptar të mjeteve të palës italiane do të rregullohet me marrëveshje të tjera që do të lidhen ndërmjet autoriteteve kompetente italiane dhe shqiptare, të cilat do të hyjnë në fuqi në datën e nënshkrimit të tyre.

2. Procedura e transferimit të migrantëve për në territorin shqiptar, drejt dhe nga zonat do të kryhet në përputhje me sa është parashikuar në piken 1 të këtij neni.

3. Kostot e angazhimit të mjeteve dhe forcave pjesëmarrëse të palës shqiptare, që burojnë nga parashikimet e këtij protokolli, do të mbulohen nga pala italiane, në përputhje me sa është parashikuar në pikën 1, të nenit 10, të këtij protokolli.

Neni 9

1. Afati i qëndrimit të emigranteve në territorin e Republikës së Shqipërisë, në zbatim të këtij protokolli, nuk mund të jetë më i gjatë sesa periudha maksimale e lejuar nga legjislacioni përkatës italian. Autoritetet italiane, në përfundim të procedurave të kryera në përputhje me legjislacionin italian, do të kryejnë largimin e migrantëve nga territori shqiptar. Shpenzimet për këto procedura do të mbulohen tërësisht nga pala italiane, në përputhje me sa është parashikuar nga dispozitat e këtij protokolli.

2. Për të garantuar të drejtën për t'u mbrojtur, palët do të lejojnë hyrjen në strukturat e parashikuara nga ky protokoll të avokatëve, ndihmësve të tyre, si edhe të organizmave ndërkombëtarë dhe agjencive të Bashkimit Evropian që ofrojnë këshilla dhe asistencë për azilkërkuesit, në kufijtë e legjislacionit italian, evropian dhe shqiptar të zbatueshëm.

3. Në rast lindjeje dhe vdekjeje, migrantët do t'u nënshtrohen dispozitave të legjislacionit italian. Për rastet e vdekjeve, pala shqiptare do të vërë në dispozicion të palës italiane strukturat e morgut dhe pala italiane do të transferojë trupin nga territori shqiptar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga fakti i vdekjes.

Neni 10

1. Shpenzimet, sipas nenit 4, pika 9, nenit 6, pika 6, nenit 8, pika 3, dhe nenit 12, pika 2, si dhe shpenzimet e detyrimet e paparashikuara, që rrjedhin nga ky protokoll, do t'i rimbursohen palës shqiptare nga pala italiane *a forfait* në masën dhe mënyrat që do të përcaktohen nga aneksi 2.

2. Aneksi 2 rregullon, gjithashtu, kushtet dhe mënyrat sipas të cilave pala italiane do të marrë përsipër shpenzimet e kryera nga pala shqiptare, në rast të nisjes nga ana e migrantëve të procedurave

administrative pranë autoriteteve kompetente shqiptare.

Neni 11

1. Në përfundim të afatit të këtij protokolli, pala italiane i kthen palës shqiptare zonat, pa detyrim kundërshpërblimi për përmirësimet e kryera.

2. Pala italiane merr përsipër largimin nga territori shqiptar të të gjithë migrantëve, deri në përfundimin e afatit të këtij protokolli.

Neni 12

1. Secila palë do të dëmshpërblejë dëmet e shkaktuara palës tjetër në mënyrë të qëllimshme ose për faj të rëndë të personelit të saj dhe humbjet që rrjedhin nga çdo detyrim për të kompensuar palët e treta për dëmet e shkaktuara atyre nga sjellja e qëllimshme ose faji i rëndë i personelit të palës tjetër. Nuk do të konsiderohen të qëllimshme apo faj i rëndë mungesat në shërbim, që vijnë si pasojë e kapaciteteve objektive të kufizuara të palëve.

2. Në përputhje me sa është parashikuar nga neni 10, pala italiane angazhohet se do të mbulojë kostot për përfaqësimin ligjor, si dhe kostot procedurale dhe të dëmshpërblimit të dëmeve në rast padie që mund të ngrihet ndaj Republikës së Shqipërisë nga palë të treta, të cilat burojnë nga lidhja e këtij protokolli, përfshirë veprimet apo mosveprimet e palës italiane ndaj migrantëve, apo për shkak të veprimtarisë së autoriteteve italiane.

3. Në rastet e përmendura në këtë nën, palët do të nxisin diskutime në mirëbesim që synojnë arritjen e një zgjidhjeje të pranueshme në mënyrë të ndërsjellë.

Neni 13

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi në datën e bashkërenduar nga palët me anë të shkëmbimit të notave verbale.

2. Protokolli do të mbetet në fuqi për 5 vjet. Me përjashtim të rasteve kur njëra nga palët i komunikon me paralajmërim të paktën gjashtë muaj përpara afatit të përfundimit qëllimin e saj për të mos e rinovuar këtë protokoll, ky i fundit do të rinovohet në formë të heshtur për një periudhë tjetër 5-vjeçare.

3. Çdonjëra nga palët, në çdo moment mund të denoncojë këtë protokoll me njoftim paraprak me shkrim prej 6 (gjashtë) muajsh. Denoncimi përmban edhe shkaqet për të cilat duhet të informohet pala tjetër. Protokolli mund të denoncohet jo më parë se të ketë kaluar 1 vit nga hyrja e tij në fuqi.

Neni 14

Çdo kundërshti ndërmjet palëve lidhur me interpretimin apo zbatimin e këtij protokolli, si edhe të marrëveshjeve të tjera, që rrjedhin prej tij, do të zgjidhet në formë miqësore nëpërmjet konsultimit mes palëve.

Nënshkruar në Romë, më 6.11.2023, në dy origjinale, në gjuhën shqipe dhe italiane, ku të dyja tekstet janë njëlloj të vlefshme.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës të Republikës së Shqipërisë

Për Qeverinë e Republikës së Italisë

ANEKSI 1

A. Zona e destinuar për ngritjen e strukturave për procedurat e hyrjes

[HARTA ME IDENTIFIKIM TË ZONAVE]

B. Zona e destinuar për realizimin e strukturave për verifikimin e kushteve të njohjes së mbrojtjes ndërkombëtare dhe për riatdhesimin e migrantëve që nuk kanë të drejtë hyrjeje dhe qëndrimi në territorin italian.

[HARTA ME IDENTIFIKIM TË ZONAVE]


AREA POLIZIA DI STATO
PRESIDIO MEDICO E PER IL TRATTAMENTO ANTISCABBIA
SERVIZI IGIENICI
ATTESA
SERVIZIO VIGILANZA
LOCALI SERVIZIO GESTIONE
RICOVERO SALME
AREA TECNICA
ASSISTENZA IMMIGRATI
PERCORSO ACCESSO PRESIDIO MEDICO
PERCORSO TRATTAMENTO ANTISCABBIA
PERCORSO MIGRANTI
PERCORSO INGRESSO
PERCORSO USCITA VERSO CAMPO ACCOGLIENZA
PERCORSO USCITA VERSO CAMPO TRATTENIMENTO
PERCORSO MEZZI DI SOCCORSO
PERCORSO MEZZI DI SOCCORSO
RECINZIONE ESTERNA CON OFFENDICOLA H = 4 m
VERIFICATA A RIBALTAMENTO
New Jersey 1,40 x 2,50 x h 1,00 m
Pannello di rete metallica tipo frangivista h=3,00 m - L=2,00 m
Tavola Unica
Layout
SCALA 1:200
SCALA 1:10000
SCALA 1:500
Rruga e Portit
Porti Detar Shengjin
Shengjin
Durres
Tirana
ALBANIA
Vlore
Google


PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
Pjesor i Pronës nr.983 "Rep. Usht.nr.4010", Gjadër, Lezhë
(Sipërfaqja dhe objektet për dhënien në përdorim)
PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM (Forca Ajrore)
DATË 02/11/2023
QËLLIMI: Dhënie në Përdorim
VENDNDODHJA
Bashkia Lezhë
TE DHËNAT E PASURISË
Sip e pasurisë 77 700m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit 1936.9m²
Indeksi i Hartës K-34-76-(100-A)
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)
38 rrënojë
39
40 rrënojë
41
42
43
44
45
46
rrënojë
Tunel
LUMI DRINIT
RRUGA PER GJADER
6/1
11
Shpjeguese
Sip. pjesore e pronës (Truall+Ndërtim) që do të përdoret për pritjen dhe akomodimin e emigranteve në kuadër të marrveshjes ndërmjet Këshillit te Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikes së Italisë = 77700m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objekteve nr.38,39,40,41,42,43,44,45,46,47 = 1936.9m² (Objektet janë të rrënuara).
"Te zona ushtarake (sipërfaqja pjesore) që do t' i vendoset në dispozicion palës Italiane është përfshirë edhe sipërfaqja e nevojshme për strukturat e policisë së Shtetit".
SH 1: 2500
REALIZOI PËR IGJIU
Specialist Ramiz Haxhiu
Specialist Eris Ndrukaj
KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI MArch. Teuta KANXHERI
REALIZOI PËR ASHK
Specialisti
OVASHK
Nënshkrimi
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori
Nënshkrimi/ Vula
TEKNOLOGJIA E MATJEVE Ortofoto 2015
PËRCAKTIMI I KUFIRIT Sipas dokumentacionit hartografik arkivor.
Shënime: Ky plan rilevimi u hartua në zbatim të shkresës së Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura nr.7851/1, datë 01.11.2023, bazuar në dokumentacionin hartografik arkivor, ortofoto, azhornimit të kryer në terren. Sip. dhe objektet për dhënien në përdorim u përcaktuan në terren nga grupi i punës.
PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË MM (Forca Ajrore)
MIRATOHET
KOMANDANTI I FORCËS AJRORE
Gjeneral Brigade Ferdinant DIMO

ANEKSI 2
RREGULLIMI I RIMBURSIMEVE NGA PALA ITALIANE PËR PALËN SHQIPTARE

A. Fusha e veprimit

Ky aneks rregullon:

a) masën dhe mënyrën e rimbursimeve që pala italiane i detyrohet palës shqiptare, në zbatim të nenit 10 të protokollit;

b) masën dhe mënyrën e rimbursimit të çdo detyrimi të papritur që pala italiane i detyrohet palës shqiptare të përmendur në këtë aneks.

B. Krijimi i fondit për rimbursimin e shpenzimeve

1. Pala shqiptare krijon pranë thesarit të shtetit një llogari të veçantë jofitimprurëse, me emërtimin "Fondi për rimbursimin e shpenzimeve të kryera në zbatim të protokollit italo-shqiptar, në kuadër të forcimit e të bashkëpunimit për çështjet e migracionit". Brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të protokollit, pala shqiptare i komunikon palës italiane nëpërmjet kanaleve diplomatike të dhënat e plota të identifikimit të llogarisë së përmendur në këtë paragraf, si dhe mënyrat me të cilat evidentohen hyrjet dhe daljet në llogari, në kuadrin e kontabilitetit publik të Republikës së Shqipërisë.

2. Llogaria e përmendur në pikën 1 të këtij seksioni ndahet në nënllogari për secilën nga kategoritë e shpenzimeve të treguara në seksionet C dhe D, të kësaj shtojce. Shpërndarja e disponueshmërisë së llogarisë speciale të thesarit ndërmjet nënllogarive të ndryshme përcaktohet dhe ndryshohet nga pala shqiptare, në përputhje me nevojat e momentit dhe i komunikohet palës italiane nëpërmjet rrugëve diplomatike.

3. Çdo shpenzim më i ulët, që lidhet me një ose më shumë nënllogari, përdoret kryesisht për të kompensuar shpenzimet më të larta në nënllogaritë e tjera.

4. Brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të protokollit, pala italiane krediton shumën ***[16.5 milionë]*** euro në llogarinë e posaçme të thesarit të treguar në pikën 1 të këtij seksioni, si një paradhënie *a forfait* e rimbursimeve që duhen bërë, në përputhje me nenin 10 të protokollit për vitin e parë të zbatimit të protokollit.

5. Pala italiane mund të kryejë derdhjen në euro dhe konvertimin në lek me kursin e këmbimit në ditën e derdhjes.

6. Llogaria e veçantë e thesaritm sipas pikës 1 të këtij seksioni mund të përdoret vetëm për qëllimet e shprehura nga ky aneks. Disponibilitetet e kësaj llogarie janë të pasekuestrueshme.

C. Shpenzimet e rimbursueshme sipas nenit 10 të protokollit

1. Shpenzimet e rimbursueshme sipas nenit 10-të protokollit llogariten sipas metodave të parashikuara në këtë seksion.

2. Pala italiane rimburson palën shqiptare për kostot e parashikuara në pikën 9, të nenit 4, të protokollit në masën e treguar më poshtë:

a) 100% të shpenzimeve të kryera për ofrimin e shërbimeve të kujdesit spitalor, të ofruara realisht, në përputhje me manualin zyrtar të kostove të kujdesit shëndetësor, të parashikuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi. Pala shqiptare dokumenton administrimin faktik të trajtimeve spitalore për të cilat kërkon rimbursimin;

b) 100% të kostos së parashikuar në kontratat përkatëse të blerjes së pajisjeve mjekësore e të barnave, përfshirë, me kërkesë të palës italiane, vaksinat, për të cilat pala shqiptare dokumenton përdorimin efektiv për qëllimet e parashikuara nga protokolli. Kontratat e blerjes i vihen në dispozicion palës italiane sipas kërkesës së saj;

c) 100% të kostos së blerjes, të aprovuar më parë nga autoritetet italiane, të artikujve dhe shërbimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike, të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të parashikuara në ketë protokoll.

3. Në rastet e parashikuara në pikën 6, të nenit 6, të protokollit, pala italiane i rimburson palës shqiptare:

a) 100% të shpenzimeve të dokumentuara, që rrjedhin nga përdorimi i personelit të forcave policore nga blerja e karburantit për automjetet e shërbimit të përdorura dhe shpenzime të tjera që lidhen drejtpërdrejt me shoqërimin e migranteve;

b) 100% të shpenzimeve për blerjen, të aprovuar paraprakisht nga pala italiane, të automjeteve apo mjeteve të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të parashikuara nga ky protokoll.

4. Në rastet e parashikuara në pikën 3, të nenit 8, të protokollit, pala italiane i rimburson palën shqiptare 100% të shpenzimeve të dokumentuara të personelit të forcave të armatosura dhe të policisë për blerjen e karburantit për mjetet e shërbimit të përdorura dhe shpenzimet e tjera që lidhen

drejtpërdrejt me përdorimin e mjeteve dhe njësive të palës shqiptare.

5. Si një alternative për rimbursimin e kostove efektive në përputhje me pikat 3 dhe 4, pala italiane mund të zgjedhë rimbursimin e kostove të përcaktuara, në përputhje me VKM-në nr. 591, datë 7 shtator 2022, "Për miratimin e llojit të shërbimeve shtesë që ofron Policia e Shtetit dhe tarifave të pagesës për personat juridikë dhe fizikë, publikë apo privatë". Autoritetet kompetente të palëve, me marrëveshje të ndërsjellë, mund të bien dakord për metoda të ndryshme të llogaritjes fikse të shpenzimeve të përmendura në pikat 3 dhe 4, duke marrë, gjithashtu, parasysh ndryshimet e sistemit ligjor italian dhe të atij shqiptar.

6. Në rastet e parashikuara në pikën 2, të nenit 12, të protokollit, pala italiane i rimburson palës shqiptare 100% të shpenzimeve të kryera realisht nga kjo e fundit dhe që rrjedhin nga:

a) shpenzimet ligjore të dokumentuara;

b) shpenzime të dokumentuara që korrespondojnë me punësimin e personelit të punësuar nga organet apo entet shtetërore ose subjektet e Republikës së Shqipërisë, të punësuar për mbrojtjen e tij në gjykatë;

c) shpenzime të dokumentuara për pagesën e avokatëve të lirë të kontraktuar, me pëlqimin paraprak me shkrim të palës italiane nga pala shqiptare, të kufizuara në mbrojtjen para gjykatave ndërkombëtare;

ç) çdo shpenzim tjetër të përcaktuar si shpenzim gjyqësor në vendimin gjyqësor;

d) dëmshpërblimin e dëmeve, në bazë të vendimit të gjykatës kombëtare apo ndërkombëtare.

7. Kur, në rastet e përmendura në shkronjën "c", të pikës 6, të këtij seksioni, pala italiane merr përsipër drejtpërdrejt barrën e shpenzimeve të mbrojtjes në gjykatë, nuk kërkohet rimbursim për asnjë shpenzim shtesë të kryer nga pala shqiptare për pagesën e avokatëve të lirë të kontraktuar nga ajo.

8. Pala, që merr përsipër mbrojtjen në gjykatë për mosmarrëveshjet e shprehura në pikat 6 dhe 7, të këtij seksioni, siguron që veprimtaria procedurale të kryhet me kujdesin maksimal dhe zbaton të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar rrezikun e humbjes në gjykate. Pala tjetër siguron bashkë-punimin maksimal për mbrojtjen më të mirë në gjykatë. Mbrojtësit mbajnë kontakte të vazhdue-shme me të dyja palët dhe ndjekin udhëzi-met e tyre për mbrojtjen më të mirë në gjykatë.

D. Të paparashikuara dhe shpenzime të tjera

1. Pala italiane, gjithashtu, i rimburson palës shqiptare:

a) shpenzimet e dokumentuara që rrjedhin nga zbatimi i punimeve të urbanizimit dhe ofrimi i shërbimeve publike të nevojshme për funksionimin e strukturave të përmendura në aneksin 1 të protokollit, vetëm nëse ato janë të mbështetura drejtpërdrejt nga pala italiane ose nga subjekte të ngarkuara prej saj;

b) dëmshpërblimet që rrjedhin nga proceset gjyqësore, në të cilat Republika e Shqipërisë ose një nga institucionet e saj bëhet pa dashje palë për shkak ose si pasojë e zbatimit të protokollit;

c) shpenzimet që rrjedhin nga dëme të tjera të paparashikuara, që i rezultojnë palës shqiptare nga zbatimi i protokollit, që nuk rrjedhin nga sjellja e qëllimshme ose neglizhente e palës shqiptare dhe në atë masë që pala shqiptare nuk ka mundur të shmangë pasojat e dëmshme me përdorimin e kujdesit normal. Mangësitë e shërbimit që rezultojnë nga aftësitë e kufizuara objektive të palëve nuk konsiderohen të qëllimshme ose faj.

ç) çdo humbje në vlerë e pagesave të kryera nga pala italiane, në përputhje me seksionet B dhe E të këtij aneksi, që rezulton nga zhvlerësimi i kursit të këmbimit.

2. Me mënyrat e parashikuara në seksionin E, pala italiane rimburson shpenzimet e përmendura në pikën 1, të këtij seksioni.

E. Rifinancimi i fondit për rimbursimin e shpenzimeve

1. Brenda datës 15 mars dhe 15 shtator të secilit prej viteve të vlefshmërisë së protokollit, pala shqiptare i komunikon palës italiane nëpërmjet kanaleve diplomatike shumën e shpenzimeve të përmendura në seksionet C dhe D të kësaj shtojce, të kryera në gjashtëmujorin e mëparshëm.

2. Kërkesa për rimbursim shoqërohet me kopje të njësuar me origjinalin të faturave për shërbimet e kryera dhe dokumentacionin e kërkuar në seksionet C dhe D të këtij aneksi, që vërtetojnë shërbimin ose shpenzimin e kryer. Pala italiane mund të kërkojë sqarime dhe shtesa në dokumentacion.

3. Brenda 45 ditëve nga komunikimi i përmendur në pikën 1 të këtij seksioni, pala italiane do të paguajë, në mënyrën e parashikuar në seksionin B të këtij aneksi, shumën e kërkuar dhe të justifikuar nga pala shqiptare, edhe si paradhënie për shpenzimet që ajo do të kryejë në gjashtëmujorin në vijim. Pas kësaj derdhjeje, shuma e llogarisë speciale të thesarit nuk

mund të jetë më e vogël se 16.5 milionë euro. Në rast mosmarrëveshjeje për një pjesë të shumës së kërkuar nga pala shqiptare, pala italiane do të vazhdojë të paguajë pjesën e pakundërshtuar brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë.

4. Pala italiane do të zbresë nga pagesat e parashikuara në përputhje me këtë aneks shumat që korrespondojnë me dëmet e pësuara prej saj dhe që i atribuohen palës shqiptare, në përputhje me pikën 1, të nenit 12, të protokollit.

F. Fondi i garancisë

1. Për të siguruar rimbursimin e shpenzimeve të parashikuara në këtë aneks, që tejkalojnë pagesat e bëra nga pala italiane, në zbatim të seksioneve B dhe E, të këtij aneksi, pala italiane krijon një fond garancie në favor të palës shqiptare.

2. Brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e protokollit, pala italiane hap në një bankë të nivelit të dytë, që operon në Republikën e Shqipërisë, një llogari rrjedhëse bankare të dedikuar ekskluzivisht për depozitimin e burimeve që lidhen me fondin e garancisë. Pala italiane i jep palës shqiptare konfirmimin e depozitës dhe çdo ndryshim në detajet e llogarisë rrjedhëse, nëpërmjet kanaleve diplomatike. Shumat e depozituara në llogarinë e garancisë nuk mund të tërhiqen nga pala italiane pa pëlqimin me shkrim të palës shqiptare.

3. Interesat e përllogaritur në llogarinë rrjedhëse rrisin disponueshmërinë e fondit të garancisë. Shpenzimet për mbajtjen e llogarisë do të sigurohen me të njëjtën disponueshmëri.

4. Në rast të dështimit të kryerjes së pagesave nga pala italiane në bazë të këtij aneksi, pala shqiptare do t'i njoftojë palës italiane, nëpërmjet rrugëve diplomatike, ftesën për përmbushjen e detyrimit, duke specifikuar shumën dhe arsyet përkatëse. Nëse këto shuma janë objekt mosmarrëveshjesh të mëparshme nga pala italiane, pala shqiptare jep sqarimet e nevojshme.

5. Nëse palët nuk arrijnë një marrëveshje brenda 45 ditëve nga njoftimi i përmendur në pikën 4, të këtij seksioni, pala shqiptare mund të tërheqë nga fondi i garancisë së përmendur në këtë nen.

6. Burimet e tërhequra nga fondi i garancisë mund të kreditohen ekskluzivisht në llogarinë e posaçme të thesarit të njoftuar më parë nga pala shqiptare, në përputhje me seksionin B. Pas tërheqjes, pala shqiptare i dërgon palës italiane, nëpërmjet rrugëve diplomatike faturën e pagesës së kryer, e cila përbën kuitancën e shumave të detyrueshme për të gjitha qëllimet e parashikuara nga protokolli.

7. Pala italiane njofton bankën ku është depozituar fondi i garancisë, për dispozitat e këtij seksioni, të cilat mbizotërojnë mbi çdo dispozitë të ndryshme të kontratës ose të kushteve të shërbimit, të përcaktuara, të cilat rregullojnë llogarinë bankare në të cilën është depozituar fondi i garancisë.

8. Nga data e përfundimit të protokollit ose nga data e denoncimit të tij nga njëra prej palëve, pika 5 e këtij seksioni do të pushojë së zbatuari.

9. Në zbatim të pikës 1, të nenit 12, të protokollit, në rast të tërheqjes së shumave nga fondi i garancisë, në kundërshtim me këtë seksion, prezumohet faj i rëndë i palës së cilës i atribuohet shkelja, me kusht që të vërtetohet që është e qëllimshme.

G. Shlyerja përfundimtare e rimbursimeve

1. Duke filluar nga data e skadimit të protokollit ose e denoncimit të tij, seksioni E pushon se zbatuari. Brenda 60 ditëve nga datat e përmendura në pjesën e parë, pala shqiptare komunikon nëpërmjet kanaleve diplomatike deklaratën përfundimtare të shpenzimeve të rimbursueshme sipas këtij aneksi. Deklaratës i bashkëlidhen faturat për shërbimet e kryera dhe dokumentacioni që vërteton shërbimet dhe shpenzimet e kryera, në përputhje me seksionet C dhe D, të kësaj shtojce, të kufizuara në shpenzime të paraportuara më parë.

2. Nëse shuma e shpenzimeve të raportuara siç duhet nga pala shqiptare, në përputhje me këtë shtojcë, është më e madhe se shuma e pagesave të bëra nga pala italiane në thesarin shqiptar dhe tërheqjet nga fondi i garancisë të bëra nga pala shqiptare në përputhje me seksionin F të kësaj shtojce, pala italiane paguan rimbursimin e mbetur që i takon palës shqiptare, brenda 60 ditëve nga komunikimi i përmendur në pikën 1 të këtij seksioni.

3. Nëse shuma e shpenzimeve të raportuara saktësisht nga pala shqiptare, në përputhje me këtë shtojcë, është më e vogël se shuma e pagesave të bëra nga pala italiane në thesarin shqiptar dhe tërheqjet nga fondi i garancisë të bëra nga pala shqiptare, në përputhje me seksionin F, pala shqiptare do të paguaje në një llogari bankare të caktuar nga pala italiane shumën e marrë më tepër se shpenzimet e raportuara, brenda 60 ditëve nga kërkesa e palës italiane. Rimbursimi bëhet në euro. Për llogaritjen e shumes së detyrimit përdoret kursi i këmbimit në ditën e kërkesës nga pala italiane.

4. Mosdokumentimi i kërkesës për rimbursim brenda afateve dhe në mënyrën e parashikuar në këtë seksion sjell heqjen dore përfundimisht nga rimbursimi dhe detyrimin për kthimin e shumave të pallogaritura.

H. Dispozitat përfundimtare

1. Autoritetet kompetente të palëve mund të miratojnë, me marrëveshje të ndërsjellë, një ose më shumë manuale operacionale për zbatimin më të mirë të këtij seksioni.

2. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 13 të protokollit, ky aneks mund të ndryshohet me marrëveshja me shkrim të palëve.

PROTOCOLLO TRA IL CONSIGLIO DEI MINISTRI DELLA REPUBBLICA DI ALBANIA E IL GOVERNO DELLA REBUBBLICA ITALIANA PER IL RAFFORZAMENTO DELLA COLLABORAZIONE IN MATERIA MIGRATORIA

Il Consiglio dei Ministri della Repubblica di Albania e il Governo della Repubblica Italiana, di seguito indicate come "Parti"

Visto il Trattato di Amicizia e di Collaborazione tra la Repubblica Italiana e la Repubblica di Albania, fatto a Roma il 13 ottobre 1995;

Visto il Protocollo tra il Ministero dell'Interno della Repubblica Italiana e il Ministero dell'Interno della Repubblica di Albania per il rafforzamento della collaborazione bilaterale nel contrasto al terrorismo e alla tratta di esseri umani, firmato a Tirana il 3 novembre 2017;

Considerato l'interesse delle Parti a promuovere una crescente cooperazione bilaterale in tutti i settori, anche nella prospettiva dell'adesione della Repubblica di Albania all'Unione Europea;

Ritenuto necessario intensificare la collaborazione nell'ambito della gestione dei flussi migratori, anche in considerazione della vicinanza geografica e della comunanza di interessi e di aspirazioni tra le Parti;

Consapevoli delle problematiche che derivano dalla migrazione illecita;

In osservanza degli accordi internazionali nell'ambito della tutela dei diritti dell'uomo e, in particolare, nell'ambito della migrazione;

Certi delle azioni da intraprendere per la prevenzione dei flussi migratori illeciti e della tratta degli esseri umani e, nel contempo, per garantire la tutela dei diritti dell'uomo;

hanno convenuto quanto segue:

Articolo 1

1. Nell'ambito del presente Protocollo, con i termini seguenti si intende:

a) "Parte albanese": il Consiglio dei Ministri della Repubblica d'Albania;
b) "Parte italiana": il Governo della Repubblica Italiana;

c) "Aree": beni immobili di proprietà demaniale, individuati nell'Allegato 1 del presente Protocollo;
d) "migranti": cittadini di Paesi terzi e apolidi per i quali deve essere accertata la sussistenza o è stata accertata l'insussistenza dei requisiti per l'ingresso, il soggiorno o la residenza nel territorio della Repubblica Italiana;
e) "personale italiano": il personale, anche non in possesso della cittadinanza italiana, inviato dalla Parte italiana in Albania per assicurare lo svolgimento delle attività previste dal presente Protocollo.

Articolo 2

Il presente Protocollo è finalizzato a rafforzare la cooperazione bilaterale tra le Parti in materia di gestione dei flussi migratori provenienti da Paesi terzi, in conformità al diritto internazionale e a quella europeo.

Articolo 3

1. La Parte albanese riconosce alla Parte italiana il diritto all'utilizzo delle Aree, secondo i criteri stabiliti dal presente Protocollo.

2. Le Aree sono concesse a titolo gratuito per la durata del presente Protocollo conformemente all'articolo 13.

Articolo 4

1. La Parte italiana può realizzare nelle Aree le strutture indicate nell'Allegato 1. Le Parti concordano che il numero totale di migranti presenti contemporaneamente nel territorio albanese in applicazione del presente Protocollo non potrà essere superiore a 3.000 (tremila).

2. Le strutture di cui al paragrafo 1 sono gestite dalle competenti autorità della Parte italiana secondo la pertinente normativa italiana ed europea. Le controversie che possano nascere tra le suddette autorità e i migranti accolti nelle suddette strutture sono sottoposte esclusivamente alla giurisdizione italiana.

3. Le competenti autorità albanesi consentono l'ingresso e la permanenza nel territorio albanese dei migranti accolti nelle strutture di cui al paragrafo 1, al solo fine di effettuare le procedure di frontiera o di rimpatrio previste dalla normativa italiana ed europea e per il tempo strettamente necessario alle stesse. Nel caso in cui venga meno, per qualsiasi causa, il titolo della permanenza nelle strutture, la Parte italiana trasferisce

immediatamente i migranti fuori dal territorio albanese. I trasferimenti da e per le strutture medesime sono a cura delle competenti autorità italiane.

4. L'ingresso dei migranti in acque territoriali e nel territorio della Repubblica di Albania avviene esclusivamente con i mezzi delle competenti autorità italiane. All'arrivo nel territorio albanese, le autorità competenti di ciascuna delle Parti procedono separatamente agli adempimenti previsti dalla rispettiva normativa nazionale e nel rispetto del presente Protocollo.

5. Le spese per l'allestimento di una o più strutture d'ingresso nel territorio della Repubblica d'Albania dei migranti sono totalmente a carico della Parte italiana.

6. Nell'ambito delle strutture di cui al paragrafo 1 la Parte italiana istituisce le strutture sanitarie al fine di garantire i servizi sanitari necessari.

7. Quando è constatato che i migranti sono portatori di malattie infettive, le autorità competenti della Parte italiana osservano le norme della quarantena e del trattamento secondo i rispettivi protocolli sanitari.

8. In caso di esigenze sanitarie alle quali le autorità italiane non possono fare fronte nell'ambito delle strutture di cui al paragrafo 1, le autorità albanesi collaborano con le autorità italiane responsabili delle medesime strutture per assicurare le cure mediche indispensabili e indifferibili ai migranti ivi trattenuti.

9. I costi dei servizi sanitari offerti dalla Parte albanese sono a carico della Parte italiana conformemente all'articolo 10, paragrafo 1 del presente Protocollo.

Articolo 5

1. Le strutture di cui all'Allegato 1 sono realizzate e gestite nel rispetto della pertinente normativa italiana, senza necessità di permessi di costruire o altre formalità analoghe previste dalla normativa albanese. La Parte italiana ha solo l'obbligo di trasmettere alle autorità albanesi il progetto e la documentazione inerente alla sostenibilità e alla funzionalità delle strutture.

2. La Parte italiana realizza altresì le strutture dedicate al personale albanese addetto alla sicurezza del perimetro esterno delle Aree, in funzione dell'attuazione degli obblighi di cui all'articolo 6, paragrafo 2 del presente Protocollo.

3. La Parte albanese facilita l'erogazione dei servizi necessari all'esercizio delle strutture di cui all'Allegato 1, alle quali sono applicate condizioni non meno favorevoli di quelle praticate a strutture simili. I costi necessari all'erogazione di tali servizi sono interamente sostenuti dalla Parte italiana.

4. Le spese sostenute dalla Parte italiana per la realizzazione delle strutture di cui all'Allegato 1 sono esenti da imposte indirette e da dazi doganali. La Parte Italiana non chiede esenzioni da tasse o altri pagamenti comunque denominati che rappresentano corrispettivi per la fruizione di servizi pubblici.

5. Per le esigenze della realizzazione e della gestione delle strutture di cui all'articolo 4 le competenti autorità della Parte italiana sono esenti da restrizioni o controlli valutari e possono liberamente trasferire valute in deroga alle disposizioni vigenti nella Repubblica di Albania.

6. La Parte albanese facilita il sollecito disbrigo delle operazioni doganali relative a materiali e attrezzature richieste dalla Parte italiana per la realizzazione delle attività previste dal presente Protocollo.

Articolo 6

1. Le competenti autorità delle Parti collaborano ai fini del mantenimento della sicurezza delle Aree.

2. Le competenti autorità della Parte albanese assicurano il mantenimento dell'ordine e della sicurezza pubblica nel perimetro esterno alle Aree e durante i trasferimenti via terra, da e per le Aree, che si svolgono nel territorio albanese.

3. Le competenti autorità della Parte Italiana assicurano il mantenimento dell'ordine e della sicurezza all'interno delle Aree. Le competenti autorità della Parte albanese possono accedere nelle Aree, previo espresso consenso del responsabile della struttura stessa. In via eccezionale le autorità della Parte albanese possono accedere nelle strutture, informando il responsabile italiano della stessa, in caso di incendio o di altro grave e imminente pericolo che richiede un immediato intervento.

4. Con riferimento ai rispettivi obblighi relativi alla sicurezza, ognuna delle Parti istituisce un'unità responsabile del buon andamento, del coordinamento e della supervisione delle questioni di sicurezza.

5. Le competenti autorità italiane adottano le misure necessarie al fine di assicurare la permanenza dei migranti all'interno delle Aree, impedendo la loro uscita non autorizzata nel territorio della Repubblica d'Albania, sia durante il perfezionamento delle procedure amministrative che al termine delle stesse, indipendentemente dall'esito finale.

6. In caso di uscita non autorizzata dei migranti dalle Aree, le autorità albanesi li ricondurranno nelle stesse. I costi che derivano dall'attuazione del presente paragrafo, sono sostenuti della Parte italiana conformemente all'articolo 10, paragrafo 1 del presente Protocollo.

7. Le competenti autorità italiane sostengono ogni costo necessario all'alloggio e al trattamento delle persone accolte nelle strutture di cui all'Allegato 1, compreso il vitto, le cure mediche (anche nei casi che necessitano l'assistenza delle autorità albanesi) e qualsiasi altro servizio ritenuto necessario dalla Parte italiana, impegnandosi affinché tale trattamento rispetti i diritti e le libertà fondamentali dell'uomo, conformemente al diritto internazionale.

8. I documenti ufficiali detenuti a qualsiasi titolo dalle autorità italiane e dal personale italiano sono esenti da sequestro o altre misure analoghe da parte delle autorità albanesi.

Articolo 7

1. La Parte Italiana comunica previamente, per le vie diplomatiche, i nominativi del personale italiano.

a) marrëveshje mbi bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Koordinatorit Kombëtar të IPA-s, Zyrtarit Kombëtar të Autorizimit, Autoritetit Menaxhues, Organeve të Ndërmjetme për Menaxhimin e Politikave dhe Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar, për zbatimin përmes menaxhimit indirekt të veprimit të "BE për Shqipërinë" për vitin 2022, në lidhje me aktivitetin për hekurudhat, të financuar nga BE-ja në kuadër të IPA III;

b) rregulloret dhe udhëzuesit proceduriale të IPA III, për organet e ndërmjetme për menaxhimin e politikave;

c) çdo raport, dokument apo komunikim tjetër lidhur me zbatimin e veprimit "BE për Shqipërinë" të mbajtur me Koordinatorin Kombëtar të IPA-s, Zyrtarin Kombëtar Autorizues, Autoritetin Menaxhues, Autoritetin Auditues, organit kontabël, Zyrës Mbështetëse të ZKA-së, organin e ndërmjetëm për menaxhimin financiar dhe çdo komunikim tjetër të lidhur me përgjegjësitë funksionale të ONMP-ve të parashikuara në FFPA dhe VKM nr. 540, datë 20.9.2023.

3. Drejtoria e Konceptimit, Fizibilitetit të Projekteve dhe Statistikave në fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përmbushjen e përgjegjësive si ONMP, bashkëpunon me Sektorin e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit Hekurudhor.

4. Ngarkohet, zëvendësministri z. Ami Kozeli, Drejtoria e Konceptimit, Fizibilitetit të Projekteve dhe Statistikave në fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Sektori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit Hekurudhor, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

URDHËR
Nr. 46, datë 28.2.2024

PËR PËRCAKTIMIN E ORGANIT TË NDËRMJETËM PËR MENAXHIMIN E POLITIKAVE (ONMP), TË DREJTUESIT DHE PËRGJEGJËSISË SË NËNSHKRIMIT PËR ZBATIMIN PËRMES MENAXHIMIT INDIREKT TË PROGRAMIT VJETOR IPA III

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III), ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, të nenit 28, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në përputhje me vendimin nr. 540, datë 20.9.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësive dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021–2027 (IPA III)",

URDHËROJ:

1. Drejtoria e Konceptimit, Fizibilitetit të Projekteve dhe Statistikave në fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, caktohet për të përmbushur përgjegjësitë e Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin e Politikave (ONMP), për zbatimin përmes menaxhimit indirekt të veprimit të BE-së për Shqipërinë për vitin 2022, në lidhje me aktivitetin për konektivitetin digjital/broadband-in, të financuar nga BE-ja në kuadër të IPA III, në përputhje me parashikimet e FFPA dhe kuadrin ligjor për IPA III.

2. Zëvendësministri z. Ami Kozeli, drejton ONMP-në dhe autorizohet të nënshkruajë dokumentet e mëposhtme:

a) marrëveshje mbi bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Koordinatorit Kombëtar të IPA-s, Zyrtarit Kombëtar të Autorizimit, Autoritetit Menaxhues, Organeve të Ndërmjetme për Menaxhimin e Politikave dhe Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar për zbatimin përmes menaxhimit indirekt të veprimit të "BE për Shqipërinë" për vitin 2022, në lidhje me aktivitetin për konektivitetin digjital/broadband-in, të financuar nga BE-ja në kuadër të IPA III;

b) rregulloret dhe udhëzuesit procedurale të IPA III, për organet e ndërmjetme për menaxhimin e politikave;

c) çdo raport, dokument apo komunikim tjetër lidhur me zbatimin e veprimit "BE për Shqipërinë" të mbajtur me Koordinatorin Kombëtar të IPA-s, Zyrtarin Kombëtar Autorizues, Autoritetin Menaxhues, Autoritetin Auditues, organit kontabël, Zyrës Mbështetëse të ZKA-së, organin e ndërmjetëm për menaxhimin financiar dhe çdo komunikim tjetër të lidhur me përgjegjësitë funksionale të ONMP-ve të parashikuara në FFPA dhe VKM nr. 540, datë 20.9.2023.

3. Drejtoria e Konceptimit, Fizibilitetit të Projekteve dhe Statistikave në fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë në përmbushjen e përgjegjësive si ONMP, bashkëpunon me Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Telekomunikacioneve dhe Postave.

4. Ngarkohet, zëvendësministri z. Ami Kozeli, Drejtoria e Konceptimit, Fizibilitetit të Projekteve dhe Statistikave në fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Drejtoria e Politikave dhe

Strategjive të Zhvillimit të Telekomunikacioneve dhe Postave, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

NJOFTIM
Nr. 3120, datë 28.2.2024

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES ME ITALINË

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane për një hua të lehtësuar për programin "Përmirësimi i rrjetit shpërndarës të energjisë elektrike në veri të Shqipërisë si pasojë e tërmetit të 2019", nënshkruar më 27.3.2023, në Tiranë, ka hyrë më datë 3.10.2023.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I DREJTORISË SË TË DREJTËS
NDËRKOMBËTARE DHE TRAKTATEVE
Shpresa Peza

VENDIM
Nr. 3, datë 30.1.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare,
Marsida Xhaferllari	anëtare,
Fiona Papajorgji	anëtare,
Sonila Bejtja	anëtare,
Sandër Beci	anëtar,
Ilir Toska	anëtar,
Genti Ibrahimi	anëtar,
Marjana Semini	anëtare,
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Blerina Basha, në datat 12.12.2023 dhe 10.1.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 6 (Sh) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: SHOQATA "KUNDËRSHTIMI NDAJ DIGËS SË SKAVICËS", përfaqësuar nga avokatët Jordan Daci dhe Baftjar Rusi, me autorizim.

SHOQATA "PËR MBROJTJEN E PRONAVE DHE MJEDISIT TË PELLGUT TË DRINIT TË ZI", përfaqësuar nga avokatët Dorian Matlija dhe Vladimir Meçe, me autorizim.

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT, përfaqësuar nga drejtorja ekzekutive Erida Skëndaj dhe Julian Mërtiri, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Mimoza Arbi dhe Xhilda Pinci, me autorizim.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, Besjan Kadiu, Erald Elezi, Enea Karakaçi, Ermal Nufi dhe avokatja e shtetit Irma Qosja, me autorizim.

KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE, përfaqësuar nga Artan Çela dhe Jurgel Koçi, me autorizim.

SHOQËRIA "BECHTEL LIMITED", në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i ligjit nr. 38/2021, datë 23.3.2021 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë 'Bechtel International Inc.' për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës", si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Shfuqizimi i vendimit nr. 485, datë 30.7.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kontratës së fazës së parë 'Kontratë për shërbime teknike – projekti hidroenergjetik i Skavicës' ndërmjet KESH sh.a. dhe 'Bechtel Limited'", si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 38/2021, datë 23.3.2021 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë "Bechtel International Inc.", për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës" dhe të vendimit nr. 485, datë 30.7.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kontratës së fazës së parë 'Kontratë për shërbime teknike – projekti hidroenergjetik i Skavicës" ndërmjet KESH sh.a. dhe Bechtel Limited"' derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 7, 11, 17, 18, 38, pika 1, 41, 42, 46, 48, 49, pika 1, 56, 59, shkronjat "d" dhe "g", 82, pika 1, 131, shkronja "a" dhe 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 8 dhe 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)* dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 6 e vijues të Konventës së Kombeve të Bashkuara "Për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për çështje që lidhen me mjedisin" *(Konventa e Aarhusit)*, ratifikuar me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000; ligji nr. 9590, datë 27.7.2006 "Për ratifikimin e 'Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare"' *(ligji nr. 9590/2006)*; nenet 27 e vijues, 45, 47, 49, 50 e vijues dhe 76 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim pretendimet e shoqatës "Kundërshtimi ndaj Digës së Skavicës", shoqatës "Për mbrojtjen e pronave dhe mjedisit të pellgut të Drinit të Zi" dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit *(KSHH)*, që kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë *(Kuvendi)*, Këshillit të Ministrave dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare *(KESH)*, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e mendimit me shkrim të shoqërisë "Bechtel Limited", si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Më datë 23.3.2021, me propozim të Këshillit të Ministrave, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 38/2021 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë "Bechtel International Inc." për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës" *(ligji nr. 38/2021)*, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 62, datë 20.4.2021 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në këtë fletore. Qëllimi i tij është autorizimi dhe përcaktimi i procedurës së veçantë për negocimin, ekzekutimin dhe miratimin e kontratës me shoqërinë "Bechtel International Inc." *(shoqëria "Bechtel")* ose një filiali të saj për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës, bazuar në shprehjen e interesit paraprak të depozituar në ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë *(neni 1)*.

2. Sipas këtij ligji, kontrata për realizimin e këtij projekti ndahet në dy faza. Kontrata e fazës së parë përfshin aktivitetet paraprake të punës që do t'i mundësojnë shoqërisë "Bechtel" të paraqesë një propozim tek autoriteti kontraktues KESH-i për kontratën e fazës së dytë dhe të ndihmojë autoritetin kontraktues dhe Këshillin e Ministrave në sigurimin e mbështetjes financiare për projektin, ndërsa kontrata e fazës së dytë konsiston në projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës. Kontrata e fazës së parë përfshin realizimin e veprimtarive të tilla si: a) matje topografike dhe studime hidrologjike në mbështetje të zhvillimit të projektimit; b) studime dhe inspektime gjeoteknike në terren; c) zhvillim të strategjisë për realizimin e projektit; ç) rishikim dhe finalizim të vlerësimit të ndikimit mjedisor e social; d) përgatitje të projektit teknik, përfshirë përzgjedhjen e furnitorit të turbinave, me qëllim preventimin e kostove dhe të sasive; dh) shërbime të tjera të dakordësuara për të mundësuar ecurinë e zhvillimit të projektimit të hidrocentralit të Skavicës *(neni 2, pikat 1 dhe 2)*. Shpenzimet për kontratën e fazës së parë mbulohen nga KESH-i, i cili kryen oponencë për veprimtaritë e fazës së parë të paraqitura nga Bechtel-i vetë dhe/ose me anë të institucioneve përgjegjëse shqiptare *(neni 2, pika 3)*.

3. Ligji ka parashikuar, gjithashtu, procedurat për negocimin e kontratës, nënshkrimin dhe miratimin e saj, si dhe realizimin e projektit *(nenet 3, 4 dhe 5)*. Kështu, kontratat e të dyja fazave nënshkruhen nga KESH-i, ndërsa ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë mbikëqyr të gjithë procesin nga firmosja e marrëveshjes deri tek ekzekutimi i saj. Procedura e negocimit për finalizimin e kontratës së fazës së parë zhvillohet nga KESH-i, ndërsa ajo e negocimit për fazën e dytë të kontratës zhvillohet nga Komisioni i Negocimit, i krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave *(VKM)*, me përfaqësues të KESH-it, ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë dhe ministrive të tjera të linjës ose organeve të tjera, sipas përcaktimit

në këtë vendim, i cili negocion dhe dakordëson kushtet e kontratës me shoqërinë "Bechtel" për fazën e dytë lidhur me projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit.

4. Po sipas ligjit nr. 38/2021, data e hyrjes në fuqi të kontratës për fazën e parë të projektit është data e hyrjes në fuqi të VKM-së që e miraton atë, ndërsa zbatimi i saj fillon menjëherë pas hyrjes në fuqi. Produktet e fazës së parë miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për infrastrukturën dhe energjinë *(nenet 4 dhe 5, pika 1)*. Nëse palët nuk mund të finalizojnë kontratën e fazës së parë brenda afatit të caktuar ose afatit të zgjatur me dakordësi të përbashkët, negociatat për kontratën konsiderohen të mbyllura, pa asnjë kosto të shkaktuar ndërmjet palëve *(neni 2, pika 3)*.

5. Për sa i përket kontratës së fazës së dytë, anëtarët e Komisionit të Negocimit sigurojnë të gjitha pëlqimet dhe miratimet e brendshme nga ministritë e strukturat përkatëse përpara se drafti përfundimtar i negociuar i kontratës për projektim e ndërtim dhe raporti i negociatave t'i paraqiten autoritetit kontraktues për nënshkrim. Në rast se palët nuk mund të finalizojnë kontratën brenda periudhës së përcaktuar ose brenda periudhës së zgjatur me dakordësinë e përbashkët, Komisioni i Negocimit përgatit dhe paraqet te autoriteti kontraktues dhe ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë procesverbalin për ecurinë e negociatave dhe përfundimin e tyre *(neni 3, pika 6)*. Në rast të finalizimit të kontratës, brenda 10 ditësh pune nga nënshkrimi i saj, ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë përgatit dhe dërgon në Këshillin e Ministrave projektligjin për miratimin e saj. Kjo kontratë miratohet nga Kuvendi dhe hyn në fuqi datën e hyrjes në fuqi të ligjit miratues *(neni 4, pika 2)*. Pas miratimit të kontratës me Bechtel-in për projektimin dhe ndërtimin e HEC-it të Skavicës, ministri përgjegjës për infrastrukturën dhe energjinë krijon një njësi të veçantë për zbatimin e projektit, duke caktuar kryetar dhe anëtarë të njësisë së zbatimit të tij ekspertë inxhinierë, juristë dhe ekonomistë që ndjekin zbatimin e kontratës së bashku me KESH-in *(neni 5, pika 4)*.

6. Më datë 30.7.2021, në zbatim të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 38/2021, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 485 "Për miratimin e kontratës së fazës së parë 'Kontratë për shërbime teknike – projekti hidroenergjetik i Skavicës' ndërmjet KESH sh.a. dhe 'Bechtel Limited'" *(VKM nr. 485/2021)*, i cili është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 125, datë 6.8.2021 dhe ka hyrë në fuqi pas botimit të tij në këtë fletore.

7. Sipas shtojcës 1 të kontratës për shërbime teknike të miratuar me këtë VKM, projekti hidroenergjetik i Skavicës (HEC Skavica) do të ndërtohet në rrjedhën e sipërme të kaskadës së tri digave ekzistuese që janë në pronësi dhe shfrytëzim të KESH-it. Qëllimi i tij është ofrimi i prodhimit shtesë të energjisë elektrike, parandalimi i përmbytjeve në rrjedhën e poshtme dhe optimizimi i kaskadës, duke qenë diga kontrolluese. Një ndër detyrat gjatë vlerësimit paraprak, mbledhjes fillestare të të dhënave dhe finalizimit të rakordimit të objektit është edhe organizimi i takimeve me konsulentët vendas, agjencitë qeveritare, ministritë dhe grupet e interesit, si dhe asistimi në përgatitjen e dokumentacionit të disponueshëm. Detyra të tjera janë vlerësimi i thelluar i vendit të projektit; kryerja e punimeve studimore/rilevimeve; kryerja e inspektimeve dhe studimeve që mundësojnë projektimin, zbatimin dhe aktivitetet e vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social *(VNMS)*; përgatitja e VNMS-së; përgatitja, në përputhje me kodet dhe standardet shqiptare e ndërkombëtare, e konceptidesë së projektit; përgatitja e planit të zbatimit të projektit; zhvillimi i vendit të projektit përmes kryerjes së një vlerësimi të thelluar për përmirësimin e tokës, profilimin, drenazhimin dhe rregullimin e peizazhit; përgatitja e planit të implementimit dhe zbatimit; identifikimi, gjetja dhe sigurimi i mbështetjes financiare nga institucionet financiare që kanë shprehur interes për të mbështetur projektin; përgatitja e preventivit paraprak të sasive/kostove; përgatitja e progresraporteve mujore etj.

8. Po sipas VKM-së, KESH-i miraton dhe dërgon njoftimet me shkrim për të gjitha projektimet, skicimet dhe përshkrimet e detajuara të përgatitura nga palët e treta dhe të dorëzuara nga Bechtel-i, si dhe i jep Bechtel-it dokumentacionin ekzistues në kopje fizike për investigimet gjeoteknike, gjeologjike, hidraulike e hidrologjike, matjet topografike, studimin për matjen e sedimenteve, normat ditore të rrjedhjes në dalje të digave të tjera të Drinit, informacionin meteorologjik vendas dhe studime të tjera përkatëse që mbështesin kryerjen e shërbimeve. Po kështu, ai mbështet Bechtel-in, kur është e arsyeshme, për të

marrë të drejtat e aksesit të tokës për të gjitha studimet që do të ndërmerren për digën, rezervuarin e zarfin/et e linjës së transmetimit, si dhe në menaxhimin e bashkëveprimit me banorët dhe bashkitë, sipas kërkesës, e me informacionin për lidhjet e synuara me rrjetin e transmetimit. KESH-i rimburson dhe mban të padëmtuar Bechtel-in dhe grupin e tij në lidhje me të gjitha pretendimet, dëmet, detyrimet, humbjet dhe shpenzimet e pësuara ose të kryera nga Bechtel-i si rezultat i gabimeve dhe mangësive në specifikime. VKM-ja nr. 485/2021 parashikon, gjithashtu, totalin e kostos së kompensimit dhe rimbursimit që do t'i paguhet shoqërisë "Bechtel" në vlerën 16.047.000 euro (pa TVSH), si dhe detyrimin e KESH-it për pagesën e parë paradhënie në vlerën 3.000.000 euro, si kusht paraprak *(shih pjesën "Të ndryshme", si dhe shtojcën 2 të VKM-së nr. 485/2021, pjesët "Kompensimi" dhe "Plani i pagesë së parashikuar të etapave").*

9. Më datë 4.5.2023, KSHH-ja dhe shoqata "Për mbrojtjen e pronave dhe mjedisit të pellgut të Drinit të Zi" i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me kërkesë për shfuqizimin e ligjit nr. 38/2021, ndërsa më datë 5.5.2023 shoqata "Kundërshtimi ndaj digës së Skavicës" ka paraqitur kërkesë për shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr. 38/2021 dhe të VKM-së nr. 485/2021, si dhe pezullimin e zbatimit të tyre deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës. Kërkuesit kanë pretenduar se aktet e kundërshtuara cenojnë të drejta kushtetuese.

10. Më datë 6.6.2023 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjeve për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Me vendimet e datës 26.6.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur bashkimin e kërkesës së KSHH-së e shoqatës "Për mbrojtjen e pronave dhe mjedisit të pellgut të Drinit të Zi" me kërkesën e shoqatës "Kundërshtimi ndaj digës së Skavicës" *(kërkuesit*), si dhe kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

11. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur rrëzimin si të pabazuar të kërkesës së shoqatës "Kundërshtimi ndaj digës së Skavicës" për pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 38/2021 dhe VKM-së nr. 485/2021, për shkak se kërkuesja nuk ka arritur të provojë ardhjen e pasojave të rënda ose të pariparueshme, çka përbën edhe kriterin thelbësor për të vendosur pezullimin e zbatimit të tyre.[1]

12. Më datë 6.10.2023, shoqata "Për mbrojtjen e pronave dhe mjedisit të pellgut të Drinit të Zi" i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për marrjen e një opinioni këshillimor *amicus curiae* nga organizatat Fondacioni EuroNatur, CEE Bankwatch Network dhe RiverWatch, si dhe nga organet e Traktatit të Krijimit të Komunitetit të Energjisë. Me vendimin e datës 30.10.2023, në mbështetje të nenit 44/b të ligjit nr. 8577/2000, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur shqyrtimin e kësaj kërkese në seancë plenare publike, pas dëgjimit të palëve, ndërsa me vendimin e datës 12.12.2023, Gjykata ka vendosur rrëzimin e saj.[2]

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

13. ***Kërkuesit,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar:

Për pezullimin e zbatimit të akteve:

13.1 Sipas shoqatës "Kundërshtimi ndaj digës së Skavicës", në rastin konkret ekziston dëmi real dhe potencial, pasi aktet kanë filluar të zbatohen në praktikë dhe të sjellin pasoja.

Për juridiksionin e Gjykatës:

13.2 Ligji dhe VKM-ja përcaktojnë rregulla sjellje e pasoja për një numër të pakufizuar personash. Shtrirja në kohë, pasojat që sjell, numri i personave që preken dhe sipërfaqja e madhe e territorit ku vepron, e bëjnë VKM-në nr. 485/2021 një akt me karakter normativ.

Për legjitimimin:

13.3 Ata legjitimohen në kërkesën drejtuar Gjykatës, pasi janë regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi, kërkesa për shfuqizimin e akteve është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar nga neni 50, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000 dhe të drejtat e cenuara nga ligji nr. 38/2021 dhe VKM-ja nr. 485/2021, të garantuara nga Kushtetuta, KEDNJ-ja dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, përfshihen brenda veprimtarisë dhe misionit për të cilin janë krijuar. Po kështu, KSHH-

[1] Gjyqtaret Fiona Papajorgji dhe Sonila Bejtja u shprehën për shqyrtimin e kërkesës për pezullimin e akteve në seancë plenare.

[2] Gjyqtarja Marsida Xhaferllari mbajti qëndrimin se shqyrtimi i kërkesës për *amicus curiae* duhej të bëhej në këtë moment procedural, pas marrjes më parë të mendimit me shkrim nga subjektet e interesuara, për shkak të natyrës tepër specifike të pretendimeve të parashtruara, çka e bënte të nevojshme marrjen e mendimit të specializuar.

ja është legjitimuar edhe më parë nga kjo Gjykatë në lidhje me disa prej të drejtave që cenohen nga aktet e kundërshtuara, për rrjedhojë ata justifikojnë interesin e tyre të drejtpërdrejtë në çështje.

Për themelin e çështjes:

13.4 Ligji dhe VKM-ja cenojnë:

13.4.1 *Identitetin kombëtar,* në drejtim të:

13.4.1.1 *Trashëgimisë kombëtare, kulturës dhe traditës*, pasi në zonën që rrezikon të përmbytet ndodhen një sërë objektesh të trashëgimisë kulturore të përcaktuara si të mbrojtura, si dhe një sërë të tjerash që meritojnë mbrojtje. Fusha e Dibrës ka qenë historikisht hambar për rrethin e Dibrës, e njohur nga historia edhe si "Malet e Dibrës". Në luginën e mesme të Drinit të Zi, të lidhur nga ana territoriale me këtë rajon, janë evidentuar gjurmët më të hershme të qytetërimit neolitik në Shqipëri, të lidhura kronologjikisht me gjysmën e dytë të mijëvjeçarit VII përpara Krishtit. Fshatrat më të hershme neolitike të këtij rajoni janë Burimi, Cetushi, Kronëzat (Fushë-Alie), ku dy të fundit përfshihen brenda kuotave të përmbytjes, si rrjedhojë e ndërtimit të digës. Po kështu, në këtë luginë kalonte degëzimi verior i rrugës antike "Egnatia", i cili bashkonte dy tranversalet më të mëdha transballkanike, atë Egnatia në jug (Ohër) dhe atë Lissis-Naissus në veri (Kukës). Kulmi i historisë së kësaj zone është epoka e mesit të shekullit XV, e karakterizuar nga luftërat fitimtare të Skënderbeut. Me ndërtimin e digës, zona e përfshirë nga harta e liqenit të hidrocentralit të Skavicës do të përmbytet përgjithmonë, pa arritur të preket nga arkeologët një arkiv i vërtetë vlerash dhe artefaktesh arkeologjike. Ndërtimi i HEC-it të Skavicës rrezikon humbjen e kulturës, të qytetërimit mijëravjeçar, të vlerave historike, si dhe atyre materialo-shpirtërore të banorëve të zonës, të lidhura me tokën, shtëpinë, krahinën, këngët e vallet, veshjen, traditat, varret e të parëve, të shkuarën etj.

13.4.1.2 *Florës dhe faunës*, të cilat përbëjnë pasuri kombëtare. Projekti i hidrocentralit vë në rrezik zhdukjeje rrëqebullin ballkanik, ariun e murrmë dhe ujkun gri, të mbrojtur nga direktiva e Bashkimit Evropian për Habitatet, Lista e Kuqe Shqiptare për Florën dhe Faunën, si dhe Konventa Evropiane për Ruajtjen e Florës dhe Faunës së Egër dhe Mjedisit Natyror *(Konventa e Bernës)*. Po kështu, preken breshka e Hermann, thëllëza shkëmbore, turtullat, peshkatari euroaziatik, vidra euroaziatike, peshqit endemikë etj. Për sa i përket florës, ndërtimi i projektit do të përmbyste pyllin përgjatë lumit të Drinit të Zi, të përbërë nga alderi i zi, plepi i zi dhe shelgjet, si dhe pyjet me lis të bardhë në kodrat përreth lumit.

13.4.2 *Të drejtën e pronës private* dhe *shpërblimit të drejtë* të saj, pasi duke pasur parasysh çmimet e referencës për tokën dhe sendet e paluajtshme për zonën e Dibrës, si një ndër zonat më të varfra të Shqipërisë, vlera e shpronësimit për banorët e zonës që do të preken nga ndërtimi i hidrocentralit do të jetë shumë e vogël dhe nuk do të arrijë të mbulojë as 1/10-ën e asaj që humbet.

13.4.3 *Të drejtën për jetë private*, në drejtim të s*ë drejtës për të zgjedhur banimin, punën dhe profesionin*, të parashikuar nga nenet 38, pika 1 dhe 49, pika 1, të Kushtetutës. Ndërtimi i hidrocentralit rrezikon 41 fshatra, duke çuar në shpërnguljen e afërsisht 20 mijë banorëve, ndërkohë që ndikimi i tij shtrihet edhe ndaj 20-30 mijë të tjerëve që janë në emigracion ose jetojnë në rrethe të tjera, por vazhdojnë të jenë ende të lidhur me zonën. Personat që vazhdojnë të jetojnë në këtë zonë sigurojnë jetesën përmes bujqësisë, blegtorisë, pemëtarisë, bletarisë, peshkimit, mbledhjes së bimëve mjekësore etj. Shpërngulja e tyre me forcë për qëllime të ndërtimit të projektit i vendos në pamundësi të sigurimit të mjeteve të jetesës, për shkak të mungesës së njohurive të specializuara për të kryer punë të tjera.

13.4.4 *Të drejtën për t'u informuar për gjendjen e mjedisit*, të parashikuar nga neni 56 i Kushtetutës, Konventa e Aarhus-it, si dhe ligjet për njoftimin e konsultimin publik dhe mbrojtjen e mjedisit. Aktet e kundërshtuara janë miratuar pa transparencë, pa informim ose konsultim publik në lidhje me dobishmërinë e investimit, kufizimet eventuale të të drejtave e ndikimit të ligjit në to, avantazhet, disavantazhet dhe pasojat që ai sjell në ekonomi, shëndetin e popullatës etj., si dhe pa përfshirje të publikut në vendimmarrje. Po kështu, aktet janë miratuar pa u përgatitur raporti i VNMS-së së projektit për ndërtimin e HEC-it të Skavicës, i cili duhej të ishte gati për opinionet dhe komentet e publikut që në tremujorin e tretë të vitit 2022. Si anëtare e Traktatit të Komunitetit të Energjisë *(TKE)*, ndaj Shqipërisë janë iniciuar tri çështje në lidhje me mjedisin, në të cilat është evidentuar dështimi i saj për të përmbushur kërkesat ligjore dhe mjedisore të *acquis communautaire.*

13.4.5 *Të drejtën për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm*, të parashikuar nga neni 59,

pika 1, shkronja "d", i Kushtetutës dhe një sërë aktesh ligjore e nënligjore, pasi realizimi i projektit do të krijonte një mikroklimë të rajonit, të karakterizuar nga përmbajtja e lartë e lagështirës në ajër, shtim të fenomenit të mjegullës, impakt negativ i treguesve të rrezatimit dhe treguesve të tjerë meteorologjikë, rritje të nivelit të karbonit në ajër, si rrjedhojë e përmbytjes së pyjeve, çka do ta bënte jetën e banorëve në pellgun e Dibrës më pak të shëndetshme. E drejta për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm është njohur edhe nga rezoluta A/76/L.75, datë 28.7.2022 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

13.4.6 *Lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe konkurrencën e lirë në drejtim të sigurisë juridike dhe parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi:

13.4.6.1 Përjashtojnë nga konkurrimi subjekte të ndryshme publike ose private, në shkelje të *parimit të barazisë përpara ligjit*. Ligji dhe VKM-ja kanë ndërhyrë në një marrëdhënie kontraktore në cenim të konkurrencës së lirë, duke përjashtuar subjektet e tjera dhe duke favorizuar shoqërinë "Bechtel", cila, e përzgjedhur thjesht me shprehjen e interesit paraprak, pa konkurrim sipas ligjit, do të përzgjedhë kontraktorë të posaçëm për realizimin e këtyre detyrave. Aktet e kundërshtuara kanë shmangur zbatimin e ligjeve nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" *(ligji nr. 162/2020)* e nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" *(ligji nr. 125/2013)* dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre. Kompanisë kontraktuese i janë dhënë të drejta dhe avantazhe ekskluzive në planifikimin, hartimin, përzgjedhjen e zinxhirit të furnizimit dhe zbatimin e projektit publik, i cili në fazën e parë do të financohet nga fonde publike të gatshme, ndërsa në fazën e dytë përmes kredisë së siguruar nga institucionet ndërkombëtare, duke paguar në këtë mënyrë kontraktorin me fonde publike edhe për ndërtimin e veprës. KESH-i është kompani shtetërore me kapital 100% shtetëror, çka do të thotë se paratë për projektin do të dalin nga buxheti i shtetit. Memorandumi i bashkëpunimit ekonomik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për projektet dhe blerjet, i miratuar me VKM-në nr. 785, datë 7.10.2022, promovon transparencën dhe mosdiskriminimin. Sipas Regjistrit të Investimeve Strategjike, projekti i Skavicës nuk rezulton të ketë statusin e investimit strategjik. Ndërhyrja në këtë të drejtë ka cenuar edhe *parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve*.

13.4.6.2 Duke pasur parasysh energjinë elektrike të kontraktuar nga KESH-i dhe planprojektet e tij, prodhimi total i energjisë elektrike i parashikuar për vitin 2025 tejkalon ndjeshëm detyrimin që ai ka për përmbushjen e kërkesave të furnizimit me energji elektrike të parashikuar për vitin 2033, çka bën që projekti i Skavicës të jetë një projekt me karakter të pastër tregtar, jashtë kuadrit të detyrimeve ligjore të KESH-it.

13.4.6.3 Ndërtimi i hidrocentralit ishte parashikuar të kryhej përmes Bankës Western Balkans Investment Framework, me grant të dhënë prej saj, kontribut lokal dhe kredi të siguruar nga Instituti Financiar Ndërkombëtar. Ky projekt, i cili bazohej në praktikat më të mira evropiane, nuk përmbyste sipërfaqen e përcaktuar sipas projektit të ri dhe, në aspektin financiar, shteti nuk kishte asnjë arsye për ta anuluar atë. Situata energjetike në vend mund të rregullohej edhe përmes masave për minimizimin e humbjeve.

13.4.7 *Parimin e proporcionalitetit në ndërhyrjen në liritë dhe të drejtat e njeriut, si: identitetin dhe trashëgiminë kombëtare, liritë dhe të drejtat sociale e kulturore, të drejtën për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, të drejtën për një mjedis të shëndetshëm, barazinë përpara ligjit dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike*, pasi:

13.4.7.1 Këshilli i Ministrave dhe ligjvënësi nuk kanë arritur të përcaktojnë ekzistencën e interesit publik specifik që justifikon ndërhyrjen e posaçme me ligjin nr. 38/2021. Relacioni bashkëshoqërues i projektligjit nuk përmend asnjë arsye publike për ndërmarrjen e kësaj nisme, nevojat që e kanë diktuar atë apo mënyrën e rregullimit ose mjetin më të përshtatshëm për arritjen e qëllimit me sa më pak pasoja të dëmshme. Ndërtimi i hidrocentralit është justifikuar me nevojën për të siguruar burime të mjaftueshme të energjisë elektrike për nevojat e popullatës. Ky qëndrim nuk është i përligjur si në drejtim të orientimit të BE-së për sigurimin e burimeve alternative, ashtu edhe në drejtim të kostove e dëmeve që i shkaktohen natyrës, tokës, ajrit, shoqërisë ose eficiencës së ndërtimit të projektit. Nevojat e vendit mund të plotësohen përmes burimeve alternative të energjisë, si ajo diellore ose të erës, të cilat nuk kanë kosto shpronësimi. Duke pasur parasysh jetëgjatësinë e kufizuar prej 70-100 vjetësh të HEC-it, interesi i përkohshëm i prodhimit të energjisë elektrike duhej

të ishte vlerësuar në raport me periudhën që zona do të qëndrojë nën ujë.

13.4.7.2 Ligji nuk është paraprirë nga studime, analiza e vlerësime të mjaftueshme për të përcaktuar paraprakisht interesat që mund të preken nga zhvillimi i projektit, çka e bën të vështirë, në mos të pamundur, kthimin prapa, nëse gjatë zbatimit të tij verifikohen efekte negative. Hapësira që ai lejon për përfshirjen e publikut gjatë fazës së parë të kontratës është minimale, e vonuar, joefektive dhe pa ndikim në vendimmarrje. Ndonëse shoqëria "Bechtel" është në proces të përgatitjes së raportit të VNMS-së, ky vlerësim nuk përmbush garancitë e duhura ligjore të publikut të prekur dhe të atij të interesuar për mbrojtjen e mjedisit, pronave, trashëgimisë kulturore dhe aspekteve të tjera social-ekonomike.

13.4.7.3 Ligji nuk parashikon asnjë instrument ose mekanizëm për ndalimin e veprimeve të mëtejshme në zbatim të tij. Ndërkohë që në relacionin shoqërues të projektligjit pranohet se sektori i energjisë përbën interes kombëtar e thelbësor për vendin dhe se ndërtimi i projektit bazohet në shprehjen e interesit paraprak, ligji përzgjedh në mënyrë ekskluzive, pa procedura konkurruese, një subjekt të vetëm për realizimin e projektit, shoqërinë "Bechtel", duke i vënë në dispozicion fonde publike për realizimin vetë ose përmes palëve të treta të përzgjedhura nga ky subjekt të studimeve dhe vlerësimeve paraprake.

13.4.8 *Detyrimin për shoqërimin e projektligjit me raportin që përligj shpenzimet financiare*, të parashikuar nga neni 82, pika 1, i Kushtetutës. Ndonëse sipas relacionit të projektligjit zbatimi i projektit nuk shoqërohet me efekte financiare në buxhetin e shtetit, sipas VKM-së nr. 485/2021, rezulton se pagesa fillestare që paguhet që në kontratën e fazës së parë nga KESH-i për llogari të shoqërisë "Bechtel" është 3.000.000 euro. Po kështu, i gjithë hidrocentrali do të bëhet nga financimi i KESH-it, çka do të thotë se paratë për ndërtimin e tij do të dalin nga buxheti i shtetit.

13.4.9 Aktet e kundërshtuara shkelin *Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA),* të ratifikuar me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006, pasi nuk respektojnë parimet e lirisë ekonomike, konkurrencës së lirë dhe transparencës. Sipas MSA-së, shteti shqiptar duhet të ndjekë dhe konsolidojë mekanizmat ligjorë dhe institucionalë që kontratat publike t'i nënshtrohen konkurrencës së lirë dhe transparencës.

13.4.10 *TKE-në,* të ratifikuar me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006 *(ligji nr. 9501/2006)*, si dhe *acquis communautaire* të nxjerrë në kuadër tij, si, direktivat e Bashkimit Evropian 2001/42/EC "Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara" dhe direktivën 2011/92/EU të amenduar me direktivën 2014/52/EU 'Për vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen në mjedis nga projekte publike dhe private"'.

13.4.11 Ligji cenon nenet 101, 102 dhe 107 të *Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian (TFBE)* për sa i përket ndalimit të marrëveshjeve antikonkurruese, ndalimit të abuzimit me pozitën dominuese e ndalimit të ndihmës shtetërore të dhënë në kundërshtim me TFBE-në dhe TKE-në.

14. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar:

Për juridiksionin e Gjykatës:

14.1 Çështja nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, pasi lënda që i është referuar për të shqyrtuar nuk prek në vetvete probleme të kushtetutshmërisë, por të raportit që duhet të kenë në zbatim norma me fuqi juridike të njëjta. Kërkuesit kanë pretenduar se të drejtat e cenuara garantohen nga ligjet nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor", nr. 10440/2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" *(ligji nr. 10440/2011)*, nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" *(ligji nr. 146/2014)*, nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" *(ligji nr. 27/2018)*, nr. 162/2020 dhe nr. 125/2013, të cilat kanë të njëjtën fuqi juridike me ligjin objekt shqyrtimi.

14.2 VKM-ja nr. 485/2021 përbën akt me karakter individual-administrativ dhe jo akt normativ, për rrjedhojë nuk përfshihet në kuptimin e nenit 131, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës dhe për kundërshtimin e saj kërkuesit nuk rezulton t'i jenë drejtuar gjykatës administrative të shkallës së parë ose Gjykatës Administrative të Apelit.

14.3 Kërkuesit kanë ngritur pretendime për cenimin e nenit 59, pika 1, shkronja "g", të Kushtetutës, ndërkohë që neni 2 i kësaj dispozite parashikon se përmbushja e objektivave socialë nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt në gjykatë dhe se ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave. Ashtu siç Gjykata ka pranuar, përmbushja e objektivave socialë nuk përfshihet në rrethin e çështjeve që i përkasin juridiksionit kushtetues.

14.4 Pretendimet për *cenimin e së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit e mbrojtjen e tij dhe të të drejtave ekonomike e sociale* janë të natyrës ligjore dhe nuk përfshihen në juridiksionin e Gjykatës.

14.5 Referuar jurisprudencës kushtetuese, në kushtet kur Shqipëria nuk i ka përmbyllur ende procedurat për integrimin në Bashkimin Evropian, pretendimet e kërkuesve për mosrespektimin e detyrimeve të përcaktuara nga nenet 101, 102 dhe 107 të TFBE-së nuk përfshihen në juridiksionin e Gjykatës.

14.6 Çështja është e parakohshme dhe nuk mund të quhet ende mosmarrëveshje kushtetuese, pasi kontrata e fazës së parë ka të bëjë me fazën studimore dhe nuk çon në fillimin e punimeve për ndërtimin e digës së Skavicës. Kjo fazë ka të bëjë me kërkimin dhe hulumtimin e kushteve për vlerësimin nëse diga mund të ndërtohet ose jo, konkretisht të vlerësimeve mjedisore, sociale, ekonomike dhe përfshirjen e grupeve të interesit. Nisja e punimeve i përket kontratës së fazës së dytë, e cila, nëse në fund të fazës së parë vendoset për ndërtimin e digës, miratohet nga Kuvendi me ligj të posaçëm. Kërkuesit mund të kundërshtojnë ndërtimin e saj pikërisht në këtë fazë.

Për themelin e pretendimeve:

14.7 Pretendimet e kërkuesve për cenimin e *identitetit kombëtar* dhe *trashëgimisë kulturore* janë të pabazuara. Ligji nuk i referohet asnjë objekti pasuror ose jopasuror të shpallur "monument kulture" ose "pasuri kulturore materiale, ose jomateriale" nga institucionet e specializuara të fushës. Objekt i tij është përcaktimi i procedurave të veçanta për negocimin, ekzekutimin dhe miratimin e kontratës me shoqërinë "Bechtel" për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës, i cili nuk përfshihet në listën përfaqësuese të trashëgimisë kulturore materiale ose jomateriale. Kërkuesit nuk parashtrojnë asnjë arsye të qenësishme se përse ligji nr. 38/2021 cenon këto parime kushtetuese.

14.8 Aktet e kundërshtuara nuk mohojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptuar *të drejtën e pronës private dhe të drejtën për të zgjedhur vendbanimin e profesionin*, pasi i takon ligjvënësit të përcaktojë përdorimin e pronës në funksion të së mirës publike, duke garantuar sistemimin dhe shpronësimin sipas një shpërblimi të drejtë të subjekteve që mund të preken nga ndërtimi i digës. Po kështu, e drejta e zgjedhjes së vendbanimit dhe liria e lëvizjes nuk janë absolute. Ato mund të kufizohen në rastin e një interesi publik që ka të bëjë me zhvillimet energjetike të vendit.

14.9 Pretendimet për *cenimin e së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit e mbrojtjen e tij dhe të të drejtave ekonomike e sociale* nuk janë ngritur në nivel kushtetues, pasi:

14.9.1 Në asnjë ndër argumentet e parashtruara nuk arsyetohet lidhja mes parashikimeve të ligjit dhe cenimit të së drejtës së qytetarëve për t'u informuar për gjendjen e mjedisit. Ligji i kundërshtuar nuk ka si objekt procedurën e kryerjes së dëgjesave publike, por vetëm procedurën që lidhet ngushtësisht me marrëdhënien ndërmjet shtetit dhe operatorit që do të realizojë veprën. Mosparashikimi në ligj i detyrimit për realizimin e konsultimeve publike ose dëgjesave me qytetarët nuk përbën shkelje të këtyre parimeve, pasi ato rregullohen me ligje të tjera. Zbatimi i detyrimeve që burojnë nga këto ligje nuk përbën çështje kushtetutshmërie.

14.9.2 Kontrata e fazës së parë nuk çon në fillimin e punimeve për ndërtimin e digës së Skavicës, por në kërkimin dhe hulumtimin e kushteve për vlerësimin nëse diga mund të ndërtohet ose jo. Është pikërisht kjo fazë që parashikon konsultimin e publikut, përfshirjen e grupeve të interesit, si dhe njohjen me aktet, dokumentet, studimet dhe analizat, përfshirë edhe vlerësimin e ndikimit mjedisor, social dhe ekonomik. Raporti i VNMS-së është duke u përgatitur dhe diskutimet fillestare me palët e interesit, studimet që do të pasojnë dhe strategjia e propozuar për kompensimin dhe zhvendosjen do të përfshihen në draftraport, i cili do të ndahet me komunitetet e prekura për të marrë opinionet dhe komentet e tyre. Gjatë kësaj faze janë realizuar angazhime të ndryshme në nivel lokal dhe qendror, me qëllim grumbullimin e informacioneve. Marrja e opinioneve nga palët e interesit dhe publiku i gjerë do të realizohet edhe përmes dëgjesave të hapura publike, ku do të prezantohen ndikimet sociale dhe mjedisore të evidentuara, si dhe masat e propozuara për eliminimin, minimizimin dhe trajtimin e tyre. Opinionet e marra do të reflektohen më pas në raportin përfundimtar. Për rrjedhojë, pretendimet e parashtruara në këtë drejtim janë të pabazuara, pasi vetë ligji parashikon se faza e parë ka si qëllim vetëm mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe vlerësimin e të dhënave të nevojshme për qëllime të realizimit të projektit.

14.9.3 Edhe sipas jurisprudencës së huaj, përcaktimi i politikave më të mira energjetike i përket ekzekutivit dhe legjislativit. Në rastin konkret, këto organe do ta bëjnë këtë vlerësim në përfundim të kontratës së fazës së parë.

14.10 Pretendimet për cenimin e *lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe barazisë përpara ligjit* janë të pambështetura në parashikime kushtetuese.

14.10.1 Në rastin konkret nuk bëhet fjalë për prokurim publik ose kryerje të investimeve publike, por për një situatë ku shteti sillet si aktor privat në treg dhe kërkon partnerë për kryerjen e veprave publike. Në mënyrën se si është konceptuar ligji synon që e gjithë veprimtaria të rregullohet përmes parashikimeve të Kodit Civil, çka do të thotë se marrëdhënia që krijohet mes shtetit dhe palës private të interesuar është një marrëdhënie civile. Ngushtimi i rrethit të subjekteve që mund të aplikojnë dhe të shpallen potencialisht fitues në këtë procedurë është në përputhje me natyrën e projektit. Ligji merr përsipër të përcaktojë strukturën e kontratës dhe asnjë prej parashikimeve nuk ka të bëjë me përcaktimin e kritereve specifike mbi bazën e të cilave do të bëhet vlerësimi. Operatorët ekonomikë që nuk kanë kapacitetet e duhura nuk mund t'u nënshtrohen procedurave të kualifikimit dhe vlerësimit, ndaj ndërhyrja e bërë nga ligji është proporcionale dhe nuk cenon parimin e barazisë përpara ligjit.

14.10.2 Për sa u përket pretendimeve për anulimin e projektit të bazuar në praktikat e mira evropiane, ky element nuk gjen pasqyrim në ligjin nr. 38/2021, për rrjedhojë nuk mund të jetë objekt shqyrtimi në këtë gjykim.

14.10.3 Pretendimet se ligji bie në kundërshtim me ligjet nr. 162/2020, nr. 125/2013 dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre janë të pabazuara. Në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me një procedurë të prokurimit publik, ku organet publike kërkojnë operatorë në treg për ofrimin e shërbimeve, duke bërë pagesën përkatëse. Parashikimi i strukturës së kontratës të ndarë në dy faza është zgjedhur pikërisht për shkak të pamundësisë financiare të shtetit për ndërtimin e hidrocentralit. Pavarësisht se në këtë procedurë nuk gjen zbatim ligji për prokurimin publik, kjo nuk e shmang administratën nga detyrimi për respektimin e procesit të rregullt ligjor, bazuar në kritere të matshme të konkurrimit dhe zhvillimit të procedurës administrative. Nga ana tjetër, ligji nr. 125/2013 nuk mund të ngatërrohet me ligjin objekt shqyrtimi. Partneriteti Publik-Privat *(PPP)* konsiston në marrëdhënien që krijohet në kushtet e këmbimit të investimit të privatit me të drejtën që i jep shteti për shfrytëzimin e veprës publike të përfituar nga ky investim. Në rastin konkret, propozimi nuk konsiston në shfrytëzimin e veprës publike, pasi kjo vepër i takon fazës së dytë të kontratës që do të miratohet me ligj dhe do të vazhdojë të jetë tërësisht në shfrytëzim të subjektit publik, KESH-it. Për rrjedhojë, ligjet e posaçme që rregullojnë prokurimin publik ose partneritetin publik privat nuk mund të përdoren në rastin konkret.

14.10.4 Në lidhje me pretendimet se kompanisë kontraktore i janë dhënë të drejta ekskluzive, neni 15.2. i VKM-së nr. 485/2021 parashikon se shoqëria "Bechtel" nuk mund të nënkontraktojë shërbimet pa marrë miratimin paraprak të klientit.

14.11 Në lidhje me *parimin e sigurisë juridike*, kërkuesit nuk kanë parashtruar argumente për paqartësinë ose pakuptueshmërinë e dispozitave të ligjit objekt shqyrtimi.

14.12 Pretendimet për cenimin e *parimit të proporcionalitetit* janë të pambështetura, pasi:

14.12.1 Ndërhyrja në të drejtat e pretenduara është bërë me ligj dhe për interes publik kombëtar në sektorin e energjisë. Ndërtimi i HEC-it të Skavicës do të luajë rolin e një rregullatori për hidrocentralet ekzistuese, do të rrisë prodhimin vendas të energjisë elektrike, do të optimizojë kapacitetet prodhuese të hidrocentraleve ekzistuese, do të minimizojë përmbytjet në fushën e Nënshkodrës, duke u dhënë fund dëmeve të shkaktuara nga derdhjet e ujit, si dhe do të krijojë vende pune e mundësi ekonomike për komunitetet vendase. Kërkuesit nuk kanë identifikuar vlerat kushtetuese ose liritë personale të prekura nga veprimtaria legjislative ose ekzekutive.

14.12.2 Pretendimi se nuk ka asnjë mjet për të kundërshtuar raportin e VNMS-së është haptazi i pabazuar, pasi ai mund të kundërshtohet gjatë diskutimeve me grupet e interesit ose përmes gjykatave administrative, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar, duke qenë se veprimtaria e shoqërisë "Bechtel" bazohet në një kontratë administrative, çka i përket së drejtës publike.

14.13 Pretendimet se ligji bie në kundërshtim me *nenin 82, pika 1, të Kushtetutës* nuk gjejnë mbështetje në parimet kushtetuese, pasi kjo dispozitë kushtetuese përcakton detyrimin për paraqitjen e raportit që përligj shpenzimet financiare në rastet kur projektligji ndërhyn në financat publike. Komisioni i Kuvendit për Ekonominë dhe Financat ka vlerësuar se ligji konkret nuk sjell efekte financiare në buxhetin e shtetit.

14.14 Argumentet e ngritura për pretendimin se ligji bie në kundërshtim me parashikimet e *MSA-së* janë të pabazuara, pasi:

14.14.1 Neni 71/1 i ligjit ratifikues përcakton shprehimisht lidhjen e marrëveshjes ndërmjet ndërmarrjeve. Në rastin konkret, nuk ekziston një marrëveshje e tillë dhe nuk rezulton të ketë vendimmarrje të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, të krijuar me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore" *(ligji nr. 9374/2005)* si organ që kontrollon dhënien e ndihmës shtetërore, ku të jetë konstatuar se ndihma e dhënë është e paligjshme ose të jetë pezulluar dhënia e saj, duke urdhëruar kthimin e shumave të marra nga përfituesi. Nga ana tjetër, Gjykata ka pranuar se përjashtimi nga rregullat e konkurrencës nuk përbën cenim të lirisë së veprimtarisë ekonomike, ndërsa sipas Gjykatës Evropiane të Drejtësisë *(GJED)* neni 90/2 i TFBE-së u lejon shteteve që sipërmarrjeve që u akordojnë realizimin e shërbimeve të interesit të përgjithshëm ekonomik, t'u akordojnë të drejta ekskluzive.

14.14.2 Ligji nuk plotëson kriteret kumulative të dhënies së ndihmës nga shteti dhe nga burimet shtetërore, dhënies së një avantazhi ekonomik marrësit, selektivitetit dhe prekjes së tregut e konkurrencës për shkak të kësaj ndihme. Për të pasur transferim të burimeve shtetërore, masa në fjalë duhet të ketë impakt në buxhetin e autoritetit publik që e jep atë. Sipas testit të "investitorit privat" të zhvilluar nga GJED-ja, kur i japin avantazh një kompanie, autoritetet publike duhet të sillen ashtu siç sillet një investitor privat. Kjo gjykatë dhe Komisioni Evropian kanë sqaruar se autoritetet publike mund të përdorin zhvillimin e konkurrencës edhe për shitjen e pronave publike. Ndihma konsiderohet e paligjshme kur çrregullon konkurrencën dhe tregun, duke i dhënë një kompanie një avantazh që nuk do ta merrte në kushte normale tregu. Në rastin konkret nuk provohet asnjë çrregullim aktual ose potencial i tregut. Ndihma shtetërore nuk është prezente kur tregu preket vetëm në nivel lokal. Për sa kohë nuk ka transferim të burimeve shtetërore te një kompani private ose dhënie të pronës publike me çmime dhe kushte favorizuese, nuk ka elemente të ndihmës shtetërore të paligjshme.

14.15 Kërkuesit nuk kanë paraqitur fakte dhe argumente të nivelit kushtetues që përligjin kërkimet për mosrespektimin e angazhimeve të ndërmarra në kuadër të TKE-së. Pretendimet se ligji nuk ka respektuar direktivat e Parlamentit Evropian janë të pabazuara. Direktivat 2001/42/EC, 2011/92/EU të rishikuara me direktivën 204/52/EU dhe atë 2004/35/CE synojnë sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe parashikojnë përgjegjësinë e kompanisë për dëmet mjedisore të shkaktuara, si dhe marrjen e masave të nevojshme parandaluese e korrigjuese dhe mbulimin e shpenzimeve.

15. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka parashtruar të njëjtat argumente si Kuvendi në lidhje me juridiksionin e Gjykatës për sa i përket mungesës së lëndës kushtetuese dhe pretendimeve të kërkuesve për cenimin e nenit 59, pika 1, shkronja "g", të Kushtetutës, për cenimin e së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit e mbrojtjen e tij, për cenimin e të drejtave ekonomike e sociale, si dhe për VKM-në nr. 485/2021.

Për legjitimimin e kërkuesve:

15.1 Sipas Këshillit të Ministrave, kërkuesit nuk legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës, pasi nuk kanë arritur të provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin janë krijuar ose veprimtarisë që kryejnë dhe pasojave që rrjedhin nga ligji që kërkojnë të shpallet si antikushtetues. Interesi i tyre nuk është argumentuar. Ai nuk plotëson kërkesat për të qenë i sigurt, i drejtpërdrejtë e vetjak dhe nuk lidhet me fushën e veprimtarisë që ushtrojnë. Fakti që veprimtaria e shoqatës "Kundërshtimi ndaj digës së Skavicës" synon ndalimin e ndërtimit të një vepre publike nuk është i mjaftueshëm për ta legjitimuar atë në Gjykatë, ndërsa fakti se një subjekt i kushtëzuar është legjitimuar në procese të tjera përpara Gjykatës nuk përbën argument për legjitimimin e tij, në rastin konkret. Në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës, kërkuesit nuk kanë argumentuar në nivel kushtetues se si dispozitat e kundërshtuara cenojnë lirinë e organizimit. Pretendimet e tyre mbështeten në hamendësime dhe nuk lidhen me përmbajtjen e aktit që kërkojnë të shfuqizohet, por me zbatimin e akteve të tjera ligjore

dhe nënligjore, të cilat qëndrojnë jashtë objektit të ligjit nr. 38/2021.

Për themelin e pretendimeve:

15.2 Këshilli i Ministrave ka parashtruar të njëjtat prapësime si Kuvendi për sa u përket pretendimeve të kërkuesve për cenimin e identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kulturore; së drejtës për të zgjedhur vendbanimin dhe profesionin; së drejtës së pronës private në drejtim të së drejtës së ligjvënësit për të përcaktuar përdorimin e saj në funksion të së mirës publike, duke garantuar shpronësimin sipas një shpërblimi të drejtë; së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit e mbrojtjen e tij; të drejtave ekonomike e sociale; lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe parimit të barazisë përpara ligjit; parimit të sigurisë juridike; parimit të proporcionalitetit në lidhje me të drejtat e tjera; nenit 82, pika 1, të Kushtetutës për sa i përket vlerësimit të bërë nga Komisioni i Kuvendit për Ekonominë dhe Financat; MSA-së për sa i përket mungesës së një marrëveshjeje mes ndërmarrjeve; TKE-së dhe direktivave të BE-së; TFBE-së. Po kështu, krahas këtyre pretendimeve, ai ka prapësuar edhe se:

15.2.1 Rasti konkret klasifikohet në aktet e parashikuara në nenin 4 të ligjit nr. 146/2014, për të cilat nuk zbatohen rregullat e konsultimit publik.

15.2.2 Kjo Gjykatë dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)* kanë pranuar se *e drejta e pronës private* mund të kufizohet për një interes publik. Çdo pasuri që do të preket nga projekti do të trajtohet me shpërblim të drejtë, sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me nenin 41 të Kushtetutës. Argumentet për këto pretendime nuk kanë të bëjnë me antikushtetutshmërinë e ligjit dhe nuk janë ngritur në nivel kushtetues.

15.2.3 Për sa u përket pretendimeve në lidhje *me nenin 82, pika 1, të Kushtetutës*, efekti financiar buron nga VKM-ja nr. 485/2021 dhe jo nga ligji. Ndonëse VKM-ja ka si bazë ligjin, ajo përbën një akt të ndryshëm. Në ligjin autorizues nuk mund të përcaktohen efektet financiare që do të rrjedhin nga miratimi i akteve nënligjore, pasi akti që shërben si bazë për këto efekte është ai i cili i parashikon ato.

16. Subjekti i interesuar, KESH-i, ka prapësuar:

Për kërkesën për pezullimin e akteve:

16.1 Ligji përcakton vetëm kornizën në bazë të së cilës do të zhvillohet procesi dhe nuk krijon një situatë që kërkon shmangien e dëmeve që mund t'i vijnë publikut nga zbatimi i tij, pasi nuk ekziston një dëm aktual që mund të vërë në dyshim serioz të drejtat kushtetuese ose veprimtarinë normale të institucioneve publike, për rrjedhojë kjo kërkesë është e pabazuar. Ndërkohë, kërkesa për pezullimin e zbatimit të VKM-së nr. 485/2021 ka mbetur pa objekt, pasi ajo është ekzekutuar tashmë, duke sjellë pasojat për të cilat është miratuar, për rrjedhojë pezullimi i saj nuk do të sillte asnjë efekt.

Për juridiksionin e Gjykatës:

16.2 VKM-ja nr. 485/2021 përbën një akt me karakter individual dhe si e tillë nuk i nënshtrohet juridiksionit të Gjykatës. Ajo i drejtohet shoqërisë "KESH" sh.a., rregullon një marrëdhënie konkrete, efektet e saj shtrihen ndaj subjekteve të përcaktuara dhe janë prodhuar tashmë, pasi kontrata e fazës së parë është miratuar, çka do të thotë se karakteri i saj ka qenë shterues. Pasojat që vijnë më pas lidhen me mënyrën se si do të projektohet dhe ndërtohet HEC-i dhe nuk i japin VKM-së karakter vazhdues. Për kundërshtimin dhe pezullimin e saj nuk rezulton që kërkuesit t'i jenë drejtuar gjykatës administrative të shkallës së parë ose gjykatës së apelit dhe këto të fundit të kenë qenë mjete joefektive.

Për legjitimimin e kërkuesve:

16.3 Referuar statuteve të kërkuesve, qëllimi dhe objekti i veprimtarisë së tyre lidhen kryesisht me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; mbrojtjen e këtyre të drejtave në gjykatë, kur është e mundur; kujdesjen dhe përsosjen e legjislacionit vendas, të dispozitave që garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve; mbrojtjen nga praktikat abuzive dhe diskriminuese në marrëveshjet e partneritetit publik-privat ose koncesionare; mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave kulturore, historike dhe etnografike të zonës. Fakti që veprimtaria e shoqatës "Kundërshtimi ndaj digës së Skavicës" synon ndalimin e ndërtimit të një vepre publike nuk është i mjaftueshëm për ta legjitimuar atë në Gjykatë. Po kështu, kërkuesit nuk legjitimohen në lidhje me pretendimet për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe konkurrencës së lirë, pasi nuk përfaqësojnë në këtë gjykim Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë dhe nuk mbrojnë të drejtat e kësaj shoqate.

Për themelin e pretendimeve:

16.4 Pretendimi i kërkuesve për cenimin e *së drejtës së pronës private* është i pabazuar, pasi kjo e drejtë mund të kufizohet për një interes publik. Ndërtimi i hidrocentralit do të ketë rolin e një rregullatori shumëvjeçar në kaskadën e Drinit, duke minimizuar

përmbytjet në fushën e Nënshkodrës. Ai do t'u japë fund prurjeve të shumta që depozitohen në muajt e pikut të prurjeve në HEC-et e Komanit dhe të Vaut të Dejës, si dhe hapjes së tuneleve të tyre të shkarkimit në rastin e kuotave maksimale, çka sillte përmbytje në zonën e Nënshkodrës. Për qëllime të hartimit të Planit të Veprimit të Zhvendosjes do të kryhen studimet e nevojshme dhe do të ndërmerren të gjitha masat për të përcaktuar popullsinë dhe sipërfaqen e prekur, planin e zhvendosjes në momentin e aplikimit, si dhe vlerën e kompensimit të pronës e aseteve. Çmimet e përcaktuara nga kërkuesit në lidhje me *shpërblimin e drejtë* janë hamendësime të pabazuara e të pajustifikuara.

16.5 Pretendimet për cenimin e *së drejtës për të zgjedhur punën, profesionin dhe për të siguruar mjetet e jetesës me punë të ligjshme* nuk qëndrojnë, pasi kërkuesit nuk kanë justifikuar në asnjë moment pasojat që mund t'i vinë interesit publik nga zbatimi i ligjit. Projekti do të ndikojë si ekonomikisht, ashtu edhe nga ana sociale, duke krijuar vende të reja pune qoftë në fazën e ndërtimit, ashtu edhe në vazhdimësi, me vënien e tij në punë.

16.6 Për sa u përket pretendimeve për *cenimin e së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit e mbrojtjen e tij*, projekti ndodhet ende në fazën e parë, atë studimore, përfundimet e së cilës do t'i nënshtrohen vlerësimit të strukturave shtetërore. Studimet e gjendjes ekzistuese mjedisore janë kryer për periudhat e verës, vjeshtës, dimrit dhe pranverës. Draftraporti i çështjeve mjedisore është hartuar në tremujorin e katërt të vitit 2023, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore" *(VKM nr. 686/2015)*, është publikuar në faqen zyrtare të KESH-it në fillim të shkurtit 2023 dhe u është dërguar Ministrisë së Turizmit e Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, si pjesë e procesit të aplikimit për hartimin e raportit të thelluar të VNMS-së.

16.7 Pretendimet e kërkuesve për cenimin e *parimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe konkurrencës së lirë* janë të pabazuara. Ligji nuk është kundërshtuar nga asnjë shoqatë që mbron interesat e subjekteve të ndryshme tregtare. Ai ka natyrë procedurale e përcakton kornizën në bazë të së cilës do të zhvillohet procesi dhe nuk cenon të drejtat e kërkuesve.

16.8 Ligji nuk cenon *parimin e sigurisë juridike* dhe *parimin e proporcionalitetit*, pasi siguria juridike nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kur për shkak të interesit publik nevojitet bërja e një rregullimi të ndryshëm të një marrëdhënieje, interesi publik ka përparësi ndaj sigurisë juridike. Jo çdo masë që ligjvënësi ndërmerr ndaj subjekteve të ligjit përbën cenim të të drejtave kushtetuese.

16.9. Ligji nuk është në kundërshtim me standardet dhe vlerat e BE-së dhe parashikimet e *MSA-së*. Neni 7(3) i MSA-së i referohet dhënies së aksesit të barabartë shoqërive të komunitetit në procedurat e dhënies së kontratave në Shqipëri, sipas legjislacionit shqiptar dhe jo sipas *acquis* së BE-së. Po kështu, ai nuk përfshihet në kategorinë e ligjeve të përafruara me *acquis* dhe as në listën e ligjeve të përafruara për periudhën shtator 2023 e në vazhdim. VKM-ja nr. 485/2021 është miratuar në bazë dhe për zbatim të ligjit, për rrjedhojë edhe pretendimet në lidhje me të janë të pabazuara.

17. Subjekti i interesuar, shoqëria "Bechtel", nuk ka paraqitur prapësime me shkrim edhe pse është njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

18. Kërkuesit kanë pretenduar se ligji nr. 38/2021 dhe VKM-ja nr. 485/2021 përcaktojnë rregulla sjellje me pasoja për një numër të pakufizuar personash. Sipas tyre, shtrirja në kohë, pasojat që sjell, numri i personave që preken e sipërfaqja e madhe e territorit ku vepron e bëjnë VKM-në një akt me karakter normativ.

19. Subjektet e interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe KESH-i kanë prapësuar se rasti në shqyrtim nuk hyn në juridiksionin kushtetues. Sipas tyre, pretendimet në lidhje me ligjin nr. 38/2021 nuk prekin në vetvete probleme të kushtetutshmërisë, por të raportit që duhet të kenë në zbatim norma me fuqi të njëjta juridike. Po kështu, në kuptim të nenit 59, pika 2, të Kushtetutës, përmbushja e objektivave socialë nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt në gjykatë dhe nuk përfshihet në rrethin e çështjeve që i përkasin juridiksionit kushtetues. Pretendimet për cenimin e së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit e mbrojtjen e tij dhe të të drejtave

ekonomike e sociale janë të natyrës ligjore. Po sipas këtyre subjekteve, VKM-ja nr. 485/2021 përbën akt me karakter individual, për kundërshtimin e së cilës kërkuesit duhej t'u ishin drejtuar gjykatave administrative, pasi i drejtohet shoqërisë "KESH" sh.a., rregullon një marrëdhënie konkrete dhe, në kushtet kur kontrata e fazës së parë është miratuar, efektet e saj, të cilat shtrihen ndaj subjekteve të përcaktuara, janë prodhuar tashmë, çka do të thotë se karakteri i saj ka qenë shterues.

20. Gjykata ka pohuar se juridiksioni kushtetues e merr përcaktimin e natyrës dhe kufijve të tij drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, sipas të cilit: *"1. Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. 2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës."*. Juridiksioni kushtetues detajohet në dispozitat e tjera të Kushtetutës, ku veçanërisht neni 131 i saj parashikon kompetencën kushtetuese sipas natyrës së çështjes, por pa u kufizuar në të, për sa kohë që Gjykata ka për detyrë të vendosë edhe për çështje që janë të parashikuara shprehimisht në norma të tjera kushtetuese *(shih vendimet nr. 38, datë 9.12.2022; nr. 36, datë 4.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*. Bazuar në nenin 131, pika 1, shkronjat "a" dhe "c", të Kushtetutës, Gjykata vendos për papajtueshmërinë me Kushtetutën të ligjit, si dhe të akteve normative të organeve qendrore.

21. Në rastin në shqyrtim, kërkuesit kanë pretenduar se ligji nr. 38/2021 cenon identitetin kombëtar, të drejtën e pronës private, të drejtën për jetë private, të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, të drejtën për t'u informuar për gjendjen e mjedisit, të drejtën për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm, lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe parimin e barazisë përpara ligjit.

22. Gjykata vëren se e drejta e pronës private, e drejta për jetë private, e drejta për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, e drejta për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, liria e veprimtarisë ekonomike dhe barazia përpara ligjit garantohen drejtpërsëdrejti nga Kushtetuta. Ndërkohë, ndonëse identiteti kombëtar, në drejtim të trashëgimisë kombëtare, dhe e drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm kanë të bëjnë me objektivat socialë të parashikuar nga neni 59 i Kushtetutës, Gjykata i vlerëson pretendimet në lidhje me to në këndvështrim të së drejtës ndërkombëtare të ratifikuar dhe detyrimeve që rrjedhin ndaj shtetit shqiptar, sipas nenit 122 të Kushtetutës. Për më tepër, Gjykata thekson se edhe në trajtimin konventor KEDNJ-ja nuk i ka parashikuar ato si të drejta më vete, por janë trajtuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së të ndërlidhura me të drejta të tjera të parashikuara në të.

23. Në kuptim të sa më lart, duke pasur parasysh se aktet e kundërshtuara si antikushtetuese parashikojnë ndërmarrjen e një sërë veprimesh gjatë fazës së parë të projektit dhe se pretendimet e kërkuesve lidhen me këtë fazë, Gjykata çmon se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "a", të Kushtetutës, çështja përbën mosmarrëveshje kushtetuese dhe ajo ka juridiksionin për të vendosur në lidhje me të, për rrjedhojë i vlerëson të pabazuara pretendimet e subjekteve të interesuara, sipas të cilave çështja është e parakohshme dhe nuk mund të quhet ende mosmarrëveshje kushtetuese, pasi kontrata e fazës së parë ka të bëjë me fazën studimore dhe nuk çon në fillimin e punimeve për ndërtimin e digës së Skavicës, çka i përket fazës së dytë që miratohet me ligj të posaçëm nga Kuvendi.

24. Për sa u përket pretendimeve në lidhje me VKM-në nr. 485/2021, në jurisprudencën e saj Gjykata ka mbajtur qëndrimin se vetëm aktet normative mund të jenë objekt i kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, ndërkohë që aktet individuale i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor. Karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme, prandaj gjatë ushtrimit të kontrollit abstrakt të normës Gjykata ndalet, paraprakisht, në natyrën e aktit të kundërshtuar, çka lidhet drejtpërdrejt me juridiksionin e saj për shqyrtimin substancial të aktit *(shih vendimet nr. 35, datë 15.6.2023; nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 86, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*.

25. Gjykata ka identifikuar tre kritere që përcaktojnë ndarjen e aktit nënligjor në individual ose normativ: (i) sipas subjekteve të cilave u drejtohet akti - subjekte individualisht të përcaktuara të së drejtës/një grup personash të përcaktuar në bazë të karakteristikave të përgjithshme ose subjekte të papërcaktuara të së drejtës; (ii) sipas objektit - krijimi, ndryshimi ose shuarja e një marrëdhënieje juridike konkrete e së drejtës administrative ose përcaktimi i normave të përgjithshme të sjelljes me karakter abstrakt; (iii) sipas karakterit shterues/

joshterues - efektet shtrihen tek subjekte të përcaktuara dhe në mënyrë të njëhershme ose te subjekte të papërcaktuara të së drejtës në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme *(shih vendimet nr. 35, datë 15.6.2023; nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 14, datë 21.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese).*

26. Në rastin konkret, Gjykata vëren se përmes VKM-së nr. 485/2021 është miratuar kontrata e fazës së parë mes KESH-it dhe shoqërisë "Bechtel Limited" për shërbimet teknike në lidhje me projektin hidroenergjetik të Skavicës. Si e tillë, kjo VKM mbart karakteristikat e një akti me karakter individual, pasi disponon për krijimin e një marrëdhënieje juridike kontraktuale konkrete mes KESH-it, në cilësinë e autoritetit kontraktues, dhe shoqërisë "Bechtel", duke iu drejtuar në këtë mënyrë subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës dhe duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë marrëdhënie. Në këtë kuptim, rregullat që ajo vendos nuk kanë natyrë të përgjithshme, pasi zbatimi i saj u referohet situatave konkrete që rrjedhin nga përmbushja e detyrimeve të përcaktuara në të. Po kështu, karakteri i saj është shterues, pasi qëllimi i VKM-së është miratimi i kontratës së fazës së parë për projektin, çka rezulton të jetë realizuar me hyrjen e saj në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

27. Për rrjedhojë, në kushtet kur VKM-ja nr. 485/2021 ka disponuar për një marrëdhënie juridike konkrete mes dy subjekteve juridike qartësisht të përcaktuara dhe efektet e saj nuk kanë karakter vazhdues, Gjykata çmon se ajo nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, për pasojë pretendimet e ngritura në lidhje me të nuk mund të merren në shqyrtim.

B. Për legjitimimin e kërkuesve

28. Çështja e legjitimimit (*locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur për shqyrtim përpara Gjykatës.

29. Kërkuesit kanë pretenduar se legjitimohen në kërkesën drejtuar Gjykatës, pasi janë regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi, kërkesa për shfuqizimin e akteve është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar nga neni 50, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000 dhe të drejtat e cenuara nga ligji nr. 38/2021, të garantuara nga Kushtetuta, KEDNJ-ja dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, përfshihen brenda veprimtarisë dhe misionit për të cilin janë krijuar. Kërkuesja, KSHH-ja, ka pretenduar se ajo është legjitimuar edhe më parë nga kjo Gjykatë në lidhje me disa prej të drejtave që cenohen nga aktet e kundërshtuara. Për rrjedhojë, sipas kërkuesve, ata justifikojnë interesin e tyre të drejtpërdrejtë në çështje.

30. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se kërkuesit nuk legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës, pasi nuk kanë arritur të provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin janë krijuar ose veprimtarisë që kryejnë dhe pasojave që rrjedhin nga ligji që kërkojnë të shpallet si antikushtetues. Sipas këtij subjekti, interesi i tyre nuk rezulton i argumentuar dhe nuk plotëson kërkesat për të qenë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak dhe nuk lidhet me fushën e veprimtarisë së tyre. Fakti që veprimtaria e shoqatës "Kundërshtimi ndaj digës së Skavicës" synon ndalimin e ndërtimit të një vepre publike nuk është i mjaftueshëm për ta legjitimuar atë në Gjykatë. Po sipas Këshillit të Ministrave, fakti se një subjekt i kushtëzuar është legjitimuar në procese të tjera përpara Gjykatës nuk përbën argument për legjitimimin e tij në rastin konkret, pasi në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës, kërkuesit nuk kanë argumentuar në nivel kushtetues se si dispozitat e kundërshtuara cenojnë lirinë e organizimit dhe pretendimet e tyre mbështeten në hamendësime e nuk lidhen me përmbajtjen e aktit që kërkojnë të shfuqizohet, por me zbatimin e akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që qëndrojnë jashtë objektit të ligjit nr. 38/2021.

31. Subjekti i interesuar, KESH-i, ka paraqitur të njëjtat argumente si Këshilli i Ministrave në lidhje me moslegjitimimin e shoqatës "Kundërshtimi ndaj digës së Skavicës". Po sipas këtij subjekti, referuar statuteve të kërkuesve, qëllimi dhe objekti i veprimtarisë së tyre lidhen kryesisht me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; mbrojtjen e këtyre të drejtave në gjykatë, kur është e mundur; kujdesjen dhe përsosjen e legjislacionit vendas për dispozitat që garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve; mbrojtjen nga praktikat abuzive dhe diskriminuese në marrëveshjet e partneritetit publik-privat ose koncesionare;

mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave kulturore, historike dhe etnografike të zonës. Po kështu, KESH-i ka prapësuar se kërkuesit nuk legjitimohen në lidhje me pretendimet për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe konkurrencës së lirë, pasi nuk përfaqësojnë në këtë gjykim Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë dhe nuk mbrojnë të drejtat e kësaj shoqate.

B.1 Për legjitimimin ratione personae

32. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se organizatat, ku bëjnë pjesë edhe kërkuesit, përfshijnë persona juridikë të organizuar në forma të ndryshme, që krijohen me ligj ose me vullnetin e lirë të anëtarëve dhe që organizohen për mbrojtjen e një qëllimi të caktuar, i cili mund të jetë në të mirë dhe në interes të publikut ose të anëtarëve të tyre. Sipas Gjykatës, këto subjekte legjitimohen t'i drejtohen asaj vetëm nëse përmbushin kushtin e kërkuar nga paragrafi 2 i nenit 134 të Kushtetutës për të argumentuar "interesin e tyre" në një "çështje të veçantë". Vlerësimi nëse një subjekt i kushtëzuar ka interes bëhet sipas rrethanave të veçanta të çdo çështjeje konkrete, pavarësisht nëse subjekti është legjitimuar ose jo në gjykime të tjera kushtetuese *(shih vendimet nr. 39, datë 15.12.2022; nr. 36, datë 4.11.2021; nr. 32, datë 27.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

33. Që të vërë në lëvizje Gjykatën, organizata duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premisat teorike për antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit *(shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 1, datë 16.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*.

34. Në rastin konkret, Gjykata vëren se shoqata "Kundërshtimi ndaj digës së Skavicës" është regjistruar si person juridik, organizatë jofitimprurëse *(OJF)*, me vendimin nr. 6966, datë 13.9.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Qëllimi dhe objekti i veprimtarisë së saj janë, ndër të tjera: ndërgjegjësimi i opinionit publik kundër ndërtimit të HEC-it të Skavicës dhe HEC-eve të ngjashme në qarkun e Dibrës; lobimi në kuadër të mbrojtjes së natyrës, florës, faunës dhe habitatit, mbrojtja e trashëgimisë, historisë, kulturës, traditës dhe të drejtave të dibranëve që preken drejtpërdrejt dhe në mënyrë indirekte nga projekti i ndërtimit të HEC-it të Skavicës dhe HEC-eve të tjera të ngjashme në qarkun e Dibrës, duke filluar nga kufiri me Maqedoninë e Veriut, deri te fillimi i digës së Fierzës, pjesa e paprekur e lumit Drin nga hidrocentralet. Po kështu, ajo synon mbrojtjen e popullsisë poshtë digës së projektuar të Skavicës.

35. Shoqata "Për mbrojtjen e pronave dhe mjedisit të pellgut të Drinit të Zi" është regjistruar si person juridik, OJF, me vendimin nr. 437, datë 5.11.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ajo ka për qëllim të veprimtarisë së saj, ndër të tjera, të sigurojë rritjen, administrimin e përdorimin racional të pyjeve dhe kullotave; të ruajë e mirëmbajë pyjet me funksion mbrojtës, si për ruajtjen e tokave nga erozioni, ashtu edhe për funksionet e tjera, si ruajtjen e veprave ujore dhe ruajtjen nga ortekët; të mbrojë, të mbledhë dhe të zhvillojë vlerat kulturore historike dhe etnografike të kësaj zone; të mbrojë të drejtat e pronarëve dhe të banorëve të zonës në raste të përmbytjeve të tokave dhe të pyjeve nga ndërtimi i ndonjë hidrocentrali në këtë zonë.

36. KSHH-ja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 2/1, datë 19.7.2002 të kësaj gjykate. Qëllimi i veprimtarisë së saj është, ndër të tjera, vëzhgimi i gjendjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe zbatimi i parimeve të shtetit ligjor, denoncimi i çdo shkeljeje që bie ndesh me legjislacionin shqiptar dhe normat e së drejtës ndërkombëtare të njohura përgjithësisht; kundërshtimi i çdo forme të diskriminimit të personit; sensibilizimi i opinionit publik për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të ligjshme të shtetasve; edukimi ligjor i shtetasve si me legjislacionin e brendshëm, edhe me atë ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut; t'i drejtohet Gjykatës për çështje që lidhen me interesat dhe misionin e organizatës, në përputhje me nenin 134 të Kushtetutës.

37. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se legjitimimi i shoqatave duhet parë edhe në këndvështrimin e dallimit që ekziston ndërmjet pretendimit për cenim të një të drejte substanciale kushtetuese që ka lidhje me interesat e tyre dhe pretendimeve për antikushtetutshmëri të aktit normativ të kundërshtuar, në kuptim të rregullimeve kushtetuese procedurale për të cilat mund t'i drejtohen Gjykatës subjektet e kushtëzuara sipas

nenit 134 të Kushtetutës *(shih vendimet nr. 62, datë 20.11.2023; nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 43, datë 5.6.2017 të Gjykatës Kushtetuese).*

38. Nga materialet e depozituara së bashku me kërkesën Gjykata vëren se kërkuesit janë krijuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe plotësojnë kriteret formale të legjitimimit të tyre në Gjykatë, në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës. Po kështu, pretendimet e parashtruara kanë të bëjnë me të drejta dhe liri kushtetuese që përputhen me misionin dhe qëllimin e veprimtarisë së tyre, për rrjedhojë Gjykata çmon se kërkuesit kanë interes kushtetues, ndaj legjitimohen *ratione personae* në kërkesën për kundërshtimin e ligjit nr. 38/2021.

B.2 Për legjitimimin ratione temporis

39. Gjykata konstaton se ligji nr. 38/2021 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 62 të datës 20.4.2021 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në këtë fletore, ndërsa kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës me kërkesa në datat 4.5.2023 dhe 5.5.2023. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkesat janë paraqitur brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar nga neni 50, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000.

B.3 Për legjitimimin ratione materiae

40. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se në rastin e subjekteve të kushtëzuara, të parashikuara nga neni 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës, pretendimet e ngritura shqyrtohen për aq sa ato përligjin interesin e këtyre subjekteve për cenimin e të drejtave themelore. Vetëm fakti se dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse organizatat legjitimohen në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që përfshihen në qëllimin e veprimtarisë së tyre, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut. Po sipas Gjykatës, interesi i organizatës për të vënë në lëvizje kontrollin kushtetues të normës vlerësohet i përligjur kur aktet që kundërshtohen prekin drejtpërdrejt anëtarët e organizatës, veprimtarinë e saj ose misionin për të cilin ajo është krijuar *(shih vendimet nr. 62, datë 20.11.2023; nr. 39, datë 15.12.2022; nr. 43, datë 5.6.2017 të Gjykatës Kushtetuese).*

41. Duke mbajtur në konsideratë natyrën e pretendimeve të parashtruara, Gjykata vlerëson se për sa u përket pretendimeve për cenimin e së drejtës së pronës private dhe shpërblimit të drejtë të saj, së drejtës për jetë private në drejtim të së drejtës për të zgjedhur banimin, punën dhe profesionin, si dhe parimit të proporcionalitetit në lidhje me këto të drejta, kërkuesit nuk kanë arritur të argumentojnë nga pikëpamja kushtetuese cenimin e tyre si rrjedhojë e zbatimit të ligjit nr. 38/2021 ose pasojat e ardhura për këtë shkak, duke mos arritur të përcaktojnë në aspektin kushtetues interesin e tyre të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar. Po kështu, kërkuesit nuk kanë arritur të përcaktojnë cenimin e identitetit kombëtar, në drejtim të trashëgimisë kulturore dhe pasurore, si dhe të së drejtës për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm në këndvështrim të standardeve ndërkombëtare të pranuara nga shteti shqiptar, sipas nenit 122 të Kushtetutës. Gjykata vëren se ligji objekt shqyrtimi është ende në fazën e parë të zbatimit të tij, që përfshin aktivitetet paraprake të punës në lidhje me projektimin dhe ndërtimin e HEC-it të Skavicës, ndaj dhe gjatë gjykimit kushtetues kërkuesit nuk arritën të provojnë cenimin e këtyre të drejtave në këtë fazë.[3]

42. Ndërsa lidhur me cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe konkurrencës së lirë, në drejtim të parimit të proporcionalitetit dhe parimit të barazisë përpara ligjit, Gjykata vëren se, që të legjitimohen për këtë pretendim, neni 11 i Kushtetutës kërkon që kërkuesit të provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë mes ligjit të kundërshtuar si antikushtetues dhe veprimtarisë së tyre, misionit që ata kanë e pasojave që u vijnë nga zbatimi i tij të drejtave të anëtarëve të tyre. Në rastin konkret, Gjykata vëren se nga materialet e depozituara së bashku me kërkesën, si dhe gjatë gjykimit kushtetues shoqata "Kundërshtimi ndaj digës së Skavicës", shoqata "Për mbrojtjen e pronave dhe mjedisit të pellgut të Drinit të Zi" dhe KSHH-ja nuk arritën të provojnë se anëtarë të tyre ushtrojnë veprimtari ekonomike ose që qëllimi i veprimtarisë për të cilën janë krijuar përfshin edhe të drejtat e garantuara nga neni 11 i Kushtetutës. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuesit nuk justifikojnë interesin e tyre

[3] Gjyqtaret Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska dhe Marjana Semini votuan për legjitimimin e kërkuesve për pretendimet për cenimin e trashëgimisë kulturore dhe pasurore, të drejtën e pronës private dhe për shpërblim të drejtë të saj, të lidhura me parimin e proporcionalitetit.

në lidhje me ligjin nr. 38/2021 edhe në këndvështrim të kësaj lirie.[4]

43. Për sa i takon pretendimit të kërkuesve për mosrespektimin e detyrimit për shoqërimin e projektligjit me raportin që përligj shpenzimet financiare, të parashikuar nga neni 82, pika 1, i Kushtetutës, në përfundim të diskutimeve, në zbatim të nenit 72, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje paraprake, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.[5]

44. Në këndvështrim të sa më lart, Gjykata vlerëson se të tre kërkuesit legjitimohen *ratione materiae* për sa u përket pretendimeve për cenimin e së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij, të garantuar nga neni 56 i Kushtetutës dhe Konventa e Aarhusit. Për rrjedhojë, në vijim, Gjykata do të vlerësojë bazueshmërinë në themel të pretendimeve të ngritura prej tyre në lidhje me këtë të drejtë.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1 Për cenimin e së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij

45. Kërkuesit kanë pretenduar se ligji nr. 38/2021 bie ndesh me nenin 56 të Kushtetutës, Konventën e Aarhusit, si dhe ligjet për njoftimin e konsultimin publik e për mbrojtjen e mjedisit, pasi miratimi i tij është bërë pa përfshirjen e publikut në vendimmarrje, pa një proces informues dhe konsultues me publikun e zonës ose më gjerë në drejtim të kufizimeve eventuale të të drejtave dhe ndikimit të ligjit në to, të dobishmërisë së investimit, avantazheve dhe disavantazheve, pasojave që ai sjell në ekonomi, shëndetin e popullatës etj., si dhe pa u përgatitur raporti i VNSM-së, i cili duhej të ishte gati për opinionet dhe komentet e publikut që në tremujorin e tretë të vitit 2022.

46. Subjektet e interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe KESH-i, kanë prapësuar se ligji nuk ka si objekt të tij procedurën e kryerjes së dëgjesave publike, por vetëm procedurën që lidhet ngushtësisht me marrëdhënien ndërmjet shtetit dhe operatorit që do të realizojë veprën, ndërsa sipas Këshillit të Ministrave, projekti klasifikohet në aktet e parashikuara në nenin 4 të ligjit nr. 146/2014, për të cilat nuk zbatohen rregullat e konsultimit publik. Po sipas këtyre subjekteve, mosparashikimi në ligj i detyrimit për realizimin e konsultimeve publike ose dëgjesave me qytetarët nuk përbën shkelje të këtyre parimeve, pasi ato rregullohen me ligje të tjera dhe kontrata e fazës së parë nuk çon në fillimin e punimeve për ndërtimin e digës së Skavicës, por në kërkimin dhe hulumtimin e kushteve për vlerësimin nëse diga mund të ndërtohet ose jo. Është pikërisht kjo fazë që parashikon konsultimin e publikut, përfshirjen e grupeve të interesit, si dhe njohjen me aktet, dokumentet, studimet dhe analizat, përfshirë edhe vlerësimin e ndikimit mjedisor, social dhe ekonomik. Subjektet e interesuara kanë prapësuar, gjithashtu, se draftraporti i çështjeve mjedisore është publikuar në faqen zyrtare të KESH-it në fillim të shkurtit 2023 dhe u është dërguar Ministrisë së Turizmit e Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit si pjesë e procesit të aplikimit për hartimin e raportit të thelluar të VNMS-së. Po kështu, studimet dhe strategjia e propozuar për kompensimin dhe zhvendosjen do të ndahen me

[4] Gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska dhe Genti Ibrahimi votuan kundër legjitimimit të kërkuesve për pretendimin për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike. Gjyqtaret Marsida Xhaferllari dhe Fiona Papajorgji votuan për legjitimimin kërkuesve në lidhje me pretendimet për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe shqyrtimin në themel të tyre, ndërsa gjyqtaret Elsa Toska dhe Marjana Semini votuan për legjitimimin vetëm të KSHH-së në lidhje me këtë pretendim dhe shqyrtimin në themel të tij.

[5] Gjyqtarët Holta Zaçaj, Ilir Toska dhe Genti Ibrahimi votuan kundër legjitimimit të kërkuesve për pretendimin për cenimin e nenit 82, pika 1, të Kushtetutës, për shkak se, si subjekte të kushtëzuara, ata nuk mund të ngrenë pretendime në lidhje me shtetin e së drejtës, në aspektin procedural të miratimit të ligjit.

- Gjyqtaret Marsida Xhaferllari dhe Sonila Bejtja, në vijim të qëndrimeve të mbajtura më parë prej tyre, votuan për legjitimimin e kërkuesve edhe për këtë pretendim, me arsyetimin se kur objekt i kontrollit kushtetues janë ligjet dhe aktet e tjera normative, Gjykata vlerëson edhe procedurën për miratimin e tyre, bazuar në nenin 51, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 8577/2000. Me fillimin e shqyrtimit në themel të çështjes, vlerësimi kushtetues i formës dhe procedurës nuk mund të shmanget nga Gjykata dhe, aq më pak, të refuzohet me arsyetimin e mungesës së legjitimimit *ratione materiae*, që është një çështje e shqyrtuar dhe e vendosur paraprakisht prej saj.

- Gjyqtarët Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sandër Beci dhe Marjana Semini votuan për qëndrimin se referuar jurisprudencës kushtetuese ndër vite, legjitimimi i kërkuesve për cenimin e nenit 82, pika 1, të Kushtetutës duhej vlerësuar në përfundim të shqyrtimit në themel të pretendimeve të ngritura me natyrë substanciale dhe vetëm nëse do të provohej shkelja e këtyre të drejtave do të merrej në shqyrtim ky pretendim.

komunitetet e prekura për të marrë opinionet dhe komentet e tyre, çka do të realizohet përmes dëgjesave të hapura publike dhe opinionet e marra do të reflektohen më pas në raportin përfundimtar. Ky vlerësim do të bëhet në përfundim të fazës së parë të projektit.

47. Neni 56 i Kushtetutës parashikon se kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij. Gjykata vëren se krahas së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit, kjo dispozitë kushtetuese përfshin edhe të drejtën për t'u informuar për mbrojtjen e tij, në drejtim të masave të ndërmarra ose që duhet të ndërmerren për këtë qëllim. Në garantimin e kësaj të drejte kushtetuese një rol të veçantë luan edhe transparenca e autoriteteve shtetërore përmes garantimit të aksesit të publikut në informacion dhe përfshirjes së tij në proceset e veprimtaritë që sjellin ndikim në mjedis. Sipas Gjykatës, kjo e drejtë paraqet rëndësi të veçantë për shkak të nevojës për parandalimin e dëmeve të pakthyeshme në kuadër të mbrojtjes mjedisore, pasi e drejta për t'u informuar për gjendjen e mjedisit shërben si masë paraprake për mbrojtjen e tij.

48. Gjykata vëren se ndonëse e drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe për t'u informuar për gjendjen e tij nuk parashikohet drejtpërsëdrejti nga KEDNJ-ja, në jurisprudencën e saj në këtë drejtim GJEDNJ-ja ka theksuar se krahas detyrimit për të miratuar legjislacionin e nevojshëm për mbrojtjen e mjedisit *(shih Hatton k. Mbretërisë së Bashkuar, datë 2.10.2001; Jugheli dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë, nr. 38342/05, datë 13.7.2017, § 75)*, në aspektin procedural shtetet kanë detyrimin që përpara realizimit të projekteve që mund të sjellin pasoja në mjedis, të vënë në dispozicion të publikut informacionin e nevojshëm në lidhje me to. Ky informacion duhet të jetë i vërtetë, i besueshëm, i saktë dhe i mjaftueshëm *(shih Association Burestop dhe të tjerë k. Francës, datë 1.7.2021, nr. 56176/18, § 108)*. Po kështu, shtetet duhet t'i japin mundësinë popullsisë së prekur për të marrë pjesë në procedurat e dhënies së lejeve, si dhe për të paraqitur kundërshtime *(shih Giacomelli k. Italisë, nr. 59909/00, datë 2.11.2006, § 94; Tătar kundër Rumanisë, nr. 67021/01, datë 27.1.2009, § 114)*.

49. Gjykata vëren, gjithashtu, se sipas nenit 122 të Kushtetutës çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare dhe ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi kërkon nxjerrjen e një ligji. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit kur nuk pajtohen me të. Nën dritën e parashikimeve të neneve 5, 116 dhe 122 të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, duke i radhitur marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, të cilat janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik, në hierarkinë e akteve normative që kanë fuqi përpara ligjeve *(shih vendimet nr. 30, datë 2.11.2022; nr. 14, datë 21.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese)*.

50. Në vështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata vë në dukje se me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000, Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e Aarhusit, konventë e cila, me qëllim që të kontribuohet në mbrojtjen e së drejtës së çdo individi e të brezave të sotëm e të ardhshëm për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqënien e tij, përcakton detyrimin e shteteve për marrjen e masave në garantim të së drejtës së publikut për të pasur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t'iu drejtuar gjykatës në lidhje me çështje të mjedisit. Po kështu, në drejtim të garantimit të mbrojtjes së mjedisit, shteti shqiptar ka ratifikuar edhe Marrëveshjen e Parisit në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara "Për ndryshimet klimatike" *(shih ligjin nr. 75/2016, datë 14.7.2016)*.

51. Gjykata thekson se, sipas Konventës së Aarhusit, shtetet anëtare kanë detyrimin të garantojnë, në një periudhë të përshtatshme dhe ndërsa alternativat për ndërhyrjet me ndikim në mjedis janë ende të hapura, pjesëmarrjen efektive të publikut gjatë përgatitjes prej autoriteteve publike të rregulloreve ekzekutive dhe rregullave të tjera ligjore të përgjithshme e detyruese, të cilat mund të kenë një efekt të rëndësishëm në mjedis. Për këtë qëllim, ajo kërkon që pjesëmarrja e publikut të realizohet që në fazat e para të përgatitjes së këtyre rregulloreve dhe/ose instrumenteve të përgjithshme ligjore e normative, përmes ndërmarrjes së disa hapave, si: përcaktimi i afateve kohore të mjaftueshme për pjesëmarrje efektive; publikimi ose bërja të disponueshme për publikun e projekteve dhe rregullave ligjore; dhënia e mundësisë publikut për të komentuar drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve përfaqësuese këshillimore; marrja parasysh e

rezultateve të pjesëmarrjes publike, për aq sa të jetë e mundur *(neni 8)*.

52. Po sipas Konventës së Aarhusit, publiku i interesuar ka të drejtë të informohet me lajmërim publik ose individualisht që në procedurën e hershme të marrjes së një vendimi për mjedisin dhe në mënyrë të përshtatshme, efektive dhe në kohë, midis të tjerash, për: (a) veprimtarinë e propozuar dhe aplikimin mbi të cilin do të merret vendim; (b) natyrën e vendimeve të mundshme ose draftin e vendimit; (c) autoritetin publik përgjegjës për marrjen e vendimit; (d) procedurën e parashikuar, mënyrën dhe kohën kur ky informacion mund të jepet, përfshirë: (i) fillimin e procedurave; (ii) mundësitë e publikut për të marrë pjesë; (iii) kohën dhe vendin e çdo mbledhjeje publike të parashikuar; (iv) adresimin tek autoriteti publik, prej të cilit mund të merret informacioni përkatës dhe ku ky informacion depozitohet për shqyrtim nga publiku; (v) adresimin tek autoriteti publik ose çdo organ tjetër zyrtar, të cilit mund t'i drejtohen komente ose pyetje, si edhe informimi për kohën ose afatet kohore të paraqitjes së këtyre pyetjeve ose komenteve; (vi) informimin për informacionin e disponueshëm mjedisor në lidhje me veprimtarinë e propozuar; (e) faktin që veprimtaria i nënshtrohet një procedure kombëtare ose ndërkufitare të vlerësimit të ndikimit në mjedis *(neni 6, pika 2)*. Informacioni që i jepet publikut të interesuar përfshin përshkrim të vendit dhe karakteristikave fizike e teknike të veprimtarisë së propozuar, të efekteve të rëndësishme të veprimtarisë së propozuar në mjedis; përshkrim të masave të parashikuara për të parandaluar dhe/ose pakësuar efektet; përmbledhje joteknike të këtyre të dhënave, përmbledhje të alternativave kryesore të studiuara nga zhvilluesi, si dhe raportet dhe këshillat që i janë dhënë autoritetit publik në kohën kur publiku i interesuar do të informohet *(neni 6, pika 6)*.

53. Në jurisprudencën e tij në lidhje me zbatimin e Konventës së Aarhusit, Komiteti i Pajtueshmërisë ka theksuar se shteti shqiptar duhet të ofrojë mundësi të përshtatshme për pjesëmarrjen e publikut në procesin vendimmarrës, si dhe të miratojë një kuadër të qartë, transparent dhe të qëndrueshëm ligjor për zbatimin e dispozitave të Konventës *(shih vendimin e Komitetit të Pajtueshmërisë ACCC/C/2005/12)*. Po sipas kësaj jurisprudence, aktet e hartuara nga shtetet në zbatim të Konventës së Aarhusit duhet të garantojnë njoftimin në kohë, adekuat dhe efektiv të publikut të interesuar, dhënien e mundësisë efektive për pjesëmarrje të tij që në fazat e hershme, si dhe marrjen parasysh të rezultatit të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, çka do të ndihmonte në shmangien e paqartësive në të ardhmen *(shih vendimin e Komitetit të Pajtueshmërisë ACCC/C/2004/2)*.

54. Nga ana tjetër, ndonëse Shqipëria nuk është ende pjesë e BE-së, standardet që kjo e fundit vendos vlerësohen nga Gjykata në kuadër të procesit të integrimit të vendit tonë në BE dhe përshtatjes së legjislacionit vendas me *acquis communautaire*. Në këtë këndvështrim, Gjykata vëren se Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, ndonëse jo pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm, në nenin 37 të saj ka parashikuar detyrimin për të integruar në politikat e BE-së një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimit të cilësisë së tij, si dhe garantimin e tij në përputhje me parimin e një zhvillimi të qëndrueshëm.

55. Për sa i përket garantimit të së drejtës për mjedis të shëndetshëm në legjislacionin shqiptar, Gjykata gjen me vend të theksojë paraprakisht hapat e ndërmarrë nga vendi ynë në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Evropian *(BE)*, për përafrimin e legjislacionit tonë me atë të *acquis communautaire* dhe rekomandimet e BE-së. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se ligji për mbrojtjen e mjedisit, i cili është përafruar plotësisht me direktivën 2004/35/KE, datë 21.4.2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit "Për përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin", përcakton si një ndër parimet e mbrojtjes së mjedisit edhe parimin e së drejtës për informim dhe pjesëmarrje të publikut në çështje që kanë të bëjnë me mjedisin *(neni 13)*, ndërsa ligji për njoftimin dhe konsultimin publik ka rregulluar procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik, përmes përcaktimit të rregullave procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike, duke përcaktuar, ndër të tjera, detyrimin e organeve publike për marrjen e masave të nevojshme për krijimin e mundësive për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit të konsultimit publik, si dhe për organizimin e konsultimeve të drejtpërdrejta ose të

takimeve publike me palët e interesuara, të cilat dokumentohen me procesverbal *(neni 6)*.

56. Ndërkohë, ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis, i cili është përafruar plotësisht me direktivën 85/337/KEE të Këshillit të BE-së, ka parashikuar detyrimin për kryerjen e vlerësimit të ndikimit në mjedis të projekteve të ndryshme, ku, sipas shtojcës II të tij, përfshihen edhe ato në fushën e industrisë së energjisë, pjesëmarrjen në procesin e përgatitjes së VNM-së edhe të publikut e organizatave jofitimprurëse, informimin e publikut gjatë VNM-së dhe zhvillimin e seancave dëgjimore me publikun dhe OJF-të e interesuara, në bashkëpunim edhe me njësitë e qeverisjes vendore dhe zhvilluesin e projektit *(nenet 14-17)*.

57. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, duke pasur parasysh detyrimet që neni 56 i Kushtetutës, jurisprudenca e GJEDNJ-së dhe Konventa e Aarhusit vendosin ndaj autoriteteve shtetërore, si dhe faktin që ligji nr. 38/2021, nga natyra e tij, sjell ndikim në mjedis, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesve për cenimin e së drejtës procedurale për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij t'i analizojë në këndvështrim të hapave, procedurave dhe veprimeve të ndërmarra nga organet shtetërore për garantimin e kësaj të drejte kushtetuese. Për këtë qëllim, Gjykata vlerëson të ndalet në analizën e pretendimit të kërkuesve për respektimin e së drejtës për informim për gjendjen e mjedisit gjatë fazës para dhe pas miratimit të ligjit objekt kundërshtimi, duke pasur parasysh se procesi për projektimin dhe ndërtimin e HEC-it të Skavicës rezulton i tillë që kërkon kryerjen e konsultimeve publike gjatë gjithë hallkave të realizimit të tij.

58. Në këtë drejtim, në analizë të akteve të hartuara nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave për këtë qëllim, Gjykata konstaton se ato nuk përmbajnë të dhëna ose informacione në funksion të konsultimit publik të projektligjit që në fazën e hershme, përpara miratimit të tij nga Kuvendi, ndonëse aktet ndërkombëtare parashikojnë detyrimin për informimin e publikut përgjatë gjithë procesit. Po kështu, ndërsa propozues për ndërmarrjen e nismës legjislative ka qenë Këshilli i Ministrave, relacioni shoqërues i projektligjit të hartuar prej tij nuk përmban informacion në këtë aspekt. Gjykata vëren se edhe në prapësimet e parashtruara në seancë, subjektet e interesuara nuk arritën të provojnë realizimin e këtij procesi gjatë fazës përpara miratimit të ligjit nr. 38/2021 dhe kryerja e konsultimit publik nuk rezulton as nga të dhënat e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike. Gjatë seancës plenare Kuvendi pranoi se, për shkak të karakterit procedural të tij, projektligji nuk i është nënshtruar konsultimit paraprak nga publiku, pasi, sipas tij, është pikërisht faza aktuale në të cilën ndodhet zbatimi i ligjit, e cila i nënshtrohet këtij konsultimi, ndërsa Këshilli i Ministrave prapësoi se ai përfshihet në aktet e parashikuara nga neni 4 i ligjit nr. 146/2014, ndaj të cilave nuk zbatohen rregullat e konsultimit publik.

59. Gjykata vlerëson se prapësimet e subjekteve të interesuara nuk qëndrojnë në rastin konkret, pasi pavarësisht parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 146/2014, detyrimi për informim për gjendjen e mjedisit vjen drejtpërdrejt nga neni 56 i Kushtetutës, si dhe nga nenet 6 dhe 8 të Konventës së Aarhusit, të cilat parashikojnë shprehimisht detyrimin e shtetit për të garantuar pjesëmarrjen efektive të publikut që *në fazat fillestare të përgatitjes* nga autoritetet shtetërore të akteve rregullatore në rastet e veprimtarive që mund të sjellin pasoja në mjedis; për të informuar publikun e interesuar në lidhje me veprimtarinë e propozuar, vendimmarrjet që disponohen në momentin e procedurës së pjesëmarrjes së publikut, informacionin e disponueshëm mjedisor, të drejtën për të bërë pyetje dhe komente, mundësinë për të marrë pjesë në vendimmarrje, të drejtën për të marrë informacion të detajuar në lidhje me vendin dhe karakteristikat fizike e teknike të veprimtarisë së propozuar, efektet e veprimtarisë në mjedis, masat e parashikuara për parandaluar ose pakësuar këto efekte, si dhe një përmbledhje joteknike të këtyre pikave; për vendimin e marrë, si dhe për ta bërë të disponueshëm përmbajtjen e tij, së bashku me arsyet dhe konsideratat mbi të cilat është bazuar.

60. Po në këtë aspekt, Gjykata vëren se edhe sipas jurisprudencës së gjykatave homologe, shqetësimet mjedisore duhet të adresohen përpara se të disponohen të dhëna të plota shkencore për ndikimet negative mjedisore të aktivitetit të propozuar. Kur ka arsye të vlefshme për të dyshuar se aktiviteti i propozuar do të ketë një efekt negativ në mjedis, duhet të merren masa paraprake dhe, nëse është e nevojshme, aktiviteti duhet të ndalohet *(shih vendimin për çështjen nr. 2007-11-03, datë 17.1.2008 të Gjykatës Kushtetuese të Letonisë)*.

61. Për sa më lart, në këndvështrim të detyrimeve që neni 56 i Kushtetutës dhe Konventa e Aarhusit

vendosin ndaj autoriteteve shtetërore përpara ndërmarrjes së veprimtarive ose projekteve me ndikim në mjedis dhe në të drejta të tjera themelore të lidhura me të, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve për cenimin e së drejtës për informim publik, si rrjedhojë e mosrealizimit të procesit të konsultimit publik të ligjit objekt kundërshtimi gjatë fazës së miratimit të tij, pavarësisht se standardet ndërkombëtare kërkojnë konsultimin e publikut që në fazat e hershme të ndërmarrjes së veprimtarive ose aktiviteteve me ndikim në mjedis, janë të bazuara, për rrjedhojë çmon se procedura e miratimit të ligjit nr. 38/2021 është bërë në shkelje të së drejtës për informim për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, të garantuar nga këto akte.

62. Krahas sa më sipër, Gjykata konstaton se sipas ligjit nr. 38/2021 procesi për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës është planifikuar të zbatohet në dy faza, ku faza e parë përfshin aktivitetet paraprake të punës që do t'i mundësojnë shoqërisë "Bechtel" të paraqesë një propozim tek autoriteti kontraktues, KESH-i, për kontratën e fazës së dytë, e cila do të miratohet me ligj të Kuvendit, nëse palët do të finalizojnë kontratën e fazës së parë. Aktualisht, projekti ndodhet ende në fazën e parë, gjatë së cilës autoritetet shtetërore rezulton të kenë ndërmarrë disa hapa, të tillë si: (i) kryerja e studimeve ekologjike, gjeologjike, hidrologjike, gjeoteknike dhe e studimeve paraprake të gjendjes sociale; (ii) hartimi i raportit të vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social të projektit, i cili rezulton të jetë publikuar në faqen zyrtare të KESH-it, duke u bërë në këtë mënyrë i aksesueshëm për publikun e gjerë; (iii) informimi i komuniteteve lokale për statusin e projektit; (iv) mbledhja e informacionit bazë dhe e komenteve nga pjesëmarrësit; (v) mbajtja e takimeve me pjesëmarrjen e kryetarëve të bashkive, kryepleqve dhe përfaqësuesve të institucioneve të nivelit kombëtar si Agjencia Kombëtare e Mjedisit *(AKM)*, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Drejtoria Rajonale e Arsimit; (vi) prezantimi i statusit të projektit te komunitetet e ndikuara drejtpërsëdrejti ose në mënyrë indirekte; (vii) zhvillimi i diskutimeve, pyetësorëve, vizitave në terren dhe intervistave të drejtpërdrejta; (viii) zhvillimi i takimeve në 14 fshatra të ndodhura në zonën e projektit.

63. Po kështu, sipas materialeve të vëna në dispozicion nga subjektet e interesuara, Gjykata vëren se për qëllime të përmbylljes së fazës së parë të projektit janë planifikuar edhe një sërë aktivitetesh me qëllim përfshirjen në proces edhe të publikut të interesuar që nuk ka marrë pjesë në fazat e mëparshme. Gjatë kësaj faze do të ndërmerren edhe një sërë angazhimesh të tjera, si: konsultimi i AKM-së me ministritë, institucionet e tjera, publikun dhe organizatat jofitimprurëse për çështjet që kërkojnë të trajtohen në VNMS-në e thelluar; hartimi i raportit të thelluar të VNMS-së, duke marrë parasysh opinionet e dhëna gjatë konsultimeve; bërja publike dhe konsultimi me publikun e interesuar i Planit të Veprimit të Zhvendosjes të popullsisë së prekur, i cili do të kryhet duke pasur parasysh standardet e Korporatës Ndërkombëtare Financiare; realizimi i dëgjesave publike në lidhje me konkluzionet e arritura në raportin e VNMS-së dhe Planin e Veprimit të Zhvendosjes, ku ky i fundit, krahas përcaktimit të numrit të popullsisë së prekur, do të përmbajë edhe të dhënat e studimeve të kryera për vlerën e kompensimit të pronës, në drejtim të përcaktimit të kostos së zëvendësimit të tokës dhe aseteve; përfundimi i projektit paraprak; përfundimi i preventivit paraprak të sasive dhe kostove, sipas projektit paraprak; përfundimi i projektit bazë (FEED); realizimi i vlerësimit social mjedisor, i cili pritet të përfundohet brenda 6-mujorit të parë të vitit 2024; përfundimi i kuadrit të politikave të zhvendosjes, i cili do të finalizohet së bashku me VNMS-në; përfundimi i planit të zhvillimit të vendit të projektit dhe zbatimit të tij; vlerësimi i mundësive të financimit; realizimi i preventivit paraprak të sasive dhe kostove.

64. Për sa më sipër, Gjykata vëren se procedura e miratimit të ligjit nr. 38/2021 është zhvilluar pa konsultime publike, pa u dëgjuar opinioni i komunitetit të zonës, me statusin e publikut të ndikuar, si dhe pa u bërë vlerësimi i ndikimit të projektit në mjedis dhe në të drejta të tjera të lidhura me të. Megjithatë, duke pasur parasysh se projekti ndodhet ende në fazën e parë të zbatimit, gjatë së cilës janë parashikuar një sërë aktivitetesh, të tilla si: a) matje topografike dhe studime hidrologjike në mbështetje të zhvillimit të projektimit; b) studime dhe inspektime gjeoteknike në terren; c) zhvillim të strategjisë për realizimin e projektit; ç) rishikim dhe finalizim të vlerësimit të ndikimit mjedisor e social; d) përgatitje të projektit teknik, përfshirë përzgjedhjen e furnitorit të turbinave, me qëllim preventimin e kostove dhe të sasive; dh) shërbime të

tjera të dakordësuara për të mundësuar ecurinë e zhvillimit të projektimit të hidrocentralit të Skavicës, aktivitete këto të cilat parashikojnë edhe angazhimin edhe pjesëmarrjen e publikut të prekur, Gjykata vlerëson se, në përputhje me detyrimet që përcaktojnë neni 56 i Kushtetutës dhe Konventa e Aarhusit, shkeljet e konstatuara gjatë fazës përpara miratimit të ligjit nr. 38/2021 mund të riparohen ende përmes përfshirjes së publikut në veprimtari dhe informacione që lidhen me fazat e ndryshme në vijim të zhvillimit dhe zbatimit të projektit, si dhe në vendimmarrje.

65. Në këndvështrim të sa më lart, Gjykata thekson detyrimin që kanë autoritetet publike të përfshira për të zbatuar nenin 8 të Konventës së Aarhusit për të garantuar pjesëmarrjen e publikut gjatë gjithë fazave të procesit të projektimit dhe ndërtimit të projektit të HEC-it të Skavicës, si dhe për të marrë në konsideratë rezultatet e procesit të informimit për mbrojtjen e mjedisit, për aq sa është e mundur. Në këtë drejtim, Gjykata thekson rëndësinë e ushtrimit efektiv të së drejtës për të marrë informacion të plotë, në veçanti nga publiku që rrezikon të preket nga realizimi i projektit, për të dhënat që do të mblidhen në përfundim të fazës së parë nga autoritetet e përfshira; aktet e hartuara deri tani; veprimtaritë konkrete të realizuara dhe që priten të realizohen; natyrën e vendimeve të marra ose që mund të merren dhe autoritetin publik përgjegjës për marrjen e tyre; procedurën e parashikuar për masat që do të ndërmerren; kohën dhe vendin e mbledhjeve publike dhe mundësinë e publikut për të marrë pjesë; studimet e kryera dhe raportet e hartuara; gjetjet në lidhje me efektet e mundshme të projektit; masat e parashikuara për pakësimin e këtyre efekteve; vendimmarrjen në lidhje me projektin dhe arsyet mbi të cilat është bazuar kjo vendimmarrje, si dhe në lidhje me vijueshmërinë e fazës së dytë të projektit.

66. Duke pasur parasysh rëndësinë thelbësore që informimi, konsultimi, pjesëmarrja e publikut dhe negocimi kanë në garantimin e së drejtës për të marrë informacion për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, Gjykata çmon se, edhe në fazën në të cilën projekti ndodhet aktualisht, ekziston mundësia e përfshirjes së publikut në të dhënat që disponohen, studimet, projektet, planet dhe vendimmarrjet, si dhe në hapa të tjerë që do të ndërmerren në kuadër të përfundimit të fazës së parë të projektit. Kjo do t'i japë mundësinë publikut të prekur të shprehë, vetë ose përmes organeve përfaqësuese këshillimore, pikëpamjet, opinionet e vlerësimet e tij në lidhje me realizimin e projektit dhe efektet e mundshme të HEC-it në mjedis dhe të drejtat e liritë themelore të lidhura me të, si dhe të paraqesë komente, informacione, analiza ose opinione që i konsideron të vlefshme. Duke garantuar përfshirjen e publikut të prekur në çdo etapë të procesit do të mund të realizohet ushtrimi efektiv i së drejtës së tij për të marrë informacion për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij, si një premisë për të garantuar një proces të drejtë e transparent vendimmarrës nga ana e autoriteteve publike, bazuar në një kuadër të plotë informativ mbi efektet e projektit, çka sjell garantimin e së drejtës për një mjedis të shëndetshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

67. Në përmbledhje të analizës së lartpërmendur, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij është i bazuar. Sikurse u theksua më sipër, duke marrë parasysh se shkelja është e riparueshme, Gjykata çmon se nuk ka vend për shfuqizimin e ligjit nr. 38/2021, për rrjedhojë ajo vlerëson të shprehet vetëm për konstatimin e shkeljes së të drejtës për informim për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, të garantuar nga neni 56 i Kushtetutës dhe Konventa e Aarhusit, në procedurat e miratimit të këtij ligji.

68. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa është e bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese , në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "a" dhe 134, pikat 1, shkronja "h" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Konstatimin e shkeljes së të drejtës për informim për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, të garantuar nga neni 56 i Kushtetutës, në procedurat e miratimit të ligjit nr. 38/2021.

2. Urdhërimin e autoriteteve publike për të riparuar shkeljen e konstatuar dhe për të garantuar

të drejtën për informim gjatë fazës së parë të zbatimit të ligjit nr. 38/2021.

3. Detyrimin për marrjen parasysh në vijim të rezultateve të procesit të informimit për mbrojtjen e mjedisit, për aq sa është e mundur, në zbatim të nenit 8 të Konventës së Aarhusit.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 30.1.2024.
Shpallur, më 29.2.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

VENDIM
Nr. 00-2023-2241 (312), datë 16.11.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Ilir Panda	kryesues;
Medi Bici	anëtar;
Sokol Binaj	anëtar;
Albana Boksi	anëtare;
Sandër Simoni	anëtar,

sot, më datë 16.11.2023, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen penale nr. 61014-00523-00-2023 akti, që i përket:

KËRKUES: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

OBJEKTI: Parashtrimi i qëndrimit për mosmarrëveshjen e kompetencës

BAZA LIGJORE: Nenet 89 dhe 90 të Kodit të Procedurës Penale

Në çështjen penale me palë:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

PERSON NËN HETIM: Fatmir Mina

VIKTIMA: Fatime Llani

OBJEKTI: Pushimin e procedimit penal nr. 566, të vitit 2022, në ngarkim të shtetasit Fatmir Mina.

Caktimin e masës mjekësore ndaj tij sipas përcaktimit të bërë nga ekspertët e Institutit të Mjekësisë Ligjore.

BAZA LIGJORE: Neni 46 i Kodit Penal dhe nenet 46 e 329/a të Kodit të Procedurës Penale

OLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Medi Bici; prokurorin pranë Prokurorisë së Përgjithshme Alfred Progonati, i cili kërkoi dërgimin e akteve gjyqtarit të seancës paraprake pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë; mbrojtësin e caktuar kryesisht, avokat Sokol Kepi, i cili kërkoi dërgimin e çështjes pranë gjyqtarit të seancës paraprake dhe e bisedoi çështjen në tërësi, në përfundim;

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes:

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar procedimin penal nr. 556/2022, në ngarkim të shtetasit Fatmir Mina, i akuzuar për veprat penale "Dhuna në familje" dhe "Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit", të parashikuara nga nenet 130/a, paragrafi 1 e 323 të Kodit Penal (në vijim KP) dhe në përfundim të hetimeve, ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë kërkesën, me objekt: Pushimin e procedimit penal nr. 566, të vitit 2022, në ngarkim të shtetasit Fatmir Mina. Caktimin e masës mjekësore ndaj tij sipas përcaktimit të bërë nga ekspertët e Institutit të Mjekësisë Ligjore.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (gjyqtari i seancës paraprake), me vendimin nr. 112, datë 27.4.2023, ka vendosur:

Pranimin e kërkesës. Pushimin e procedimit penal nr. 556, të vitit 2022, për veprën penale "Dhuna në familje", parashikuar nga neni 130/a/1 i KP, në ngarkim të personit nën hetim Fatmir Mina. Dërgimin për gjykim pranë gjykatës kompetente, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë të procedimit penal nr. 556, të viti 2022, për caktimin e masës mjekësore për shtetasin nën hetim Fatmir Mina.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (gjyqtari i seancës paraprake), ndër të tjera ka arsyetuar se: "*...Kërkesa e prokurorit në rastin konkret gjen parashikim në nenin 329/a të KPP, ku i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes. (...) rezulton e provuar se personi nën hetim ka konsumuar elementet e veprave penale "Dhuna në familje", parashikuar nga neni 130/a/1 i KP dhe "Largim nga vendi i qëndrimit", parashikuar nga neni 323 i KP, por për shkak të gjendjes së tij mendore, ekziston një shkak që nuk lejon vazhdimin e procedimit, pasi ashtu sikurse u theksua edhe më sipër,*

referuar aktit të ekspertimit psikiatriko-ligjor nr. 293, datë 29.4.2022 (akt ekspertimi i kryer në kuadër të procedimit penal nr. 2080/2021) ai ka qenë në kushtet e papërgjegjshmërisë para kryerjes së veprës dhe pas saj. Sa më sipër, gjykata konkludon se kërkesa e prokurorisë është bazuar dhe si e tillë duhet të pranohet duke vendosur pushimin e procedimit penal nr. 566, i vitit 2022 për veprat penale "Dhuna në familje", parashikuar nga neni 130/a/1 i KP dhe "Largimi nga vendi i qëndrimit", parashikuar nga neni 323 i KP, për personin nën hetim, duke qenë se ekziston një shkak për të cilin ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë në kuptim të nenit 328/d të KPP. Në lidhje me kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës mjekësore ndaj personit nën hetim, në zbatim të nenit 46 të KP, gjykata vlerëson të theksojë faktin se kjo kërkesë duhet të jetë objekt shqyrtimi nga gjykata e themelit, pasi referuar dispozitave të KPP gjykata e seancës paraprake nuk mund të marrë prova të reja dhe ajo duhet të vendosi vetëm mbi bazën e akteve që i ka bashkëlidhur kërkesës organi i akuzës. Duke qenë se në rastin konkret është e domosdoshme të urdhërohet kryerja e një akti të ri ekspertimi psikiatriko-ligjor për të përcaktuar gjendjen mendore të personit nën hetim dhe masën mjekësore më të përshtatshme për të aktualisht, kjo kërkesë e organit të akuzës duhet t'i dërgohet gjykatës së themelit. (...) në rastin konkret, fashikulli i gjykimit duhet të përmbajë të gjitha aktet e kryera gjatë hetimeve paraprake, si dhe ato të seancës paraprake. Pra kjo kërkesë së bashku me të gjitha aktet e kryera gjatë hetimeve paraprake dhe ato të seancës paraprake duhet t'i bashkohet fashikullit të gjykimit, me qëllim që të merret në shqyrtim nga gjykata që do të gjykojë çështjen e themelit.".

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (gjyqtari i themelit), me vendim të datës 6.7.2023, ka vendosur:

Shpalljen e moskompetencës lëndore, në lidhje me shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt: Caktimin e masës mjekësore ndaj shtetasit Fatmir Mina. Dërgimin e akteve për kompetencë pranë gjyqtarit të seancës paraprake....

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (gjyqtari i themelit), ndër të tjera ka arsyetuar se: "...*Gjykata, kryesisht, në seancën gjyqësore të datës 6.7.2023, mori në shqyrtim konform nenit 83/1 të KPP, çështjen e kompetencës lëndore të saj, në lidhje me shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga ana e organit të prokurorisë për caktimin e masës mjekësore ndaj shtetasit Fatmir Mina. ... Gjykata vlerëson se, kompetenca lëndore në procesin gjyqësor penal përfaqëson parakusht procedural për marrjen në shqyrtim dhe zgjidhjen në themel të çështjeve, të cilat paraqiten për shqyrtim përpara gjykatës, për pasojë, mosrespektimi i dispozitave procedurale në lidhje me kompetencën lëndore, në dallim nga ajo tokësore, përfaqëson një mangësi themelore të procesit, e cila është e parikuperushme përmes ankimit në gjykatën më të lartë, edhe nëse çështja është zgjidhur drejt nga gjykata e shkallës së parë. Neni 329/a, pika 2 i KPP parashikon se: ... 2. Në rastet kur prokurori ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes shqyrtohet bashkarisht me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq. KPP, i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, për herë të parë në historinë e shtetit të së drejtës në Republikën e Shqipërisë, mbështetur edhe në ndryshimet kushtetuese, të miratuara me ligjin nr. 76, datë 22.7.2016, ka parashikuar jo vetëm një subjekt të ri procedural (gjyqtarin e seancës paraprake), por edhe një fazë të re të procedimit penal, e ndryshme nga procedimi penal klasik (faza e hetimit dhe gjykimit), ajo e seancës paraprake, e cila ka në themel këto elemente: i. Së pari, rritjen e efektivitetit dhe eficiencës së ndjekjes penale, sipas parimit të ligjshmërisë; ii. Së dyti, respektimin e së drejtës së personit nën hetim, të pandehurit për një proces të rregullt ligjor (hetimor dhe gjyqësor); iii. Së treti, respektimin e parimit kushtetues të hetimit dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor; iv. Së katërti, respektimin e parimit të ekonomisë gjyqësore. v. Së pesti, respektimin dhe garantimin e të drejtave të viktimës në procesin hetimor dhe gjyqësor penal; vi. Së gjashti, garantimin e parimit kushtetues, të dhënies së drejtësisë nga gjykata. Me ndryshimet e bëra në KPP, me ligjin nr. 35/2017, rezulton se, është parashikuar rishtazi, figura procedurale e gjyqtarit të seancës paraprake, në kompetencë të të cilit, përfshihen ato kategori çështjesh (ratione materia), të cilat nga pikëpamja kohore (ratione temporis) vijnë menjëherë pas përfundimit të hetimeve paraprake, por përpara fazës së gjykimit dhe të cilat, konsistojnë në mënyrën e përfundimit të veprimtarisë hetimore të prokurorit, i cili pasi ka ushtruar ndjekjen penale, sipas nenit 148 të Kushtetutës dhe sipas neneve 278 e vijues të KPP, mbështetur në parimin e ligjshmërisë, mund t'i kërkojë gjyqtarit të seancës paraprake: i. Dërgimin e çështjes në gjykim (neni 331 i KPP); ii. Pushimin e akuzës ose të procedimit penal, në rastin kur ndodhemi përpara krimeve (neni 329/a i KPP).*

5.1 *Duke pasur në konsideratë sa më sipër, si dhe nga interpretimi teleologjik i pikës 2 të nenit 329/a të KPP, gjykata vlerëson se, edhe në rastet kur, në përfundim të hetimeve paraprake të një procedimi penal, nga ana e prokurorit paraqitet kërkesë pranë gjyqtarit të seancës paraprake për pushimin e procedimit penal dhe caktimin e masës mjekësore ndaj personit nën hetim, kompetencën lëndore për shqyrtimin e kësaj kërkese në të dy kërkimet e saj, e ka gjyqtari i seancës paraprake, i cili pasi vlerëson se janë kushtet për pushimin e procedimit penal nga ato të parashikuara nga neni 328/1 i KPP (në rastin konkret, pushimi i procedimit*

penal vjen për shkak të papërgjegjshmërisë së personit nën hetim), disponon për pushimin e procedimit penal dhe caktimin e masës mjekësore ndaj personit konkret. Në vlerësimin e kësaj gjykate, ky konkluzion është rrjedhojë logjike edhe faza e seancës paraprake, si një fazë e ndërmjetme procedurale midis hetimit paraprak dhe gjykimit, duke i dhënë prevalencë parimit të ekonomisë gjyqësore, si dhe rritjes së eficiencës gjyqësore. Parë në këtë këndvështrim, kjo gjykatë vlerëson se, nuk është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga ana e organit të prokurorisë për caktimin e masës mjekësore ndaj shtetasit Fatmir Mina, për pasojë në rastin konkret duhet disponuar me shpalljen e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e akteve për kompetencë pranë gjyqtarit të seancës paraprake ku është regjistruar fillimisht kërkesa e organit të prokurorisë për pushimin e procedimit penal nr. 566, të vitit 2022 dhe caktimin e masës mjekësore ndaj shtetasit Fatmir Mina, i dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 130/a/1 dhe 323 të KP.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (gjyqtari i seancës paraprake), në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 247 (70110-00919-61-2023) Regjistrit Themeltar, datë 31.7.2023, ka vendosur:

Parashtrimin e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore/funksionale pranë Gjykatës së Lartë, lidhur me shqyrtimin e kërkesës, me objekt: Caktimin e masës mjekësore ndaj tij sipas përcaktimit të bërë nga ekspertët e Institutit të Mjekësisë Ligjore, duke argumentuar se kjo kërkesë duhet të shqyrtohet nga gjyqtari i themelit.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (gjyqtari i seancës paraprake), ndër të tjera, arsyeton se: "*... Gjyqtari i themelit në rast të vlerësimit apo konstatimit të mospasjes së kompetencës lëndore për shqyrtimin e kërkesës penale, duhej që qëndrimin e tij t'ia parashtronte Gjykatës së Lartë, pasi disponimi nga Gjyqtari i Themelit, me vendimin e datës 6.7.2023 për: Shpalljen e moskompetencës lëndore .... nuk është në zbatim të drejtë të ligjit procedural penal, edhe pse aktualisht jemi para këtij fakti dhe çështja është rishortuar; duke i ka kaluar për gjykim përsëri gjyqtarit të seancës paraprake. … gjyqtari i themelit ka disponuar duke tejkaluar dispozitat ligjore, duke marrë kompetencat në një gjykatë më të lartë. … Në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës, pra moskompetencës funksionale të gjyqtarit të seancës paraprake për marrjen në shqyrtim dhe caktimin e masës mjekësore, dhe dërgimin për gjykim gjyqtarit të themelit, gjykata ka vlerësuar: (...) Në interpretim sistematik të nenit 46 të KP, kërkohet plotësimi kumulativ i kushteve, së pari, të jetë kryer një vepër penale të paktën nga ana objektive, së dyti, vepra penale të jetë kryer nga personi, që në kohën e kryerjes së krimit, vuante nga një turbullim psikik/neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin mendor dhe nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet/mosveprimet dhe as të kuptojë se kryen vepër penale, dhe së treti, të provohet autorësia e krimit, gjykim, i cili zhvillohet nga gjyqtari i themelit (GJTH) dhe jo nga gjyqtari i seancës paraprake (GJSP). Ndaj në kushtet që duhet të urdhërohet kryerja e aktit të ekpertimit psikiatriko-ligjor, për të vlerësuar gjendjen mendore të personit nën hetim, si dhe me caktimin e masës mjekësore, për rrjedhojë kjo kërkesë e organit të akuzës duhet t'i dërgohet gjykatës së themelit...Gjykata në arsyetimin e saj i referohet edhe vendimit nr. 146, datë 3.3.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit nuk është kompetencë e GJSP, verifikimi i kushteve kumulative të dispozitës së sipërcituar, pra çmuarja dhe provueshmëria e akuzës në ngarkim të personit nën hetim, kjo është në kompetencën funksionale të gjyqtarit të themelit (GJTH) të çështjes... Gjithashtu, në vendimin nr. 1086, datë 21.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në të cilin arsyetohet se… gjykata që ka dhënë vendimin është dhe gjykata kompetente për (ri)shqyrtimin e këtij vendimi pas një viti (...). Gjykata vlerëson se, edhe pse vendimi i sipërcituar, lidhet me konfliktin e kompetencës tokësore të gjykatave për shqyrtimin e kërkesës për rivlerësimin e masës mjekësore, në këtë vendim Gjykata e Lartë, ka mbajtur qëndrimin se shqyrtimi i kërkesës për rivlerësimin apo caktimin e masës mjekësore shqyrtohet nga gjykata e themelit, pasi duke qenë një gjykim i posaçëm, gjykata ka detyrimin të vërtetojë se, fakti penal ka ndodhur dhe personi i akuzuar e ka kryer atë, si dhe të verifikimit të përgjegjësisë penale të një personi që ka kryer një vepër penale, që lidhet me kohën kur është kryer vepra, sipas nenit 17 të KP dhe si rrjedhojë çmuarja dhe vleftësimi i provave në drejtim të provueshmërisë së fajësisë apo pafajësisë së personit nën hetim, kryhet gjatë shqyrtimit të çështjes në themel.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë:

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) konstaton ekzistencën e mosmarrëveshjes për kompetencën lëndore/funksionale, ndërmjet gjyqtarit të seancës paraprake të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe gjyqtarit të themelit të po kësaj gjykate, për sa i përket gjykimit të kërkesës së paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt: Caktim mase mjekësore.

9. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në dhomë këshillimi, Kolegji konstatoi qëndrime të ndryshme të gjykatave në drejtim të shqyrtimit të kërkesave, me objekt: Caktimin e masës mjekësore, të parashikuar

nga neni 46 i KP. Kërkesa për caktimin e masave mjekësore ndaj personave të papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore buron nga parashikimet e nenit 46 të KP dhe 46 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim KPP), ku përcaktohet se organi kompetent për të vendosur masën mjekësore është gjykata, pa bërë ndarjen e gjyqtarit të seancës paraprake nga gjyqtari që gjykon çështjen në themel[6]. Kolegji vë në dukje se këto dispozita ligjore nuk janë harmonizuar me ndryshimet e KPP, të vitit 2017, ku u parashikua për herë të parë figura e "gjyqtarit të seancës paraprake" dhe kompetencat e tij.

10. Sa më sipër, ka sjellë qëndrime të ndryshme në praktikën gjyqësore, pasqyrim i të cilave është edhe parashtrimi i mosmarrëveshjes për kompetencën funksionale në rastin konkret, ndërmjet "gjyqtarit të seancës paraprake" dhe "gjyqtarit të gjykimit të çështjes në themel", lidhur me caktimin e masave mjekësore, sipas nenit 46 të KP. Gjithashtu, Kolegji konstaton se mungesa e harmonizimit të dispozitave ligjore ka krijuar vështirësi edhe për organin e prokurorisë, lidhur me procedurën që duhet të ndjekë për caktimin e masave mjekësore ndaj personit të papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore, për të cilin ka dyshime se ka kryer vepër penale dhe paraqet rrezikshmëri shoqërore.

11. Në vijim të kësaj analize, Kolegji verifikoi qëndrimet e ndryshme të praktikës gjyqësore, në lidhje me procedurën për caktimin e masave mjekësore në procesin penal, duke evidentuar sa vijon:

11.1 Prokuroria paraqet kërkesë për pushimin e çështjes dhe caktimin e masës mjekësore, ndaj personit nën hetim. Gjyqtari i seancës paraprake ka argumentuar se ka kompetencë funksionale për të vendosur edhe për pushimin e akuzës/çështjes për shkak të papërgjegjshmërisë së personit nën hetim dhe për caktimin eventual të një mase mjekësore ndaj tij.

11.2 Prokuroria paraqet kërkesë për pushimin e çështjes dhe caktimin e masës mjekësore ndaj personit nën hetim. Në këtë rast, gjyqtari i seancës paraprake ka vlerësuar se është kompetent të shprehet vetëm lidhur me kërkimin e parë (pushimin e çështjes), duke vendosur dërgimin e çështjes në gjykatën që shqyrton çështjen në themel për t'u shprehur për caktimin e masës mjekësore.

11.3 Prokuroria duhet të paraqesë kërkesë vetëm për caktimin e masës mjekësore, kërkesë e cila duhet të shqyrtohet nga gjykata që shqyrton çështjen në themel. Sipas këtij qëndrimi, kërkimet për pushim të çështjes dhe për caktimin e masës mjekësore, janë në kundërshtim me njëra-tjetrën, pasi nuk mund të kërkohen bashkërisht. Nëse prokuroria paraqet kërkesë me të dyja kërkimet, gjyqtari i seancës paraprake vendos kthimin e akteve prokurorit.

11.4 Nëse në seancën paraprake është vendosur pranimi i kërkimit të prokurorisë për pushimin e çështjes, si dhe dërgimi i çështjes në gjykatën e shqyrtimit në themel për t'u shprehur në lidhje me kërkimin për caktimin e masës mjekësore (pra, nëse është zbatuar varianti i dytë, i përmendur më lart), gjykata e shqyrtimit të çështjes në themel ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Arsyetimi i gjykatës në këtë rast është bazuar në faktin se me pushimin e çështjes, mungon një nga kushtet për të proceduar (për shkak të mungesës së procedimit penal). Sipas këtij qëndrimi, përderisa procedimi penal në ngarkim të personit nën hetim është pushuar (nga gjyqtari i seancës paraprake), gjykata që shqyrton çështjen në themel është në "pamundësi absolute për të caktuar masë mjekësore ndaj tij". Në një rast të tillë, gjykata ka zbatuar legjislacionin për shëndetin mendor, por jo parashikimet që bëhen në nenin 46 të KP.

11.5 Në rastin e fundit, konstatohet paraqitja e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq nga prokurori, ndërkohë që gjyqtari i seancës paraprake ka dyshime, në lidhje me papërgjegjshmërinë e të pandehurit për shkak të gjendjes mendore. Në këtë rast, gjyqtari i seancës paraprake ka urdhëruar plotësimin e hetimeve, duke u kryer ekspertimi psikiatriko-ligjor i të pandehurit.

12. Kolegji, për të krijuar një pamje sa më të plotë të problematikave të ndeshura në rastin e caktimit të masave mjekësore, ka evidentuar edhe argumentet thelbësore të gjykatave në qëndrimet e cituara më sipër. Konkretisht, gjykata/gjyqtari i seancës paraprake ka argumentuar:

[6] Neni 46, pika 1 i KP-së parashikon : *"Masat mjekësore mund të jepen nga gjykata …", ndërsa neni 46 i KPP parashikon se: "1.… gjykata, vendos, edhe kryesisht shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik … 2. Kur është vendosur ose duhet vendosur masa mjekësore e detyrueshme për të pandehurin, gjykata urdhëron që i pandehuri të ruhet në një institucion psikiatrik … 3. Gjatë hetimeve paraprake, prokurori i kërkon gjykatës të vendosë për shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik …".*

12.1 Caktimi i masës mjekësore është kërkim i ndërvarur dhe rrjedhimisht pason vendimin për pushimin e çështjes, kur plotësohen kushtet e përcaktuara nga neni 46 i KP. Rrjedhimisht, e njëjta gjykatë duhet të "zgjidh" edhe pasojat.

12.2 Nëse pranohet kërkesa për pushimin e çështjes, rrjedhimisht do të shuhen edhe masat e sigurimit siç parashikon ligji. Kjo nënkupton që persona të papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore dhe të rrezikshëm, të cilët janë hetuar me masë sigurimi "Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik" të lirohen dhe të vijojnë të jenë të lirë derisa të gjykohet kërkesa për caktimin e masës mjekësore.

12.3 Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) mban qëndrimin se mjafton që kufizimi i lirisë (caktimi i masës mjekësore) të ketë kaluar filtrin gjyqësor ose të ligjit të posaçëm, në mënyrë që të konsiderohet në përputhje me nenin 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Pra, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së nuk ka rëndësi emërtesa që merr gjykata "paraprake", "themeli", apo çdo emërtesë tjetër.

12.4 Gjyqtari i seancës paraprake në thelb bën të gjitha vlerësimet e gjyqtarit të themelit në lidhje me akuzën, por nuk cakton masë dënimi. Në momentin që vlerëson njërin nga komponentët e përgjegjësisë penale, pra përgjegjshmërinë për shkak të gjendjes mendore të subjektit që ka kryer veprën penale, detyrimisht duhet të konstatojë edhe ekzistencën e elementeve të tjera të figurës së veprës penale, pasi në të kundërt ai nuk do ta pushonte procedimin me atë shkak, por për ndonjë një shkak tjetër, të parashikuar në nenin 328/1 të KPP.

12.5 Masa mjekësore në thelb nuk është një dënim klasik, i cili individualizohet sipas rrezikshmërisë së veprës penale, autorit të saj dhe rrethanave lehtësuese e rënduese. Ajo ka në fokus shëndetin e autorit të veprës penale dhe njëkohësisht mbrojtjen e interesit publik.

13. Nga ana tjetër, gjyqtarët që kanë disponuar dërgimin për gjykim të masës mjekësore, kanë arsyetuar si më poshtë:

13.1 Gjykata në këto raste cakton "dënim" dhe e vetmja gjykatë që mund të caktojë "dënim" është gjykata e themelit. Masat mjekësore, neni 46 i KP, i konsideron dënim të një lloji të veçantë, por që në thelb është dënim.

13.2 Është gjykata e themelit ajo që analizon përgjegjësinë penale (ekzistencën e veprës penale) dhe cakton masën mjekësore.

13.3 Nuk parashikohet si mënyrë disponimi apo kompetencë e gjyqtarit të seancës paraprake caktimi i masës mjekësore.

14. Për sa parashtruam më sipër, Kolegji vlerëson se ndodhemi në kushtet kur duhet të shprehet me një vendimmarrje njësuese, në zbatim të nenit 438/1 të KPP, i cili parashikon: "*Kolegji Penal, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë nisjen e procedurës së gjykimit për të njësuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore*". Me vendimin e datës 28.9.2023, Kolegji ka vendosur: Kalimin e çështjes penale nr. 61014-523-2023, datë regjistrimi 4.9.2023, për shqyrtim në seancë gjyqësore, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjet: ... 1. Cila është procedura që duhet të ndiqet nga prokurori lidhur me caktimin e masës mjekësore ndaj personit të papërgjegjshëm për të cilin dyshohet se ka kryer vepër penale, në kushtet kur, sipas neneve 290 dhe 328 të KPP, procedimi penal për raste të tilla nuk duhet të fillojë ose nëse ka filluar duhet të pushohet? 2. Cila është gjykata kompetente dhe mënyra e disponimit të saj për caktimin e masave mjekësore, në kushtet kur, sipas neneve 328 dhe 332/dh, paragrafi 1, shkronja "ç" të KPP, çështja penale për raste të tilla duhet të pushohet? Në lidhje me këtë çështje, Kolegji i ka kërkuar mendimin e Ministrisë së Drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 438/7 të KPP, e cila ka paraqitur mendim e saj në lidhje me çështjen e shtruar për njësim, mendim i cili është publikuar sipas parashikimit ligjor. Ndërsa prokurori dhe mbrojtja mendimet e tyre i kanë shprehur në seancën gjyqësore, të zhvilluar në Gjykatën e Lartë.

15. Në funksion të trajtimit të çështjeve të shtruara për njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji fillimisht vlerëson të nevojshme të trajtojë natyrën dhe qëllimin e masave mjekësore, standardet ndërkombëtare të zbatueshme në këto raste, si dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. Kolegji në analizën e rastit konkret i është referuar edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës së Kasacionit në Itali, për shkak të ngjashmërisë që ka e drejta procedurale penale shqiptare me të drejtën procedurale penale italiane.

16. Kolegji thekson se në rastin e trajtimit të çështjeve që lidhen me caktimin e masave mjekësore për personat e papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore, duhet mbajtur në konsideratë se ato

gëzojnë të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme kushtetuese (ligji "Për shëndetin mendor" nr. 44/2012, i përditësuar, neni 6 i tij). Kërkesa për caktimin e masave mjekësore ndaj personave të papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore bazohet në parashikimet e nenit 46 të KP dhe nenit 46 të KPP. Ajo që duhet theksuar në këtë rast është fakti që kompetente për të vendosur masën mjekësore është gjykata. Në këtë vështrim, Kolegji thekson se standardet dhe instrumentet e rëndësishme ndërkombëtare theksojnë domosdoshmërinë e mbrojtjes së të drejtave dhe dinjitetin e personave me çrregullime të shëndetit mendor.[7] Kolegji thekson se në rastin e ndalimit/arrestimit të personit, i cili ka çrregullime të shëndetit mendor, duhen garantuar dy të drejta thelbësore procedurale: i. e drejta që ky person të ndihmohet nga një përfaqësues ose mbrojtës përgjatë procedurës; ii. ekspertimi i gjendjes mendore sa më shpejt të jetë e mundur për të përcaktuar jo thjesht përgjegjshmërinë e tij para ligjit, por edhe përcaktimin e trajtimit mjekësor të përshtatshëm në raport me nevojat e tij. Këto elemente janë theksuar edhe nga GJEDNJ-ja në çështjen Strazimiri kundër Shqipërisë, i cili do të trajtohet edhe në vijim të këtij vendimi. Kolegji vë në dukje se si legjislacioni material dhe procedural penal, ashtu edhe ligji për shëndetin mendor, parashikojnë ndërhyrjen e gjykatës në caktimin e masave mjekësore, pra zhvillimin e një procedure gjyqësore ku personit me probleme të shëndetit mendor t'i garantohen të drejtat procedurale që i njeh ligji. Gjykatat duhet të vendosin në bazë të ekspertimit psikiatriko-ligjor, duke marrë parasysh interesat e personit të sëmurë për një trajtim sa më të mirë dhe sa më të përshtatshëm për gjendjen e tij mendore (*shih GJEDNJ, Strazimiri kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 34602/16*).

17. Neni 46 i KP, me titull "Masat mjekësore dhe edukuese", parashikon: "*Masat mjekësore mund të jepen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepër penale, ndërsa masat edukuese mund të jepen ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale. Masat mjekësore janë: 1. Mjekimi i detyruar ambulator. 2. Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor. Vendimi gjyqësor për masat mjekësore dhe edukuese është i revokueshëm në çdo kohë kur zhduken rrethanat për të cilat ai është dhënë, por në çdo rast, gjykata, kryesisht, është e detyruar që pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit, të marrë në shqyrtim vendimin e saj*". Ndërsa, neni 46 i KPP me titull "Masat mjekësore të detyrueshme", parashikon: "*1. Në çdo rast kur gjendja mendore e të pandehurit tregon se ai duhet të kurohet, gjykata, vendos, edhe kryesisht shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik. 2. Kur është vendosur ose duhet vendosur masa mjekësore e detyrueshme për të pandehurin, gjykata urdhëron që i pandehuri të ruhet në një institucion psikiatrik. 3. Gjatë hetimeve paraprake, prokurori i kërkon gjykatës të vendosë për shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik dhe kur vonesa paraqet rrezik, urdhëron shtrimin e përkohshëm deri në marrjen e vendimit nga gjykata*".

18. Legjislacioni penal shqiptar, masat mjekësore i parashikon në kreun V, të pjesës së përgjithshme të KP, ku parashikohen dënimet penale. Pavarësisht se janë vendosur nga ligjvënësi në kreun e dënimeve, masat mjekësore nuk përfshihen në sistemin e dënimeve dhe ndryshojnë prej këtyre të fundit. Dënimi penal është një masë shtrënguese shtetërore që zbatohet kundër personave, të cilët kanë kryer vepra penale shoqërisht të rrezikshme dhe që sipas ligjit, kanë përgjegjësi penale. Për sa i përket *ratio-s (qëllimit)* të dënimit penal, Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, është shprehur se dënimi penal përmbush dy funksione të ndryshme, të cilat mund të konsiderohen si edukative. Nga njëra anë qëndron funksioni i parandalimit të përgjithshëm të veprave penale, pasi kërcënimi se shteti do të zbatojë sanksione penale sa herë që shtetasit do të kryejnë veprime të dënueshme nga legjislacioni penal, funksionon si një mënyrë për të dekurajuar dhe parandaluar cilindo nga shtetasit që të ndërmarrë veprime që bien në kundërshtim me normat penale. Nga ana tjetër qëndron funksioni i parandalimit të posaçëm, i cili lidhet drejtpërsëdrejti me autorin e veprës penale, pasi duke zbatuar sanksionin penal synohet riedukimi i tij në mënyrë që, pas kryerjes së dënimit, të mos ndërmarrë në të ardhmen veprime kriminale. Në përputhje me frymën e Kushtetutës, sanksioni penal i cilësdo natyre duhet të synojë vetëm riedukimin dhe më pas integrimin e të dënuarit në jetën shoqërore. Gjykata, duke pasur

[7] Në kuadrin e Këshillit të Evropës është me rëndësi të theksohet Rekomandimi 10(2004) i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare, instrument që së bashku me standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) synon mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave dhe lirive themelore të personave me çrregullime të shëndetit mendor, veçanërisht atyre personave që trajtohen në mënyrë të pavullnetshme.

parasysh dhe doktrinën e konsoliduar evropiane në këtë fushë, ka theksuar se, që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën penale të kryer. Në këtë mënyrë, që të mund të ketë një proces riedukativ të suksesshëm, duhet që ndëshkimi penal të perceptohet nga autori i veprës penale si i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën penale që ai ka kryer[8].

19. Nga ana tjetër, Kolegji vë në dukje se ndaj personave të papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore, caktohen masat mjekësore që në thelb nuk janë dënime penale. Zbatimi i dënimit ndaj këtyre personave jo vetëm që është i papranueshëm, sepse mungon elementi faj, por ai është dhe i padobishëm dhe pa ndonjë kuptim, pasi mbi këta persona nuk është i mundur ndikimi për edukimin dhe riedukimin e tyre (qëllimi i dënimit). Për sa më sipër, qëllimi i masave mjekësore nuk është ndëshkimi i personit që ka kryer një vepër penale, por kurimi i tij, si dhe parandalimi i kryerjes së veprave të tjera penale. Në sintezë, Kolegji thekson se në KP, masat e trajtimit të detyrueshëm nuk janë dënime penale, por janë masa të posaçme, masa *sui generis* të karakterit mjekësor, të cilat mund t'iu caktohen vetëm personave që kryejnë vepra penale, të cilët kanë çrregullime të shëndetit mendor.

20. GJEDNJ-ja, në kuadër të së drejtës për lirinë dhe sigurinë personale, neni 5 të KEDNJ-së, ka elaboruar praktikë gjyqësore në lidhje me ndalimin e personave që vuajnë nga sëmundje mendore. Një individ mund të paraqitet "me çrregullime të shëndetit mendor" dhe mund t'i nënshtrohet heqjes apo kufizimit të lirisë, vetëm atëherë kur verifikohen të paktën tre kushtet e mëposhtme *(shih Stanev k. Bullgarisë [DhM], § 145; D.D. k. Lituanisë, § 156; Kallweit k. Gjermanisë, § 45; Chtoukatourov k. Rusisë, § 114; Varbanov k. Bullgarisë, § 45, dhe Winterwerp k. Vendeve të Ulëta, § 39)*:

i. duhet të jetë përcaktuar në mënyrë bindëse sëmundja mendore e të interesuarit, me anë të një ekspertize mjekësore objektive, me përjashtim të rasteve kur nevojitet një shtrim i detyruar me urgjencë;

ii. çrregullimi mendor i të interesuarit duhet të ketë një karakter që e përligj shtrimin e detyruar. Duhet të provohet që heqja e lirisë ka qenë e domosdoshme, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes;

iii. sëmundja mendore e përcaktuar me anë të një ekspertize mjekësore objektive duhet të vazhdojë gjatë të gjithë kohës që zgjat shtrimi i detyruar.

21. GJEDNJ-ja ka theksuar se, asnjë heqje lirie e një personi të konsideruar me çrregullime të shëndetit mendor nuk mund të gjykohet në përputhje me nenin 5 të KEDNJ-së, në qoftë se ajo është vendosur pa marrë më parë mendimin e një mjeku ekspert *(Ruiz Rivera k. Zvicrës, § 59; S.R. k. Vendeve të Ulëta (vend. pran.), § 31)*. Për sa i përket të dytit, nga kushtet e përmendura më sipër, shtrimi i detyruar i një personi të prekur nga një çrregullim mendor mund të diktohet jo vetëm kur ky i fundit ka nevojë, për t'u shëruar ose për t'u bërë më mirë, për një terapi ose për çdo lloj trajtimi tjetër klinik, por edhe kur del se është e nevojshme që ai të mbikëqyret për të mos u lejuar që të dëmtojë veten ose të tjerët *(Hutchison Reid k. Mbretërisë së Bashkuar, § 52)*. Një çrregullim mendor duhet të paraqesë njëfarë serioziteti që të mund të konsiderohet si "real" *(Glien k. Gjermanisë, § 85)*. Autoriteteve kombëtare u lihet njëfarë kompetence apo hapësirë vlerësimi për t'u shprehur rreth çështjes nëse një individ duhet të shtrohet apo jo me detyrim si person me probleme të shëndetit mendor. Në këtë rast, autoritetet kompetente kombëtare duhet të vlerësojnë me kujdes provat që u paraqiten në një rast të caktuar *(shih Plesó k. Hungarisë, § 61; H.L. k. Mbretërisë së Bashkuar, § 98)*. Data me rëndësi në të cilën sëmundja mendore e personit në fjalë duhet të jetë përcaktuar në mënyrë bindëse në vështrim të kërkesave të pikës "e") të nenit 5 § 1 të KEDNJ-së, është ajo e marrjes së masës që i heq atij personi lirinë për shkak të çrregullimeve të shëndetit të tij mendor *(shih O.H. k. Gjermanisë, § 78)*.

22. Në rastin kur autoritetet kanë të dhëna mjekësore, të cilat tregojnë se personi në fjalë është shëruar, ato mund të kenë nevojë për pak kohë për të shqyrtuar nëse është me vend që t'i jepet fund shtrimit të tij *(Luberti k. Italisë, § 28)*. Sidoqoftë, lënia në fuqi e masës së heqjes së lirisë për arsye thjesht administrative nuk është e përligjur *(shih R.L. e M.-J.D. k. Francës, § 129)*. Ndalimi i një personi me çrregullim të shëndetit mendor duhet të bëhet në një spital, në një klinikë ose në një institucion tjetër të përshtatshëm e të lejuar për këtë lloj shërbimi *(L.B.*

[8] Vendim nr. 19, datë 1.6.2011, i Gjykatës Kushtetuese.

k. Belgjikës, § 93; Ashingdane k. Mbretërisë së Bashkuar, § 44; O.H. k. Gjermanisë, § 79). Megjithatë, një person mund të vendoset përkohësisht në një institucion jo të caktuar posaçërisht për shtrimin e të sëmurëve me çrregullim të shëndetit mendor përpara se të transferohet në një institucion të përshtatshëm, me kusht që periudha e pritjes të mos jetë tepër e gjatë *(shih Pankiewicz k. Polonisë, §§ 44–45; Morsink k. Vendeve të Ulëta, §§ 67–69; Brand k. Vendeve të Ulëta, §§ 64–66).*

23. GJEDNJ-ja ka theksuar se, kërkesa për drejtësi procedurale që rrjedh nga neni 5§4 nuk dikton që të zbatohen kritere uniforme e të pandryshueshme, të pavarura nga konteksti, nga faktet dhe nga rrethanat e çështjes. Ndonëse procedura që lidhet me nenin 5§4 nuk duhet të shoqërohet gjithmonë me garanci të njëjta si ato që parashikon neni 6 për mosmarrëveshjet civile ose penale, ajo duhet të ketë një karakter gjyqësor dhe t'i ofrojë individit të interesuar garanci sipas natyrës së heqjes së lirisë për të cilën ai ankohet *(shih A. me të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar [DhM], § 203; Idalov k. Rusisë [DhM], § 161).*

24. Kolegji vë në dukje se të drejtat dhe garancitë procedurale të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të KEDNJ-së, duhen zbatuar edhe në rastin e personave me probleme të shëndetit mendor, elemente që janë trajtuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së. Në këtë aspekt, GJEDNJ-ja ka evidentuar disa nga të drejtat që duhet t'i garantohen personit të ndaluar me çrregullime të shëndetit mendor, sikurse janë zhvillimi i një seance *(Nikolova k. Bullgarisë [DhM], § 58)*, e drejta për t'u dëgjuar personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit *(Kampanis k. Greqisë, § 47)*, përfshirë dhe në intervale kohe të arsyeshme gjatë qëndrimit në izolim *(Çatal k. Turqisë, § 33; Altınok k. Turqisë, § 45)*, respektimi i kontradiktoritetit dhe "barazia e armëve" mes palëve gjatë kësaj procedure *(Reinprecht k. Austrisë, § 31; A. me të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar [DhM], § 204).*

25. Në një vështrim krahasues me ligjin penal italian, Kolegji konstaton se gjykatat mund të caktojnë një masë shtrënguese, siç është vendosja në një institucion të posaçëm për personat e papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore, të cilët kanë kryer një vepër penale dhe që vlerësohen shoqërisht të rrezikshëm për shoqërinë.[9] Sipas Kodit Penal të Republikës së Italisë (neni 203) rrezikshmëria shoqërore e një personi, duhet kuptuar si "një mundësi e theksuar që ai të kryejë në të ardhmen vepra penale të tjera". Ky vlerësim do të bëhet nga gjykata mbi bazën e kritereve që parashikohen në ligj për caktimin e dënimit (neni 133 i Kodit Penal të Italisë). Sipas jurisprudencës italiane, vlerësimi i aftësisë së një personi për të kuptuar rëndësinë e veprimeve që ai ka kryer, është një çështje që i përket gjyqtarit të debatit/themelit.[10] Kolegji vë në dukje se Kodi i Procedurës Penale të Italisë, neni 425/1, parashikon se gjyqtari i seancës paraprake merr vendim për mosvazhdimin e procedimit, duke përcaktuar dhe shkakun në dispozitiv, kur ekziston ndonjë nga rastet e parashikuara në këtë dispozitë. Një nga rastet për të cilat disponohet me vendim për mosvazhdimin e procedimit është edhe rasti kur një person nuk mund të dënohet. Në ndryshim nga KPP i Republikës së Shqipërisë (i cili në mënyrë të ngjashme parashikon rastet e pushimit të çështjes/akuzës nga gjyqtari i seancës paraprake), pika 4 e kësaj dispozite (pra, e nenit 425 të KPP të Italisë) parashikon shprehimisht që gjyqtari i seancës paraprake nuk mund të disponojë me vendim për mosvazhdimin e procedimit, ndaj personit që nuk mund të dënohet, kur vlerësohet se ndaj tij duhet të caktohet një masë sigurie mjekësore. Ky parashikim ligjor theksohet dhe në jurisprudencën e Gjykatës së Kasacionit të Italisë[11].

26. Përpara ndryshimeve ligjore të nenit 425 të KPP të Italisë, Gjykata Kushtetuese e Italisë me vendimin nr. 41, të vitit 1993, ka deklaruar në kundërshtim me Kushtetutën nenin 425, pika 1 të këtij Kodi për pjesën që lejonte dhënien e një vendimi për mosvazhdimin e procedimit gjatë seancës paraprake, kur dilte i qartë shkaku i padënueshmërisë. Gjykata Kushtetuese e Italisë në atë vendim ka theksuar se, personi që nuk mund të dënohet për shkak të gjendjes së tij mendore, nuk mund t'i mohohet debati dhe si pasojë mundësia për të ushtruar plotësisht të drejtën e tij të mbrojtjes. Gjykata Kushtetuese e Italisë ka evidentuar atë që është edhe thelbi i gjykimit në seancë paraprake, që synon verifikimin e plotësisë së hetimeve dhe

[9] Neni 202 i Kodit Penal të Republikës së Italisë.

[10] Vendim nr. 11897/2019, Gjykata e Kasacionit Itali.

[11] Vendim i Gjykatës së Kasacionit të Italisë, nr. 18213, datë 24.4.2018.

vlefshmërisë së provave ku bazohet akuza.[12] Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin njësues nr. 00-2021- 1134 (62), datë 1.11.2021, ka theksuar: "*Gjyqtari i seancës paraprake ka kompetencë të verifikojë provat e mbledhura në ngarkim të të pandehurit gjatë fazës së hetimeve paraprake, si dhe bazueshmërinë/qëndrueshmërinë e akuzës në gjykimin e themelit. Me fjalë të tjera, detyra kryesore e gjyqtarit të seancës paraprake është të kontrollojë nëse kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq është e bazuar, si nga pikëpamja e mjaftueshmërisë së provave, ashtu edhe nga pikëpamja e përdorshmërisë dhe vlefshmërisë së akteve, por nuk ka si qëllim të arrijë në konkluzione mbi fajësinë e të pandehurit. Kontrolli i ushtruar nga gjyqtari i seancës paraprake mbi hetimet e kryera, përfshi këtu edhe saktësimin apo korrigjimin e akuzës, nuk do të thotë se ai merr funksionet e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale".*

27. Kolegji vlerëson se vendosja e masës mjekësore duhet të kalojë të gjitha fazat nëpër të cilat kalon një procedim penal deri në paraqitjen në gjykatë të kërkesës për caktimin e saj, duke filluar me regjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e hetimeve nëse personi i papërgjegjshëm ka kryer apo jo vepër penale. Kërkesa për caktimin e masave mjekësore ndaj personave të papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore bazohet pikërisht në parashikimet e nenit 46 të KP dhe nenit 46 të KPP (cituar më lart). Kolegji rithekson se, ligji penal material dhe procedural përcaktojnë se organi kompetent për të vendosur masën mjekësore është gjykata, ndonëse nuk evidenton nëse është gjyqtari i seancës paraprake apo gjyqtari i themelit. Kolegji vë në dukje se neni 46 i KP ka pësuar disa ndryshime me ligjin nr. 36/2017, por pa cenuar thelbin e kësaj dispozite ligjore. Ndërkohë nga ana tjetër, neni 46 i KPP nuk ka pësuar ndryshime, pavarësisht se paragrafi i tretë, i nenit 46 të KP referon tek KPP, në lidhje me rregullat për revokimin e vendimit gjyqësor që përmban caktimin e një mase mjekësore, rregullime këto që mungojnë deri në këtë moment. Sa më sipër, ka sjellë edhe lindjen e mosmarrëveshjeve për kompetencë funksionale/ lëndore midis "gjyqtarit të seancës paraprake" dhe "gjyqtarit të gjykimit të çështjes në themel", lidhur me faktin se cili prej tyre ka kompetencën për caktimin e masave mjekësore, sipas nenit 46 të KP, duke sjellë si pasojë qëndrime e interpretime të ndryshme në praktikën gjyqësore. Gjithashtu, mungesa e harmonizimit të dispozitave ka krijuar vështirësi edhe për organin e prokurorisë, lidhur me procedurën që duhet të ndjekë për caktimin e masave mjekësore ndaj personit të papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore për të cilin dyshohet se ka kryer vepër penale.

III. Qëndrimet njësuese të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë:

28. Në funksion të zgjidhjes së problematikave të parashtruara në këtë vendim, Kolegji vlerësoi me rëndësi trajtimin e disa çështjeve për njësim të praktikës gjyqësore. Çështja e parë e shtruar për njësim është:

Cila është procedura që duhet të ndiqet nga prokurori lidhur me caktimin e masës mjekësore ndaj personit të papërgjegjshëm për të cilin dyshohet se ka kryer vepër penale, në kushtet kur, sipas neneve 290 dhe 328 të KPP, procedimi penal për raste të tilla nuk duhet të fillojë ose nëse ka filluar duhet të pushohet?

29. Kolegji në trajtimin e kësaj çështjeje vlerëson me rëndësi parashtrimin e disa elementeve që lidhen me inicimin e procedimit penal, duke analizuar specifikat që ka secili nga momentet procedurale të përfshira në këtë pyetje. Procedimi penal merr shkas nga njoftimi që merr prokurori, kryesisht apo nga policia gjyqësore, por edhe nga kallëzimi i shtetasve apo personave juridikë për një fakt penal. Duhet vënë në dukje se "procedimi penal" dhe "procesi penal" nuk janë sinonime të njëri-tjetrit, referuar përmbajtjes së dispozitave të veçanta në KPP. Jurisprudenca dhe doktrina në Shqipëri ka theksuar se, me shprehjen "procedim penal" kuptohet një seri veprimesh apo aktesh, të kryera sipas një rendi të caktuar kronologjik, deri në dhënien e një vendimi penal, ku secili prej tyre, atëherë kur është kryer në mënyrë të vlefshme, sjell detyrimin për të vijuar me veprimin, aktin tjetër. Nga sa më sipër, kuptohet që në konceptin e procedimit penal përfshihen tre elemente thelbësor: i. së pari, ligji parashikon një "seri të rregulluar kronologjikisht" aktesh, veprimesh, në kuptimin që këto akte duhet të kryhen, duke respektuar një afat kohor të përcaktuar; ii. së dyti, të gjitha aktet, veprimet e procedimit kanë si qëllim të vërtetojnë ekzistencën e një fakti të paligjshëm penalisht dhe atribuimin e tij një personi. Kjo përbën objektin e procedimit, e

[12] Vendim nr.41, i vitit 1993 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë, https://www.cortecostituzionale.it/

thënë në terma latinë "*res giudicanda*"; iii. së treti, kryerja e një veprimi apo akti të procedimit lind "detyrimin" për subjektin tjetër për të kryer veprimin apo aktin pasues, e kështu me radhë, deri në dhënien e vendimit përfundimtar. Procedimi penal i zakonshëm ndahet në tre faza: hetimet paraprake, seanca paraprake dhe gjykimi. Ndërkohë, me shprehjen "proces penal" kuptohet një pjesë e procedimit penal. Janë pjesë e "procesit penal" faza e seancës paraprake dhe gjykimi. Fillimi i procesit penal përkon me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori; ndërsa përfundon kur vendimi merr formë të prerë, d.m.th., kur vendimi penal është i paankimueshëm pasi ndaj tij nuk është bërë ankim ose sepse janë shteruar të gjitha mjetet e zakonshme të ankimit.

30. Kolegji thekson se moment me rëndësi i procesit penal është ushtrimi i ndjekjes penale. Kolegji Penal në vendimin njësues nr. 00-2021-1134 (62), datë 1.11.2021, ndër të tjera ka theksuar: "*Në zbatim të nenit 327, pika "6" të KPP, prokurori me depozitimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, depoziton njëkohësisht edhe të gjitha aktet në gjykatë/gjyqtari i seancës paraprake. Ky moment procedural, sipas ligjit (shprehimisht në këtë nen parashikohet: "në përfundim të hetimeve..., shënon përfundimin e hetimeve paraprake. Në favor të këtij interpretimi të karakterit teleologjik, në përshtatje me qëllimin e ligjvënësit në parashikimin e këtij instituti procedural, është edhe përcaktimi i nenit 331 të KPP (kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq) që nënkupton përfundimin e fazës së hetimeve paraprake me kontestimin/atribuimin e akuzës të pandehurit dhe dërgimin e çështjes për gjykim. Është pikërisht kjo kërkesë (për dërgimin e çështjes në gjyq) e paraqitur nga prokurori në përfundim të hetimeve paraprake, (përmbajtja e të cilës pasqyron në thelb akuzën e kontestuar prej këtij të fundit të hetuarit, i cili prej këtij momenti "fiton" statusin e të pandehurit, duke u akuzuar për një akuzë të caktuar), që "provokon" konstituimin e seancës paraprake si një moment kyç në funksion, sikurse u sipërcitua, të verifikimit të akuzës të atribuuar të pandehurit, si për sa i përket aspektit të kompletueshmërisë së hetimeve të zhvilluara, ashtu edhe në drejtim të kualifikimit të saktë juridik të faktit penal të atribuuar nëpërmjet akuzës, të pandehurit*". Ky është rasti i zakonshëm, pasi në gjykimet e posaçme mungon faza e seancës paraprake (gjykimi i drejtpërdrejtë; urdhri penal) ose në rastet e gjykimit të shkurtuar apo gjykimit me marrëveshje, ku ligji ka parashikuar gjyqtarin e seancës paraprake si kompetent për t'u shprehur edhe për themelin e akuzës.

31. Nëse prokuroria arrin në përfundimin se ndodhet para provave dhe fakteve të mjaftueshme, ushtron ndjekjen penale ndaj personit të dyshuar si autor i veprës penale. Në raste të tilla, prokurori i çështjes, në bazë të nenit 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave konkrete procedurale dhe materiale penale, ka detyrë të përfaqësojë dhe të mbrojë akuzën, duke kërkuar nga gjykata, mbi bazën e provave dhe të fakteve të mbledhura, sipas rastit, dënimin e autorit të veprës penale. Këtu qëndron edhe veçoria e prokurorisë, pasi asnjë organ tjetër nuk është i autorizuar të ushtrojë ndjekjen penale dhe të përfaqësojë akuzën në gjyq përveç asaj. Pra, procedimi penal dhe ngritja e akuzës publike është tagër e prokurorisë. I takon këtij organi, në bazë të nenit 148/1 të Kushtetutës dhe nenit 24/3 të KPP, të ushtrojë ndjekje penale dhe të ngrejë akuzë publike në emër të shtetit, nëse ndodhet para kryerjes së një vepre penale të parashikuar si të tillë nga KP (*shih vendimin nr. 3/2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Në lidhje me mosfillimin e procedimit penal, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin njësues nr. 02/2013, ndër të tjera, kanë theksuar: "*14. Procedimi penal merr shkas nga njoftimi që merr prokurori kryesisht apo nga policia gjyqësore, por edhe nga kallëzimi i shtetasve apo personave juridikë për ngjarjen e një vepre penale. Prokurori regjistron procedimin penal fillimisht për veprën që ai ka marrë njoftim se është kryer e, sipas rastit, edhe emrin e personit që i atribuohet vepra penale. Është pikërisht ky momenti që prokurori ka mundësi të verifikojë nëse ndodhemi para rasteve të parashikuara prej nenit 290 të KPP, pra nëse ndodhemi përpara rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal dhe që legjitimojnë marrjen e vendimit mbi mosfillimin e procedimit penal. 15. Rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thellë. Konstatimi i rrethanave është i lehtë dhe përgjithësisht bëhet para fillimit të procedimit penal, për këtë, mjaftojnë vetëm disa verifikime të shpejta për të konkluduar rreth marrjes së një vendimi mosfillimi. Si subjekte që marrin pjesë në këtë fazë, përveç prokurorit dhe policisë gjyqësore, janë edhe kallëzuesi, si njoftues i veprës penale, e në varësi të rastit, edhe personi të cilit i atribuohet vepra penale...*".

33. Neni 290 i KPP parashikon rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit. Konkretisht, kjo dispozitë parashikon se procedimi penal nuk mund të fillojë kur: a) personi ka vdekur; b) personi është i papërgjegjshëm ose nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale; c) mungon ankimi i viktimës ose ajo e tërheq ankimin; ç) kur fakti nuk parashikohet

nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston; d) vepra penale është shuar; dh) është dhënë amnisti; e) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit, brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit, vendim, i cili është i ankimueshëm në gjykatë nga kallëzuesi ose viktima, para gjyqtarit të hetimeve paraprake, sipas nenit 291 të KPP. Një nga rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal e për pasojë ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori është kur personi që i atribuohet vepra penale është i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore (neni 290, pika 1, shkronja "b" e KPP). Sipas nenit 17 të KP nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës penale vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet ose mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale (papërgjegjshmëria e plotë për shkak të gjendjes mendore). Pavarësisht përjashtimit nga përgjegjësia penale, ligjvënësi në nenin 46 të KP ka parashikuar se ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer një vepër penale, mund të jepen masat mjekësore "Mjekimi i detyruar ambulator" ose "Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor".

34. Kolegji rithekson se rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thellë, por mjaftojnë disa veprime për të arritur në konkluzionin nëse procedimi penal duhet filluar apo jo. Ndërkohë, në interpretim të nenit 17 të KP, instituti i "papërgjegjshmërisë për shkak të gjendjes mendore", do të zbatohet vetëm ndaj personave që provohet se kanë kryer një vepër penale dhe në kohën kur e kanë kryer veprën atë kanë qenë të papërgjegjshëm. Këto dy kushte duhet të ekzistojnë njëkohësisht, përndryshe, jo vetëm që personi nuk mund të përjashtohet nga përgjegjësia penale, por ndaj tij as nuk mund të caktohen masat mjekësore të përcaktuara nga neni 46 i KP. Kjo do të thotë që kërkohen verifikime më të thella në lidhje me identifikimin e personit që ka kryer veprën penale; në lidhje me papërgjegjshmërinë për shkak të gjendjes mendore, duke përcaktuar e analizuar me shumë kujdes edhe rrezikshmërinë e këtij personi; si dhe në varësi të këtyre elementeve bëhet përcaktimi i masës mjekësore më të përshtatshme, sipas nenit 46 të KP. Të gjitha këto verifikime nuk mund të bëhen brenda afatit 15-ditor të përcaktuar në nenin 291, pika 1 të KPP, por mund të sqarohen vetëm pas një hetimi gjithëpërfshirës të kryer nga prokurori.

35. Nisur nga sa u thanë më sipër, Kolegji vlerëson se parashikimi urdhërues i bërë në nenin 290 të KPP për prokurorin për të mos filluar procedimin penal, në rastet kur personi është i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore është i ndryshëm nga rrethanat e tjera të parashikuara në këtë dispozitë që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal. Kjo për faktin se, vetëm pas një procesi hetimor të thelluar, prokuroria është në gjendje të konkludojë paraprakisht nëse i hetuari ka kryer ose jo një vepër penale, nëse ka qenë ose jo i përgjegjshëm në kohën e kryerjes së saj, si dhe nëse paraqitet nevoja për caktimin e masave mjekësore sipas nenit 46 të KP. Në rastin e personave të papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore, veçoria qëndron në faktin se, neni 46 i KP i jep të drejtën vetëm gjykatës të vendosë një masë mjekësore për shkak të rrezikshmërisë që mund të paraqesë autori i veprës penale, duke parandaluar kryerjen prej tij të veprave të tjera në të ardhmen. Edhe sipas ligjit procedural penal (neni 46 i KPP), organi i vetëm që disponon për masat mjekësore të detyrueshme (shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik) është gjykata edhe kryesisht, si dhe me kërkesë të prokurorit gjatë hetimeve paraprake (referuar nenit 239 të KPP).

36. Në përfundim të kësaj analize, Kolegji vlerëson se në rastin kur fakti penal dyshohet të jetë kryer nga një person i papërgjegjshëm për shkak të çrregullimeve të shëndetit mendor, prokurori duhet të kryejë hetime. Kjo do të thotë se për më tepër, në raste të tilla është shumë e rëndësishme që prokurori të grumbullojë prova për të provuar autorësinë e veprës penale, të procedojë me kryerjen e ekspertimit psikiatriko-ligjor, të verifikojë nëse një person tjetër ka nxitur apo ka përfituar nga gjendja mendore e personit që dyshohet të ketë kryer veprën penale, veprime këto që nuk lejojnë disponimin nga prokurori për mosfillimin e procedimit penal.

37. Kolegji në këtë pikë vë theksin tek rëndësia që ka kryerja e aktit të ekspertimit psikiatriko-ligjor gjatë hetimeve paraprake, sidomos në rastet e ndalimit apo arrestimit të personit që dyshohet të ketë kryer veprën penale dhe shfaq probleme apo çrregullime të shëndetit mendor. GJEDNJ-ja, në çështjen *Varbanov kundër Bullgarisë*, ka mbajtur

qëndrimin se pa mendimin e një eksperti mjekësor, nuk mund të bëhet asnjë privim nga liria e një personi që konsiderohet të jetë me çrregullime të shëndetit mendor, pasi kjo do të përbënte shkelje të nenit 5/1 (e) të Konventës. Ndërsa, në çështjen *Ilnseher kundër Gjermanisë*, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se ekspertët mjekësor duhet të kenë një kualifikim specifik, siç është eksperti psikiatër.

38. Sa më sipër, prokurori nuk mund të vendosë mosfillimin e procedimit penal pa kryer më parë ekspertimin psikiatriko-ligjor, e rrjedhimisht është logjike që fillimisht duhet të regjistrohet procedimi penal dhe të kryhen të gjitha veprimet e nevojshme hetimore për vërtetimin e faktit penal, autorësinë e personit, papërgjegjshmërinë e tij mendore, si dhe në eventualitet faktin se, ai është shoqërisht i rrezikshëm dhe për pasojë, duhet të caktohet ndaj tij një masë mjekësore. Në sintezë, prokurori kur ka të dhëna të mjaftueshme që është kryer një vepër penale nga një person që dyshohet të jetë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore, duhet të kryejë hetime paraprake të plota dhe fashikulli i prokurorit duhet të përmbajë të gjitha aktet që provojnë elementet e sipërpërmendur.

39. Në përgjigje të pyetjes së parë të shtruar për njësim, Kolegji arrin në përfundimin njësues se:

Kur dyshohet se vepra penale, është kryer nga një person që dyshohet të jetë i papërgjegjshëm, prokuroria nuk vendos mosfillimin e procedimit penal, pa regjistruar këtë procedim, por kryen hetime të mëtejshme.

40. Në lidhje me disponimin e prokurorit për pushimin e akuzës ose të çështjes, sipas nenit 328 të KPP, Kolegji vë në dukje se ligji parashikon dy situata të ndryshme procedurale nëse fakti është cilësuar kundërvajtje penale apo krim. Neni 328 i KPP, me titull "Pushimi i akuzës ose çështjes", në pikën 1, shkronja "ç" parashikon: "*1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: (…) ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet*". Kjo dispozitë penale parashikon pushimin e akuzës apo çështjes nga prokurori, kur procedohet për kundërvajtje penale, kur nga hetimet paraprake prokurori ka konstatuar se ekziston një rrethanë që përjashton personin nga marrja e tij si i pandehur apo nga dënimi, rrethanë kjo që përfshin situatën kur personi autor i veprës penale është i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore. Me këtë formulim të përgjithshëm, ligjvënësi i është referuar atyre rasteve kur është vërtetuar mungesa e kushteve thelbësore për të ushtruar ndjekjen penale, d.m.th., mungesa e elementeve të veprës penale, sikurse është edhe situata kur personi nuk mund të merret i pandehur ose nuk mund të dënohet, për shkak të papërgjegjshmërisë. Kolegji thekson se edhe në këtë rast, përjashtim nga kjo situatë përbën rasti kur ekzistojnë arsye për caktimin e masave mjekësore, të cilat duke pasur nevojë për një gjykim në themel, pra për një vlerësim të plotë në lidhje me ekzistencën e faktit penal, atribuimin e tij personit të dyshuar, papërgjegjshmërisë për shkak të gjendjes mendore dhe rrezikshmërisë së tij shoqërore, vendosin detyrim për prokurorin që të ushtrojë ndjekjen penale, duke paraqitur kërkesë për kalimin e çështjes në gjyq për caktimin e masës mjekësore.

41. Kolegji vlerëson se, ashtu sikurse në rastin e mosfillimit të procedimit penal, edhe në rastin e pushimit të akuzës ose çështjes penale kur procedohet për kundërvajtje penale, si dhe kur është e nevojshme caktimi i një mase mjekësore që kufizon lirinë e personit dhe që si e tillë kërkon shqyrtim në themel dhe në kontradiktoritet të palëve, prokurori nuk mund të disponojë me pushimin e çështjes. Nisur nga fakti që, neni 46 i KP parashikon dhënien e një mase mjekësore vetëm nga gjykata, prokurori mund të disponojë me vendim për pushimin e çështjes, për personat e papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore që kanë kryer kundërvajtje penale, vetëm kur rezulton se ndaj tyre nuk duhet të caktohet masë mjekësore, sipas nenit 46 të KP (kjo mund të rezultojë nëse verifikohet se personi me çrregullime të shëndetit mendor nuk përbën rrezik për sigurinë publike, situatë kjo që referon në zbatimin e ligjit për shëndetin mendor).

42. Në lidhje me këtë moment, Kolegji vlerëson se prokurori nuk mund të disponojë me vendim për pushimin e çështjes, duke analizuar në këtë disponim për kryerjen e veprës penale, autorësinë dhe papërgjegjshmërinë e autorit, e në vijim duke kërkuar nga gjykata vetëm caktimin e masës mjekësore. Kjo për arsye se, caktimit të masës mjekësore mund t'i hapet rrugë vetëm mbi bazën e kërkesës së prokurorit për kalimin e çështjes në gjyq që presupozon ushtrimin e ndjekjes penale dhe jo ndërprerjen e saj nëpërmjet pushimit të çështjes. Gjykata nuk është organ formalizues i veprimeve të prokurorit, por organ drejtësidhënës, e cila kontrollon veprimet hetimore të kryera nga

prokurori dhe me vendim shprehet mbi veprën penale, autorin, papërgjegjshmërinë për shkak të gjendjes mendore në këtë rast dhe masat që do të merren ndaj tij, duke respektuar të drejtat e mbrojtjes, kontradiktoritetin dhe barazinë e palëve në këtë proces, ku çështja dhe akuza penale duhet të shqyrtohet në themel.[13]

43. Në sintezë të parashtrimit sa më sipër, Kolegji thekson se prokuroria nuk mund të pushojë çështjen penale ndaj një personi që është i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore, nëse ka të dhëna të mjaftueshme se ky person ka kryer një vepër shoqërisht të rrezikshme dhe lënia e tij e lirë është e rrezikshme për shoqërinë. Ndërsa, kur prokurori konstaton se lënia e lirë e personit të papërgjegjshëm që ka kryer veprën penale, nuk rrezikon shoqërinë, atëherë ai mund të disponojë për pushimin e çështjes penale, pasi në këtë rast vlerëson se nuk është e nevojshme caktimi i një mase mjekësore nga gjykata. Me ndryshimet e KPP me ligjin nr. 35/2017, prokurori e pushon vetë çështjen penale, pa ia dërguar gjykatës, kur procedohet për kundërvajtje penale. Megjithatë, edhe kjo vendimmarrje e prokurorit, kontrollohet nga gjyqtari i seancës paraprake, i cili ka kompetencën, sipas nenit 329 të KPP, ta zhbëjë atë, duke urdhëruar prokurorin të kryejë veprime të tjera hetimore apo të formulojë akuzë.

44. Në lidhje me këtë çështje, Kolegji arrin në përfundimin njësues se:

Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori, bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja "ç" të Kodit të Procedurës Penale, vendos pushimin e çështjes penale për personin e papërgjegjshëm, të cilit i atribuohet vepra penale, kur rezulton se ndaj tij nuk duhet të caktohet masë mjekësore, sipas nenit 46 të Kodit Penal.

45. Më tej, në nenin 329/a të KPP parashikohet detyrimi i prokurorit, kur procedohet për krime dhe janë rastet e parashikuara në ligj, t'i drejtohet gjyqtarit të seancës paraprake me kërkesë për pushimin e akuzës ose çështjes, e cila parashikon dhe rastin e personit autor të krimit por të papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore. Konkretisht, neni 329/a i KPP, me titull "Kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes", në pikën 1 të tij, parashikon: "1. *Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes"*. Në nenin 328, pika 1, shkronja "ç" të KPP parashikohet pushimi i akuzës ose çështjes kur personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet, rast ky që përfshin dhe papërgjegjshmërinë për shkak të gjendjes mendore. Ndërsa në nenin 329/b të KPP parashikohen rregullat për shqyrtimin e kërkesës së prokurorit dhe mënyra e disponimit të gjyqtarit të seancës paraprake, lidhur me kërkesën për pushimin e akuzës ose çështjes.

46. Ashtu sikurse në rastin e mosfillimit të procedimit penal apo pushimit të akuzës ose çështjes penale kur procedohet për kundërvajtje penale, edhe në rastin kur procedohet për krime, Kolegji thekson domosdoshmërinë që kur prokurori vlerëson se duhet caktuar një masë mjekësore që kufizon lirinë e personit, gjykata/gjyqtari i seancës paraprake nuk mund të disponojë për pushimin e çështjes apo të akuzës. Vendimi i pushimit kur procedohet për krime ndaj një personi që nuk mund të dënohet, pasi është i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore, nuk lejon që në vijim të procedohet me caktimin e një mase mjekësore. Në terma të tjerë, fakti që çështja penale është pushuar pengon gjykatën që do marrë në shqyrtim caktimin e masës, të verifikojë ekzistencën e faktit penal dhe atribuimin e tij pikërisht personit të akuzuar, përfshirja e të cilit apo fakti nëse ai është në të vërtetë autori i veprës penale, duhet provuar në gjykim, në përputhje me standardet e procesit të drejtë e të rregullt ligjor. Në rastin e personave të papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore, është e qartë që nuk mund të flitet për elementin faj, në kuptimin klasik të tij, por vërtetimi i autorësisë apo i faktit se vepra penale

[13] Në kuadrin e praktikës gjyqësore dhe të një të "drejte gjyqësore" tashmë të formuar prej vitesh, Kolegji sjell në vëmendje edhe udhëzimin nr. 2, datë 2.1.1961, të Plenumit të Gjykatës së Lartë *"Mbi zbatimin e masave mjekësore"*. Në këtë udhëzim përcaktohet shprehimisht: "*3) Kur në përfundim të hetimeve dalin të dhëna të mjaftueshme, që tregojnë se është kryer një vepër shoqërisht e rrezikshme nga i pandehuri në gjendje sëmundjeje psikike dhe lënia e tij e lirë rrezikon shoqërinë ose se i pandehuri ka rënë i sëmurë nga sëmundja psikike e pashërueshme, pas kryerjes së krimit, hetuesi merr vendim dhe çështjen ja dërgon gjykatës (neni 197 i KPP). Kur hetuesi konstaton se lënia e lirë e të pandehurit, që ka kryer veprën penale në gjendje sëmundjeje psikike, nuk është e rrezikshme për shoqërinë e pushon vetë çështjen pa ja dërguar gjykatës (nenet 196 dhe 98 të KPP)".*

është kryer pikërisht nga personi i papërgjegjshëm, është detyrë kryesore e gjykatës, si subjekti procedural i ngarkuar me ligj për dhënien e drejtësisë. Në këtë vështrim, Kolegji thekson se gjykimet e kësaj natyre, kur kërkohet dhe është e domosdoshme caktimi i një mase mjekësore në kuadrin e një procedimi penal, prokurori në ushtrim të kompetencave të tij, si titullar i ndjekjes penale, duhet të kërkojë dërgimin e kësaj çështje në gjyq, duke argumentuar këtë disponim të tij.

47. Në mënyrë që të caktohet masa mjekësore në kuptim të nenit 46 të KP, duhet para së gjithash të plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte: i. të jetë kryer një vepër penale të paktën nga ana objektive; ii. vepra penale të jetë kryer nga personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale; iii. personi autor i veprës penale dhe i papërgjegjshëm para ligjit duhet të paraqesë rrezikshmëri shoqërore se pa trajtimin mjekësor të detyruar (trajtimin e pavullnetshëm) rrezikon jetën, shëndetin, sigurinë e vetes ose të tjerëve. Zbatimi i masës mjekësore përfshin edhe konstatimin se personi të cilit i atribuohet vepra penale është i rrezikshëm shoqërisht dhe për rrjedhojë një gjykim i mëtejshëm në themel për caktimin e masës mjekësore duhet të kryhet në një proces kontradiktor dhe në ushtrimin e kompetencave të njohjes së plotë, arsye tjetër kjo që përjashton dhënien e një vendimi pushimi nga gjyqtari i seancës paraprake, bazuar në një kërkesë të paraqitur nga prokurori sipas neneve 329/a dhe 328, pika 1, shkronja "ç" të KPP. Për rrjedhojë, arrihet në përfundimin se për personin që ka kryer një krim dhe që është i papërgjegjshëm penalisht për shkak të gjendjes mendore, prokurori kur procedon për krime, i kërkon gjykatës (gjyqtarit të seancës paraprake) pushimin e akuzës ose çështjes bazuar në nenet 329/a dhe 328, pika 1, shkronja "ç" të KPP, vetëm në rastet kur vërtetohet se ky person nuk paraqet rrezikshmëri shoqërore për jetën, shëndetin, sigurinë e vetes ose të tjerëve dhe për pasojë nuk lind nevoja për caktimin ndaj tij të një mase mjekësore sipas nenit 46 të KP.

48. Në lidhje me këtë çështje, Kolegji arrin në përfundimin njësues se:

Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime, prokurori, bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja "ç" të Kodit të Procedurës Penale, i kërkon gjykatës (gjyqtarit të seancës paraprake) pushimin e çështjes penale për personin e papërgjegjshëm, të cilit i atribuohet vepra penale, kur rezulton se ndaj tij nuk duhet të caktohet masë mjekësore, sipas nenit 46 të Kodit Penal.

49. Në vijim të parashtrimeve në lidhje me pyetjen e parë të shtruar për njësim, Kolegji vlerëson se në përfundim të hetimeve paraprake, kur prokurori konstaton se i hetuari ka kryer një vepër penale, por në kohën e kryerjes së veprës ai ka qenë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore dhe rezulton (ka të dhëna të mjaftueshme) se lënia e tij e lirë rrezikon jetën, shëndetin, sigurinë e vetes ose të tjerëve, pra i hetuari paraqet rrezikshmëri shoqërore për kryerjen e veprave të tjera penale, atëherë ai duhet të ushtrojë ndjekjen penale, duke paraqitur në gjykatë kërkesë për gjykimin e çështjes dhe caktimin e masës mjekësore. Më tej, është gjykata që duhet të vendosë mbi bazën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me ekzistencën ose jo të veprës penale, përcaktimit të gjendjes mendore të të hetuarit në kohën e kryerjes së kësaj vepre dhe rrezikshmërisë së tij shoqërore, element shumë i rëndësishëm për të përcaktuar llojin e masës mjekësore që do të caktohet. Në kushtet kur sipas ligjit penal material e procedural rrezikshmëria shoqërore e personit që ka kryer vepër penale, kusht *sine qua non* për caktimin e një mase mjekësore, konstatohet vetëm nga gjykata (neni 46 i KP dhe neni 46 i KPP), prokurori nuk mund të procedojë sipas nenit 327, pika 6, shkronja "a" të KPP, që parashikon: "*6. Në përfundim të hetimeve paraprake, prokurori procedon si më poshtë: a) vendos pushimin e akuzës apo çështjes, në rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, ose i kërkon gjykatës pushimin e akuzës apo çështjes, në rastet e parashikuara nga neni 329/a i Kodit*". Kjo për arsye se nevoja për caktimin e masës mjekësore sipas nenit 46 të KP i imponon prokurorit ushtrimin e ndjekjes penale, nëpërmjet paraqitjes së kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, bazuar në nenin 327, pika 6, shkronja "b" të KPP që parashikon: "*6. Në përfundim të hetimeve paraprake, prokurori procedon si më poshtë: … b) i kërkon gjykatës dërgimin e çështjes në gjyq, kur nuk procedon sipas neneve 400, 406/a dhe 406/dh të këtij Kodi*".

50. Kërkesa për caktimin e masës mjekësore është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me fundin e procedimit penal si kërkim subsidiar, që vendoset

vetëm nga gjykata dhe në rastin konkret është pushimi i çështjes penale, pasi personi nuk mund të merret si i pandehur dhe si rrjedhojë nuk mund të dënohet. Pra, prokurori gjatë hetimeve që kryen ndaj një personi që është i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore, nëse ka të dhëna të mjaftueshme se ai ka kryer një vepër shoqërisht të rrezikshme dhe lënia e tij e lirë rrezikon shoqërinë, duhet t'i drejtohet gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq me qëllim caktimin e masës mjekësore.[14]

51. Në lidhje me këtë çështje, Kolegji arrin në përfundimin njësues se:

Në përfundim të hetimeve paraprake, si në rastin kur procedohet për kundërvajtje penale, ashtu edhe në rastin kur procedohet për krime, ndaj personit të papërgjegjshëm që i atribuohet vepra penale dhe kur ndaj të cilit duhet të caktohet masë mjekësore, sipas nenit 46 të Kodit Penal, prokurori i kërkon gjykatës (gjyqtarit të seancës paraprake) dërgimin e çështjes në gjyq për caktimin e masës mjekësore.

52. Çështja e dytë e shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore është ajo që në thelb lidhet edhe me mosmarrëveshjen për kompetencën e parashtruar në rastin konkret, me këtë përmbajtje:

Cila është gjykata kompetente dhe mënyra e disponimit të saj për caktimin e masave mjekësore, në kushtet kur sipas dispozitave të neneve 328 dhe 332/dh, pg. 1, shkronja "ç" të KPP, çështja penale për raste të tilla duhet të pushohet?

53. Kolegji vlerëson se vendosja e masës mjekësore duhet të kalojë të gjitha fazat nëpër të cilat kalon një procedim penal deri në paraqitjen në gjykatë të kërkesës për caktimin e saj, duke filluar me regjistrimin e procedimit penal dhe kryerjen e hetimeve nëse personi i papërgjegjshëm ka kryer apo jo vepër penale. Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Elemente të procesit të rregullt ligjor janë prezumimi i pafajësisë, e drejta e mbrojtjes, barazia e armëve (kontradiktoriteti), e drejta për t'u dëgjuar përpara se të gjykohet, etj. Në bazë të parimit të barazisë së shtetasve para ligjit të sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës së RSH-së, e drejta për një proces të rregullt ligjor vlen edhe për personat me çrregullime të shëndetit mendor. Për rrjedhojë, procedura e caktimit të masave mjekësore bëhet mbi bazën e kërkesës së prokurorit, e cila pasohet nga një procedurë e zakonshme gjykimi, pasi personit të dyshuar si autor i veprës penale duhet t'i sigurohen të gjitha garancitë e procesit të rregullt ligjor, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Kjo për shkak se masa mjekësore është një masë shtrënguese, e cila sjell privim apo kufizim të lirisë së personit për një kohëzgjatje të pacaktuar.[15]

54. GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se personit të papërgjegjshëm duhet t'i garantohen të drejtat dhe ndaj tij të ketë një proces të rregullt ligjor.[16] GJEDNJ-ja ka theksuar se, parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet e një gjykimi të drejtë, i kërkuar nga neni 6/1 i KEDNJ-së. Ky parim ndalon shprehjen e parakohshme nga vetë gjykata të vlerësimit se, personi "i akuzuar për një vepër penale" është fajtor përpara se kjo të provohet në përputhje me ligjin.[17] Në çështjen *Karaman kundër Gjermanisë*, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se gjykatat penale janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime apo dyshime. Sa më sipër, arrihet në përfundimin se gjykata është e detyruar të analizojë elementet e veprës penale në rastin kur shqyrton kërkesën e prokurorisë për caktimin e

[14] Në një vështrim historik, ky qëndrim është mbajtur edhe nga udhëzimi nr. 2, datë 2.1.1961, i Pleniumit të Gjykatës së Lartë, "Mbi zbatimin e masave mjekësore", ku është përcaktuar: *"3) Kur në përfundim të hetimeve dalin të dhëna të mjaftueshme, që tregojnë se është kryer një vepër shoqërisht e rrezikshme nga i pandehuri në gjendje sëmundjeje psikike dhe lënia e tij e lirë rrezikon shoqërinë ose se i pandehuri ka rënë i sëmurë nga sëmundja psikike e pashërueshme, pas kryerjes së krimit, hetuesi merr vendim dhe çështjen ja dërgon gjykatës (neni 197 i KPP)".*

[15] Neni 27/2/d i Kushtetutës parashikon se mund të kufizohet liria e personit kur plotësohen dy kushte kumulative: së pari personi është i paaftë mendërisht; së dyti personi përbën rrezik për shoqërinë.

[16] Vendim i GJEDNJ-së, Çështja "Beiere kundër Latvia", aplikimi nr. 30954/05, datë 29.11.2011. Vendim i GJEDNJ-së, Çështja "Van der Leer kundër Vendeve të Ulta", aplikimi nr. 11509/85, datë 22.1.1990.

[17] Vendim i GJEDNJ-së, Çështja "Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar", datë 12 korrik 2013; "Karaman kundër Gjermanisë", datë 27 shkurt 2014.

masës mjekësore, duke qenë se kjo e fundit kufizon lirinë e personit për një kohëzgjatje të papërcaktuar. Në funksion të arritjes së qëllimit të mësipërm, neni 152 i KPP ka sanksionuar parimin e vlerësimit të lirë të provave sipas parimit se asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar. Çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre**.** Çmuarja dhe vlerësimi, bëhet mbi bazën e asaj çka rezulton gjatë marrjes e shqyrtimit të tyre gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor.[18] GJEDNJ-ja çmon mënyrën në të cilën trajtohen provat si një çështje të rëndësishme në marrjen e vendimit nëse një gjyq ka qenë i drejtë apo jo. *(Çështja Van Mechelen dhe të tjerë kundër Vendeve të Ulëta)*. Për sa më sipër, për të respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë, për provueshmërinë e faktit penal, autorësinë e personit të papërgjegjshëm, si dhe rrezikshmërinë e tij shoqërore, gjykata duhet të zbatojë standardin e të provuarit *"tej çdo dyshimi të arsyeshëm"*.

55. Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë është përcaktuar se, në seancë paraprake nuk zbatohet standardi provues *"përtej çdo dyshimi të arsyeshëm"*, standard ky që i përket fazës së gjykimit të çështjes në themel dhe formësohet mbi bazën e provave të marra në gjykim në prezencë të kontradiktoritetit të palëve para një gjykate natyrale dhe neutrale[19]. Gjyqtari i seancës paraprake nuk mund të bëjë një vlerësim më të thellë se ai që kërkohet për seancën paraprake, si dhe nuk mund të hyjë në çështje të të vlerësuarit të provave e çmuarjes së tyre në kuptim të të provuarit, vlerësim që bëhet në kontradiktoritet e debat gjyqësor që është karakteristikë e gjykimit në themel të çështjes.[20] Detyra e gjyqtarit të seancës paraprake është që, në prani të burimit të provave që i paraqiten, të limitohet të verifikojë nëse në situatën në të cilën ndodhen aktet, mund të kalohet çështja në gjyq, pa bërë vlerësime thelbësore që i takojnë fazës së gjykimit në themel të çështjes.[21]

56. Kolegji thekson se, gjyqtari i seancës paraprake është në pamundësi për t'u shprehur lidhur me caktimin e masës mjekësore ndaj të pandehurit të deklaruar të papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore (në momentin e kryerjes së veprës penale të atribuar sipas akuzës), shkak ky për të cilin mund të vendoset pushimi i çështjes ose akuzës, sipas përcaktimit të shkronjës "ç", të paragrafit të parë, të nenit 328 të KPP. Nëse do të pranohej e kundërta, nisur nga karakteristikat e seancës paraprake dhe *ratio* i parashikimit të kësaj faze të procesit penal, do të cenoheshin të drejtat legjitime të personit të akuzuar. Në seancën paraprake gjykohet kryesisht mbi bazën e materialit mbështetës të kërkesës për gjykim të paraqitur nga prokurori (fashikulli i hetimeve), e ndërkohë asnjë dispozitë procedurale penale nuk parashikon të drejtën e gjyqtarit të seancës paraprake të marrë prova, fakt që cenon në mënyrë të rëndësishme të drejtën e mbrojtjes, në drejtim të kundërshtimit të kërkesës për caktimin e masës mjekësore dhe kushteve për caktimin e saj, mbi të gjitha të verifikimit të rrezikshmërisë shoqërore të subjektit të papërgjegjshëm, që justifikon në thelb caktimin e kësaj mase. Në terma të tjerë, gjyqtari i seancës paraprake nuk mund të procedojë me caktimin e masës mjekësore mbas pushimit të çështjes në përputhje me përcaktimet e nenit 328/1/ç të KPP, në kushtet e sipërcituara, në cenim të së drejtës së mbrojtjes së personit që ka kryer veprën penale në kushtet e papërgjegjshmërisë, për të ushtruar të drejtën e paraqitjes së provave mbi thelbin e "*res giudicanda*", verifikimin e rrezikshmërisë shoqërore të këtij të fundit, në cilësinë e kushtit kryesor për caktimin e kësaj mase.

57. Mbi këtë bazë arsyetimi, Kolegji vlerëson se e vetmja gjykatë që garanton realizimin e kësaj të drejte thelbësore, por në të njëjtën kohë shqyrton edhe problematikat e tjera që eventualisht mund të kundërshtohen nga mbrojtja, të tilla si verifikimi i faktit penal të atribuar këtij subjekti prej organit të akuzës, përgjegjshmërinë e autorit të veprës penale, e cila për veçantinë dhe ndjeshmërinë që paraqet duhet patjetër t'i nënshtrohet hetimit dhe debatit gjyqësor, është ajo e "gjykimit të çështjes në themel". Sa më sipër, nisur nga fakti që në çdo rast që duhet të caktohet një masë mjekësore është e detyrueshme që të vërtetohet kryerja e veprës penale, autorësia e

[18] Vendimet nr. 60, datë 22.2.2022 dhe nr. 104, datë 1.4.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[19] Vendim nr. 183, datë 24.6.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[20] Vendim nr. 169, datë 14.6.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[21] Vendim nr. 77, datë 8.3.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; Vendim nr. 185, datë 5.7.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

personit të dyshuar, papërgjegjshmëria dhe rrezikshmëria e këtij personi, bazuar në standardin e gjykimit "tej çdo dyshimi të arsyeshëm", standard ky që i përket fazës së gjykimit të çështjes në themel të zhvilluar në respektim të parimit të kontradiktoritetit të palëve, të drejtës së mbrojtjes, barazisë së armëve, Kolegji arrin në përfundimin se disponimi mbi caktimin e masës mjekësore në ngarkim të personit të papërgjegjshëm që ka kryer vepër penale, është në kompetencën e gjykatës që do të shqyrtojë çështjen në themel, kjo në kuptim edhe të dispozitave procedurale që rregullojnë rolin e gjyqtarit të seancës paraprake.

58. Zgjidhja e çështjes në themel nga gjyqtari i seancës paraprake, duke marrë padrejtësisht rolin e gjyqtarit të shqyrtimit të çështjes në themel dhe debat gjyqësor, ndërkohë që kompetenca e tij është kontrolli i "cilësisë" së hetimeve, nëse ato janë të plota ose jo; nëse ka vend që organi procedues të kryejë veprime të tjera hetimore apo të kërkojë burime të tjera provash në lidhje me ekzistencën e faktit penal dhe autorët e saj, përbën cenim të procesit të rregullt ligjor, sidomos në drejtim të së drejtës së mbrojtjes së personit të papërgjegjshëm që i është atribuuar kryerja e veprës penale. Në vijim, Kolegji rithekson se, legjislacioni shqiptar parashikon në nenet 332–332/gj të KPP rolin e gjyqtarit të seancës paraprake dhe kompetencat që i jep ligji. Gjyqtari i seancës paraprake nuk mund të hyjë në çështje të të vlerësuarit të provave e çmuarjes së tyre në kuptim të të provuarit, vlerësim që bëhet në kontradiktoritet dhe debat gjyqësor që është karakteristikë e gjykimit në themel të çështjes. Për rrjedhojë nuk mund të analizojë dhe konkludojë në raport me veprën penale në të gjithë elementet e saj, vërtetimi i së cilës është parakusht absolut që kushtëzon kërkesën dhe vendosjen e masës mjekësore nga gjykata. Nëse nuk arrihet të provohet se personi për të cilin kërkohet masa mjekësore ka kryer veprën penale, nuk jemi në kushtet e investimit të gjykatës për caktimin e masës mjekësore. Gjithashtu, duhet të vërtetohet që vepra penale është kryer nga personi, i cili në referim të nenit 17 të KP është i papërgjegjshëm para ligjit dhe se personi paraqet rrezikshmëri shoqërore se do të kryejë vepra të tjera po të lihet i lirë.

59. Në lidhje me çështjen e dytë, Kolegji arrin në përfundimin njësues se:

Gjykata kompetente për caktimin e masave mjekësore, sipas nenit 46 të Kodit Penal dhe nenit 46 të Kodit të Procedurës Penale, është gjykata që gjykon çështjen në themel.

60. Ligjvënësi nuk ka normuar rregullime të posaçme në legjislacionin procedural, mbi shqyrtimin gjyqësor të kërkesës me objekt caktimin e masës mjekësore, ndaj që të realizohet gjykimi në themel i çështjeve të kësaj natyre kur nga organi i procedimit çmohet e nevojshme dhe e domosdoshme caktimi i masës mjekësore, prokuroria në përfundim të hetimeve paraprake, siç është thënë më sipër, duhet të paraqesë kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq për caktimin e masës mjekësore (në thelb, ushtrimi i ndjekjes penale ndaj subjektit në fjalë). Në vlerësimin e Kolegjit, ky është i vetmi mjet që konstituon seancën paraprake, në kuadrin e së cilës, gjyqtari i kësaj seance ka detyrimin, gjithnjë kur ndan të njëjtin mendim me prokurorin (kërkesën e tij), për të vendosur, bazuar në përcaktimin e shkronjës "a", të paragrafit të parë, të nenit 332/dh të KPP, pranimin e kërkesës dhe dërgimin e çështjes në gjyq. Në këtë përfundim arrihet edhe në vështrim të neneve 327/1, shkronja "b" dhe 331/1 të KPP, që e përjashtojnë "seancën paraprake" vetëm për procedurat e posaçme të gjykimit të parashikuara nga ky Kod në nenet 400 (gjykimi i drejtpërdrejtë), 406/a (urdhri penal) 406/dh (gjykimi me marrëveshje kur nuk paraqitet në seancë paraprake).

61. Në sintezë, kur nuk procedon sipas neneve 328, 329/a, 400, 406/a ose 406/dh të KPP, prokurori kërkon dërgimin e çështjes në gjyq, çka bën të mundur shtytjen e procedimit në fazën tjetër të procesit penal "gjykimit të çështjes në themel". Në këtë rast vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq, lidhet me verifikimin e kryerjes së të gjithë verifikimeve nga prokurori, vlerësimin se fakti ka ndodhur dhe ka arsye të mjaftueshme dhe të bazuar për të konkluduar se personi i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore, mund të jetë autori i kësaj vepre penale. Një element me shumë rëndësi që duhet verifikuar nga gjyqtari i seancës paraprake është kryerja e ekspertimit psikiatriko-ligjor, i cili duhet të përcaktojë edhe rrezikshmërinë e personit, shkak që ligjëron kërkimin për caktimin e masës mjekësore. Kolegji vlerëson se gjyqtari i seancës paraprake, pasi ka kryer kontrollin për ligjshmërinë e veprimtarisë hetimore në fazën e hetimeve paraprake, plotësinë e tyre dhe mjaftueshmërinë e provave, disponon me vendim për dërgimin për gjykim të kërkesës për

caktimin e masës mjekësore.

62. Në lidhje me këtë çështje, Kolegji arrin në përfundimin njësues se:

Gjyqtari i seancës paraprake, kur çmon se hetimet paraprake janë të plota, bazuar në nenin 332/dh, shkronja "a" ,të Kodit të Procedurës Penale, vendos pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq për caktimin e masës mjekësore ndaj personit të papërgjegjshëm që i atribuohet vepra penale, sipas nenit 46 të Kodit Penal.

63. Masat mjekësore kanë karakter të dyfishtë, sepse zbatohen për të mbrojtur njëkohësisht interesat e personave që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor dhe interesat e shoqërisë. Kjo do të thotë se qëllimi i masave mjekësore nuk është ndëshkimi i personit që ka kryer një vepër penale, por kurimi i tij, si dhe parandalimi i kryerjes së veprave të tjera penale. Neni 17 i KP[22] parashikon institutin e "papërgjegjshmërisë për shkak të gjendjes mendore", ku në paragrafin e parë të këtij neni parashikohet papërgjegjshmëria e plotë, ndërsa në paragrafin e dytë parashikohet ulja e ekuilibrit mendor, e cila nuk e përjashton personin nga përgjegjësia penale. Praktika gjyqësore dhe doktrina ka pranuar se, papërgjegjshmëria bazohet në dy kritere: kriterin mjekësor dhe kriterin juridik. Kriteri mjekësor mbështetet në të dhënat shkencore që përftohen nga ekzaminimi psikiatrik. Mund të ndodhë që papërgjegjshmëria ekziston në raport me një fakt të caktuar penal dhe të mungojë në raport me një fakt tjetër; kjo passjell që vërtetimi i papërgjegjshmërisë së autorit në një gjykim (apo procedim) nuk ka efekt detyrues në gjykimin pasardhës ndaj të njëjtit autor.[23] Kriteri juridik është një proces provueshmërie, për të vërtetuar faktin se deri në çfarë shkalle ka ndikuar çrregullimi i shëndetit mendor tek një persona, në aftësinë e tij për të kuptuar rëndësinë e një veprimi të kryer prej tij, dhe çka është më e rëndësishme për të verifikuar këtë gjendje mendore të personit në raport me rrezikshmërinë e tij shoqërore. Ky kriter në thelb lidhet me vetë qëllimin e caktimit të masave mjekësore, që nga njëra anë garantojnë sigurinë publike, por nga ana tjetër synojnë garantimin e kujdesit shëndetësor dhe krijimit të një mjedisi social të përshtatshëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor.[24]

64. Legjislacioni penal shqiptar, masat mjekësore i parashikon në kreun V të pjesës së përgjithshme të KP, ku parashikohen dënimet penale. Pavarësisht se janë vendosur nga ligjvënësi në kreun e dënimeve, masat mjekësore kanë për qëllim të neutralizojnë rrezikshmërinë shoqërore për një kategori të caktuar subjektesh, për të rritur mbrojtjen e shoqërisë nëpërmjet parandalimit të rrezikut të recidivizmit të personit të papërgjegjshëm, autor i veprës penale. Kolegji evidenton se, duke krahasuar "dënimin" me "masën mjekësore", kuptohet edhe dallimi ndërmjet themelit të zbatimit të këtyre instituteve. Kështu, ndërkohë që dënimi është pasojë e një gjykimi të provueshmërisë së shkeljes së ligjit, masa mjekësore rrjedh nga gjykimi i rrezikshmërisë shoqërore, jo i përgjegjshmërisë dhe i mundësisë për recidivizëm të ardhshëm. Nga kjo rrjedhin dy konkluzione: së pari, ndërsa dënimi përcaktohet në bazë të rëndësisë së faktit, kohëzgjatja e masës mjekësore është logjikisht e papërcaktuar, sepse lidhet me ecurinë e rrezikshmërisë; kështu që nevoja për masën mjekësore pushon vetëm kur mungon rrezikshmëria shoqërore; së dyti, nëse dënimi u caktohet personave të përgjegjshëm dhe me përgjegjësi të pjesshme, masa mjekësore është e zbatueshme vetëm për personat që nuk mund të dënohen, kur janë të rrezikshëm dhe caktohet ndaj tyre në mënyrë ekskluzive. Neutralizimi dhe trajtimi i personit të papërgjegjshëm autor të veprës penale ka vend dhe intensitet të ndryshëm, sipas tipologjisë së masës mjekësore. Kodi Penal, në nenin 46 të tij, parashikon masat mjekësore personale që presupozojnë rrezikshmërinë e autorit (të pandehurit) dhe si të tilla janë "Mjekimi i detyruar ambulator" dhe "Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor". Masa mjekësore "Mjekimi i detyruar ambulator" është një lloj i trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri dhe paraqet masë më të lehtë për autorin e veprës penale (në raport me mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor), sepse kjo masë nuk e izolon atë nga rrethi

[22] Neni 17 paragrafi I, i Kodit Penal "Papërgjegjshmëria për shkak të gjendjes mendore": *"Nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës penale vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet ose mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale."*.

[23] Vendim datë 18.12.1996, seksioni IV, Gjykata e Kasacionit Itali.

[24] Ky qëllim përputhet me atë të ligjit për shëndetin mendor, që zbatohet në rastet e personave që kanë çrregullime të shëndeti mendor, por nuk kanë kryer një vepër penale.

i caktuar shoqëror apo ambienti familjar, për shkak se vepra penale e realizuar nga ana e personit të papërgjegjshëm paraqet një shkallë më të vogël të rrezikshmërisë. Si pasojë e kësaj, mundësia e lënies së lirë të autorit dhe shmangia e ndarjes së tij nga rrethi familjar, do të ndikojë në risocializimin dhe riintegrimin e tij sërish në shoqëri.

65. Kodi Penal parashikon si shkak për përjashtimin e personit nga përgjegjësia penale "turbullimin psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale". Si rrethana të cilat ndikojnë në shkaktimin e papërgjegjshmërisë së autorit të veprës penale, por pa u kufizuar, janë çrregullimet e shëndetit mendor, të cilat mund të jenë të përhershme apo të përkohshme. Ligji për shëndetin mendor, i përditësuar[25], përkufizon çrregullimet e shëndetit mendor si një çrregullim thelbësor i mendimit, perceptimit, orientimit ose kujtesës, që dëmtojnë sjelljen, gjykimin, kapacitetin për të njohur realitetin ose aftësinë e personit për të përmbushur kërkesat e jetës, çka e bën atë mendërisht të sëmurë, ose është prapambetja mendore, kur shoqërohet me sjellje agresive patologjike ose seriozisht të papërgjegjshme. Në interpretim të nenit 46 të KPP dhe neneve 17 e 46 të KP, masat mjekësore u caktohen autorëve të veprave penale, të cilët janë të paaftë për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të tyre, si pasojë e turbullimit psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tyre mendor, që i shpie këta të fundit në gjendje të papërgjegjshme. Kolegji thekson se është me rëndësi të përcaktohen nëse si pasojë e këtij turbullimi apo çrregullimi psikik ose neuropsikik, është prishur tërësisht ekuilibri mendor apo vetëm është ulur. Në këtë rast të fundit, personi është i përgjegjshëm penalisht, por kjo rrethanë do të mbahet në konsideratë në caktimin e dënimit (paragrafi i dytë, i nenit 17 të KP). Në këtë aspekt, Kolegji sjell në vëmendje se, "turbullimi psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht apo ulur ekuilibrin mendor", nuk është gjendje, e cila mund të zgjidhet nga organet e drejtësisë, sepse këta të fundit nuk janë të kualifikuar për të bërë konstatimin e papërgjegjshmërisë së individit ndaj të cilit zhvillohet procedimi penal, në lidhje me një fakt konkret. Për këtë arsye, caktimi i një eksperti (ekspert psikiatër), sipas parashikimeve në KPP dhe mendimi i tij janë thelbësor.

66. Për t'u vlerësuar domosdoshmëria e caktimit të këtyre masave ndaj personave të papërgjegjshëm, një rol të rëndësishëm ka mendimi i ekspertit psikiatër në çdo procedim penal që zhvillohet ndaj personit të dyshuar të papërgjegjshëm dhe që i atribuohet kryerja e veprës penale. Kjo, për arsye se ekzistojnë shumë raste që autori i veprës penale ka funksion (funksionim) të pjesshëm të sistemit nervor dhe si rezultat i kësaj ai kryen vepër penale. Prandaj, Kolegji thekson se është e nevojshme të konstatohet nëse i njëjti person në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë ose jo i përgjegjshëm për veprimin ose mosveprimin e tij, në mënyrë që sanksioni penal i caktuar nga ana e gjykatës që e gjykon çështjen, të jetë në përputhje me ligjin, si dhe njëherazi të vlerësohet nga gjykatat më të larta si vendim i drejtë dhe i bazuar në dispozita ligjore. Për këtë arsye, në KP, ekziston edhe nocioni, i cili mund të përkufizohet si "ulje e ekuilibrit mendor", thënë ndryshe "zvogëlim i aftësisë mendore". Sipas paragrafit të dytë, të nenit 17 të KP, personi i cili ka kryer vepër penale konsiderohet se ka "aftësi të zvogëluar mendore" nëse në kohën e kryerjes së veprës penale vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik, që ka ulur ekuilibrin e tij mendor për të kuptuar dhe kontrolluar plotësisht veprimet apo mosveprimet e tij. Në këtë rast, personi, ekuilibri mendor i të cilit ka qenë "i ulur" dhe jo "i prishur tërësisht" (parag. 1, i nenit 17 të KP) konsiderohet penalisht përgjegjës, por kjo rrethanë mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e masës dhe llojit të dënimit.

67. Nisur nga sa më sipër, Kolegji vlerëson të ritheksojë rëndësinë e kryerjes së ekspertimit psikiatrik-ligjor për çdo procedim penal që zhvillohet ndaj një personi të dyshuar, i cili pretendon se ka qenë apo është i papërgjegjshëm në kohën e kryerjes së veprës penale. Nisur nga çështja konkrete ku është parashtruar mosmarrëveshja për kompetencë, Kolegji vlerëson se duhet vënë në dukje se, vërtetimi i papërgjegjshmërisë së autorit në një gjykim (apo procedim) nuk ka efekt detyrues në gjykimin pasardhës ndaj të njëjtit autor që më vonë ka kryer një vepër tjetër penale, përderisa ekziston mundësia që çrregullimi i shëndetit mendor të jetë i përkohshëm. Gjithashtu, për shkak të rëndësisë që

[25] Ligji nr. 44/2012, i ndryshuar me ligjin nr. 20/2021.

ka konstatimi i ekspertit lidhur me gjendjen psikike të të pandehurit në momentin e kryerjes së veprës penale, gjen zbatim mbrojtja e detyrueshme (në rast se i pandehuri nuk ka mbrojtës të zgjedhur). Neni 49/1, shkronja "c" e KPP parashikon: "*1. Organi procedues i siguron menjëherë një mbrojtës të paguar nga shteti të pandehurit që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose ka mbetur pa të kur: … c) është me aftësi të kufizuara, që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes"*, dispozitë që garanton maksimalisht të drejtat e personit që i është atribuuar kryerja e veprës penale gjatë të gjithë procedimit penal, që mund të finalizohet me caktimin e një mase mjekësore ndaj tij për një kohë të papër-caktuar.

68. Caktimi i masave mjekësore duhet paraprirë nga një proces shumë i kujdesshëm, ku gjyqtari që do shqyrtojë çështjen në themel, duhet në radhë të parë të vërtetojë se fakti penal ka ndodhur/ekziston dhe është kryer pikërisht nga personi për të cilin kërkohet caktimi i masës mjekësore. Në vijim, objekt verifikimi do të jetë vërtetimi i rrezikshmërisë shoqërore të autorit të veprës penale, kjo e lidhur ngushtësisht me llojin e masës mjekësore që do të caktohet dhe mënyrën se si do të trajtohet ky person në kuadër të përkujdesjes shëndetësore. Ndonëse masat mjekësore kanë natyrë parandaluese, duke qenë se passjellin pasoja në lirinë e personit, duhet të mbështeten jo vetëm në "prezumimin" e rrezikshmërisë shoqërore të autorit, por edhe në vërtetimin e elementit garantues objektiv të sipërpërmendur. Kjo për arsye se rrezikshmëria shoqërore, duke qenë një element i papërkufizuar në KP, nuk duhet të shihet vetëm si "rrezik apo frikë për recidivizëm të ardhshëm", por të jetë manifestuar tashmë nga sjellje treguese të rrezikshmërisë shoqërore, sikurse është kryerja e një vepre penale. KPP nga ana tjetër, nuk përcakton mënyrën se si duhet të vlerësohet rrezikshmëria shoqërore e personit të papërgjegjshëm. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se gjyqtari mund t'i referohet kritereve të përcaktuara në nenin 47, paragrafi i dytë i KP, për aq sa ato janë të zbatueshme në rastin konkret. Kjo do të thotë se, në vlerësimin për ekzistencën e rrezikshmërisë shoqërore dhe zgjedhjen e masës mjekësore më të përshtatshme për personin e papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore, mund të mbahet në konsideratë rrezikshmëria e veprës penale: i. nga natyra, lloji, mjeti, objekti, koha, vendi dhe çdo mënyrë tjetër e veprimit; ii. pasoja e ardhur ose rreziku para të cilit është gjendur personi i dëmtuar apo i sulmuar; iii. intensiteti i veprimit të kryer. Gjyqtari duhet të ketë parasysh edhe rrezikshmërinë e personit referuar gjendjes së tij familjare, sociale, individuale, motivet dhe arsyet që kanë nxitur një sjellje të tillë prej tij, si dhe parashikueshmërinë e këtyre veprimeve apo sjelljeve në të ardhmen. Në sintezë, duke pasur parasysh rrethanat e kryerjes së faktit penal, motivin e kryerjes së veprës penale, autorin dhe cilësitë vetjake të tij, gjykata cakton masën mjekësore jo për atë çfarë ka bërë personi si ndëshkim, por me qëllim për ta shëruar autorin e veprës penale ose eventualisht për të neutralizuar rrezikun e kryerjes së veprave penale të tjera që do mund të kryente i njëjti, nëse do lihej në liri dhe pa mbikëqyrje dhe përkujdesje shëndetësore. Masat mjekësore, në thelb janë masa të mjekimit, të ruajtjes dhe mbrojtjes së kësaj kategorie të autorëve të veprave penale, si dhe mbrojtjes së shoqërisë nga rreziku i mundësisë së kryerjes së veprave penale të tjera.

69. Kolegji evidenton gjithashtu se që të ekzistojë rrezikshmëria duhet që ajo të jetë: *i. konkrete,* domethënë të ekzistojë efektivisht në lidhje me faktin penal konkret, që legjitimon caktimin e masës mjekësore ndaj personit. Pikërisht për një arsye të tillë, aftësia e personit për të kuptuar rëndësinë e një veprimi të kryer dhe për ta dëshiruar atë, duhet të qartësohet në raport me kryerjen e çdo vepre penale, e si rrjedhojë nuk mund të konsiderohet se mungon, duke u bazuar vetëm në një përjashtim nga përgjegjësia penale e të njëjtit person për shkak të papërgjegjshmërisë mendore të konstatuar në një procedim tjetër.[26] Rrezikshmëria duhet të jetë edhe *ii. aktuale* , e qëndrueshme, pra në momentin e aplikimit dhe ekzekutimit të vetë masës[27]. GJEDNJ-ja në çështjen *Ilnseher kundër Gjermanisë*[28], ka elaboruar tre kushte minimale që duhet të merren parasysh në caktimin e masave mjekësore, e konkretisht: 1. duhet të tregohet në mënyrë të besueshme se personi është me mendje jo të shëndoshë; 2. çrregullimi mendor duhet të jetë i një

[26] Qëndrim ky i mbajtur dhe në jurisprudencën e Gjykatës së Kasacionit të Italisë në vendimin nr. 21826/2014.

[27] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Italisë, vendim nr. 139/1982, aksesuar në https://www.cortecostituzionale.it/.

[28] GJEDNJ, Çështja Ilnseher kundër Gjermanisë, aplikimi nr. 10211/12 dhe 27505/14, datë 4.12.2018.

lloji ose shkalle që kërkon izolim të detyrueshëm; 3. vlefshmëria e izolimit të vazhdueshëm varet nga vazhdimësia e një çrregullimi të tillë.

70. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se "gjyqtari që gjykon çështjen në themel", i cili sipas ligjit ka të drejtën për të caktuar masë mjekësore në përputhje me nenet 46 të KP dhe 46 të KPP ndaj personave të papërgjegjshëm për shkak të gjendjes mendore që i atribuohet kryerja e një vepre penale, disponon me caktimin e masës, vetëm nëse nga çmuarja e provave, krijon bindjen e brendshme "*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm"* se në procesin penal u arrit të provohet: i. nga pikëpamja materiale është cenuar një marrëdhënie shoqërore e mbrojtur posaçërisht nga ligji penal, ekzistenca e faktit penal; ii. cenimi ka ardhur si pasojë e drejtpërdrejtë e një veprimi ose mosveprimi të kundërligjshëm, nga personi që i atribuohet kryerja e veprës penale, kryerja e veprës penale nga ky person; iii. personi autor i veprës penale në kohën e kryerjes së saj, vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se po kryen një vepër penale, pra personi duhet të jetë i papërgjegjshëm para ligjit; (iv) personi paraqet rrezikshmëri shoqërore dhe pa trajtimin mjekësor të pavullnetshëm ai rrezikon jetën, shëndetin ose sigurinë e vetes ose të të tjerëve, element ky që rrjedh nga qëllimi parandalues që ndjek caktimi i masave mjekësore sipas nenit 46 të KP, por edhe nga qëllimi që ndjek çdo kufizim i të drejtave e lirive themelore sipas nenit 27 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë[29]. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari që shqyrton çështjen në themel disponon me vendim përfundimtar për pushimin e çështjes penale dhe caktimin e masës mjekësore në referim të neneve 46 dhe 387 të KPP dhe nenit 46 të KP, vetëm nëse nga vlerësimi dhe çmuarja e provave bindet "tej çdo dyshimi të arsyeshëm", për autorësinë e personit të papërgjegjshëm në kryerjen e veprës penale, si dhe për rrezikshmërinë e tij shoqërore.

71. Në lidhje me sa u parashtrua më sipër, Kolegji arrin në përfundimin njësues se:

Gjykata që shqyrton çështjen në themel, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, disponon me pushimin e çështjes penale, duke u bazuar në nenet 387, pika 1 dhe 328, pika 1, shkronja "ç", të Kodit të Procedurës Penale dhe caktimin e masës mjekësore ndaj personit të papërgjegjshëm që i atribuohet vepra penale, sipas nenit 46 të Kodit Penal, kur vërtetohen: 1. ekzistenca e faktit penal; 2. kryerja e tij nga ky person; 3. papërgjegjshmëria e këtij personi në kohën e kryerjes së veprës penale; 4. rrezikshmëria shoqërore e personit të papërgjegjshëm.

IV. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete:

72. Lidhur me zgjidhjen e konfliktit të kompetencës (funksionale) të ngritur prej gjyqtarit të "seancës paraprake", Kolegji vlerëson se qëndrimi i këtij të fundit është marrë në zbatim të gabuar të nenit 332/dh, shkronja "a" të KPP. Kolegji arrin në këtë përfundim për arsye se "gjyqtari i seancës paraprake" ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes penale në ngarkim të shtetasit Fatmir Mina dhe për pjesën tjetër të kërkesës së prokurorit, "caktimin e masës mjekësore" ndaj këtij personi ka vendosur "dërgimin e çështjes në gjykatën e themelit", pa pasur një kërkesë të organit të akuzës për dërgimin e çështjes në gjyq për caktimin e masës mjekësore, bazuar në nenin 331, pika 1 të KPP, e cila presupozon ushtrimin e ndjekjes penale dhe jo ndërprerjen e saj nëpërmjet pushimit të çështjes.

73. Kolegji vlerëson të pabazuar në ligj edhe qëndrimin e gjyqtarit të "themelit" që ka shpallur moskompetencën e gjykimit të çështjes të caktimit të masës mjekësore, duke e rikthyer atë tek gjyqtari i "seancës paraprake" që është shprehur për pushimin e çështjes penale, me argumentin që e njëjta gjykatë duhet të vendosë për të dy kërkesat e organit të akuzës (pushimin e çështjes penale dhe caktimin e masës mjekësore), për sa kohë sipas

[29] Neni 27 i Kushtetutës së RSH: *"Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj. 2. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme: a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente; b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj; c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj; ç) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent; d) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë; dh) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit. 3. Askujt nuk mund t'i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor.".*

arsyetimit të mësipërm, gjyqtari i "seancës paraprake" është në pamundësi për të realizuar një procedurë të tillë të plotë edhe për caktimin e masës mjekësore. Kolegji e vlerëson të pabazuar në ligj edhe qëndrimin e "gjykatës së themelit" që arsyeton kompetencën funksionale të "gjyqtarit të seancës paraprake" për shqyrtimin e kërkesës për caktimin e masës mjekësore bazuar në kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes penale, sipas parashikimit të paragrafit të dytë, të nenit 329/a të KPP. Kjo dispozitë ligjore parashikon: "*Kur prokurori ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq kërkesa për pushimin e çështjes shqyrtohet bashkërisht me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq*." Kjo për arsye se në rastin konkret nuk rezulton një kërkesë e prokurorit për "dërgimin e çështjes në gjyq", e cila do të bënte të mundur kalimin e procedimit, prej fazës së hetimeve paraprake në seancën paraprake dhe më pas me miratimin e kësaj kërkese prej "gjyqtarit të seancës paraprake" kalimin e çështjes drejt fazës përfundimtare, atë të gjykimit të çështjes në themel.

74. Kolegji e vlerëson vendimmarrjen e gjyqtarit të "seancës paraprake", që ka parashtruar konfliktin e kompetencës para Gjykatës së Lartë për pushimin e çështjes ndaj të hetuarit Fatmir Mina, të "vesuar" prej paligjshmërisë, në kushtet kur kjo vendimmarrje është e mbështetur në një akt ekspertimi psikatriko-ligjor, të kryer për llogari të një procedimi tjetër penal të mëparshëm, pa u verifikuar përgjegjshmëria e të hetuarit Fatmir Mina në kohën e kryerjes së veprave penale, për të cilat gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur pushimin e çështjes penale. Në funksion të zgjidhjes së konfliktit të kompetencës së parashtruar prej "gjyqtarit të seancës paraprake", Kolegji vlerëson se çështja duhet të dërgohet pranë tij me detyrimin që "gjyqtari i seancës paraprake" t'ia kthejë atë prokurorit (në cilësinë e titullarit të ushtrimit të ndjekjes penale) për të bërë të mundur ushtrimin e ndjekjes penale prej tij, nëpërmjet paraqitjes së kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq për caktimin e masës mjekësore. Në rastin në shqyrtim është me rëndësi që të verifikohet për llogari të këtij procedimi penal edhe gjendja shëndetësore mendore e personit nën hetim, duke u verifikuar në raport me këtë fakt penal dhe kohën e kryerjes së tij.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke u bazuar në nenet 91, 438 dhe 441/2 të Kodit Procedurës Penale;

VENDOSI:

1. Dërgimin e akteve të çështjes penale nr. 247 (70110-00919-61-2023) Regjistri Themeltar, datë 31.7.2023, gjyqtarit të seancës paraprake, pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për shqyrtimin e kërkesës për caktimin e masës mjekësore, të parashikuar nga neni 46 i Kodit Penal, ndaj personit për të cilin kërkohet të caktohet masa mjekësore, Fatmir Mina.

2. Ky vendim është njësues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 16.11.2023

Kryesues: Ilir Panda
Anëtarë: Sokol Binaj, Medi Bici, Albana Boksi, Sandër Simoni

VENDIM
Nr. 5, datë 26.2.2024

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar; në kreun I, nenit 22, pika 4, të ligjin nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar", të ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror'", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar 'Sekret shtetëror' në AIDSSH", i ndryshuar, me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, "Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, 'Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar 'Sekret shtetëror' në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e

informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me vendimin nr. 5, datë 26.2.2024, si më poshtë:

1.I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 50, Plan-kombinacioni për takimin e një b.p. me një objekt, 3 (tri) fletë. Dosja daton në vitin 1960. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

2. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 52, Detyrat vjetore orientuese të organeve të zbulimit të kufirit, 14 (katërmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

3. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 53, Raport vjetor mbi veprimtarinë e armikut në repartet e kufirit, 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

4. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 54, Relacion mbi një diversion të kryer nga zbulimi grek, 2 (dy) fletë. Dosja daton në vitin 1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

5. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 55, Relacione mbi arratisjen e një ushtari dhe një nënoficeri në sektorin e Peshkopisë, 6 (gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

6. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 57, Buletine mujore me parulla të ndryshme me karakter armiqësor, 34 (tridhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitin 1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

7. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 58, Relacion mbi asgjësimin e një grupi thyesish në sektorin Radomir Pleshtar, 4 (katër) fletë. Dosja daton në vitin 1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

8. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 59, Lista e katundeve dhe objekteve në brezin dhe zonën kufitare, 53 (pesëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitin 1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

9. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 63, Raporte mbi punën e jashtme, mbi agjenturën, veprimtarinë në brezin kufitar, detyrat vjetore etj. 102 (njëqind e dy) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

10. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 64, Buletinet mujore të Degës së Zbulimit të Kufirit dërguar Sekretariatit të MPB-së, 33 (tridhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

11. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 65, Plan perspektiv i kufirit për punën e jashtme, 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

12. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 66, Raport vjetor mbi analizën e punës së organeve të kundërzbulimit të kufirit, relacion mbi zbatimin e direktivës së MPB-së së datës 23.6.1960, 22 (njëzet e dy) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

13. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 68, Buletine mujore me parulla të ndryshme armiqësore, 2 (dy) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

14. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 69, Relacion mbi zbatimin e detyrave që ngre direktiva e ministrit dhe plani grafik i ndihmës e kontrollit nga dega në reparte, 10 (dhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

15. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 70, Relacion mbi arratisjen e ushtar Xh.G., në repartin e Leskovikut, 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

16. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 72, Procesverbale të asgjësimit të dokumenteve, inventari i urdhrave dhe udhëzimeve të asgjësuara, 25 (njëzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

17. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 73, Raporti vjetor dhe detyrat për vitin, 60

(gjashtëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1963. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

18. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 74, Buletine mujore të degës dërguar Sekretariatit të MPB-së, 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1963. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

19. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 76, Temë mbi veprimtarinë e organeve tona dhe veprimtaria armiqësore brenda dhe jashtë, 47 (dyzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1964. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

20. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 77, Raport 6-mujor mbi veprimtarinë e armikut në brezin dhe zonën kufitare, 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1964. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

21. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 78, Buletinet mujore të Degës së Zbulimit të Kufirit dërguar Sekretariatit të MPB-së, 46 (dyzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1964. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

22. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 79, Procesverbal mbi dorëzimin e materialeve të kategorisë "A" për ruajtje dhe inventarët përkatës, 7 (shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1965. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

23. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 80, Raporti dhe detyrat vjetore mbi aktivitetin e organeve të zbulimit të kufirit, 48 (dyzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1965. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

24. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 81, Buletine mujore të Degës së Kundërzbulimit dërguar Sekretariatit të MPB-së, 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1965. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

25. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 83, Detyrat funksionale të Degës së 3-të të Kundërzbulimit të Kufirit të Drejtorisë së Parë, 9 (nëntë) fletë Dosja daton në vitin 1972. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

26. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 84, Raport vjetor i degës, 51 (pesëdhjetë e një) fletë, Dosja daton në vitin 1972. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

27. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 85, Temë mbi kuptimin e detyrave funksionale të seksioneve të degës, 32 (tridhjetë e dy) fletë, Dosja daton në vitin 1972. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

28. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 86, Disa porosi të ministrit për degën, 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1972. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

29. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 87, Përgjithësim mbi bashkëpunimin e punëtorit operativ me komandat e kufirit, 6 (gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1972. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

30. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 88, Detyrat funksionale të punëtorëve operativë të degës, miratuar nga zëvendësministri, 8 (tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1973. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

31. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 89, Raporti vjetori i degës, 54 (pesëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitin 1973. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

32. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 93, Raporti vjetor i degës, 43 (dyzet e tre) fletë. Dosja daton në vitin 1974. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

33. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 95, Tema mbi kuptimin e zbatimin e detyrës funksionale, 22 (njëzet e dy) fletë. Dosja daton në vitin 1974. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

34. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Kundërzbulimi i Kufirit, kutia 36, dosje nr. 96, informacione mbi kapjen e dy motobarkave greke, 3 (tri) fletë. Dosja daton në vitin 1974. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

35. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Bandat, kutia 42, dosje nr. 137, Pasqyra statistikore për vitin 1960,

5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1960. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

36. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Bandat, kutia 42, dosje nr. 141, Deponimet e H.Sh., ish-desant i riatdhesuar më 1960, 60 (gjashtëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1960. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

37. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3, MES-i, kutia 44, dosje nr. 19, Qarkore e MPB-së drejtuar gjithë organeve të Sigurimit e të Policisë mbi veprimtarinë armiqësore në ekonomi në qarkun e Elbasanit, 3 (tri) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

38. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3, MES-i, kutia 44, dosje nr. 27, Relacion mbi disa pakënaqësi të punonjësve, si dhe mbi pakënaqësitë e fshatarëve të bregdetit që kultivojnë ullinj etj. 25 (njëzet e pesë). Dosja daton në vitin 1957. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

39. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 28, Relacione për disa veprime të gabuara në drejtim të kolektivizimit të bujqësisë, luftën e klasave në fshat etj. 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1957. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

40. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 29, Relacione mbi të metat e dobësitë që ekzistojnë në minierat tona, 9 (nëntë) fletë. Dosja daton në vitin 1957. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

41. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 30, Relacion mbi disa rroga personale të padrejta në Bankën e Shtetit, 2 (dy) fletë. Dosja daton në vitin 1957. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

42. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 31, informacion mbi të meta e dobësi në sektorin e minierave, ndërmarrjet mekanike, 35 (tridhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1957. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

43. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 32, informacion mbi të meta e dobësi në ndërtimin e veprave ujitëse, hidrocentralin "Enver", 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1957. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

44. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 33, informacion mbi të meta e dobësi në ndërmarrjen e projektit, 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1957. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

45. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 34, informacion mbi të meta e dobësi në transportin detar e automobilistik, 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1957. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

46. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 35, informacion mbi të meta e dobësi në prodhimin e karburanteve, 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1957. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

47. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 36, informacion mbi të meta e dobësi në importimin e makinerive dhe depot për vendosjen e tyre, 7 (shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1957. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

48. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 38, Udhëzim dërguar organeve të Sigurimit dhe Kufirit në rrethe mbi sëmundjen "Afta episodike" në gjënë e gjallë që po shfaqej në Greqi, 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

49. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 40, Relacione mbi keqtrajtimin e punëtorëve, si dhe pakënaqësitë e tyre në disa objekte ekonomike, 20 (njëzet) fletë. Dosja daton në vitin 1958. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

50. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 41, Relacion mbi zjarrin e shkaktuar në Kombinatin e Naftës në Qytetin Stalin, si dhe mbi rrezikun e zjarrit në rafinerinë e Cërrikut, 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1958. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

51. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 42, informacion mbi disa të meta në ndërmarrjet tregtare, 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1958. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

52. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 43, informacione mbi disa të meta në bujqësi, veprimtaria e kulakëve etj. 13 (trembëdhjetë) fletë Dosja daton në vitin 1958. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

53. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 45, informacion mbi disa mashtrime dhe raportime fiktive të ndërmarrjeve, 18

(tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1958. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

54. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 47, Korrespondencë e degës mbi veprimet e padrejta të parkut "Ibrahim Rexha", 9 (nëntë) fletë. Dosja daton në vitin 1958. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

55. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 48, Korrespondence e degës me Durrësin e Tiranën për disa t; meta e dobësi në sektorin e komunikacionit, 9 (nëntë) fletë. Dosja daton në vitin 1958. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

56. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 49, Korrespondencë e plane masash dërguar DPB Durrës për disa dëmtime në portin e atyshëm, 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1958. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

57. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 50, Korrespondencë me Krujën për avaritë në bonifikimin e Thumanës, 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1958. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

58. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 52, Relacion mbi djegien e stabilimentit të Sharrave të Kryeziut në Pukë, 46 (dyzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1959-1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

59. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 54, informacion për zjarrin e rënë në kombinatin e Drurit "Nako Spiru" Elbasan, mbi deficitet e ndërmarrjes se konsumit etj. 3 (tri) fletë. Dosja daton në vitin 1959-1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

60. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 56, Korrespondencë e degës 3 me Elbasanin për diversion në hekurudhë, 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1959-1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

61. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 57. Korrespondencë me DPB Sarandë mbi dëmtimet e kanalit kryesor në lumin Pavël, 3 (tri) fletë. Dosja daton në vitin 1959-1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

62. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 58. Korrespondencë me DPB Shkodër mbi makinat që kalojnë në ura me ngarkesë dhe sigurimi i tyre, 2 (dy) fletë. Dosja daton në vitin 1959-1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

63. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 59, Raporti vjetor dhe detyrat për vitin 1961, 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1959-1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

64. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 44, dosje nr. 61. Relacione e informacione dërguar udhëheqjes mbi sabotimet blegtorale, shpërdorimet në ullinj etj. 20 (njëzet) fletë. Dosja daton në vitin 1959-1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

65. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 63. Relacion drejtuar udhëheqjes mbi çrregullimet në makineritë e pajisjet teknike, 10 (dhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1959-1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

66. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 64. informacion dërguar organeve të pushtetit mbi dëmtimet në ndërtim, 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1959-1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

67. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 65. Mbi gjendjen e depove të bereqetit dhe rezervat, 6 (gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1959-1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

68. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 66. Mbi çrregullimet në ndërmarrjet e ndryshme industriale, 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1959-1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

69. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 67. informacione mbi disa mungesa në frigoriferin e madh të Tiranës, 3 (tri) fletë. Dosja daton në vitin 1959-1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

70. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 68. informacione me degët Lushnjë, Durrës, Fier, mbi mungesat e dëmtimet në kontejnerin e ndërtimit dhe në degët e rezervave, 8 (tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1959-1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

71. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 69. Mbi abuzimet në sektorin e transportit automobilistik e hekurudhës në Berat, Elbasan e Korçë, 14 (katërmbëdhjetë) fletë. Dosja

daton në vitin 1959-1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

72. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 70. Korrespondencë me DPB Durrës mbi mungesat në portin e Durrësit, 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1959-1961. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

73. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 72. Raport vjetor për krime në ekonomi, 24 fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

74. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 73. Raporte informative mbi mungesat e dëmtimet në ekonominë socialiste, 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

75. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 75. Relacion dërguar Prokurorisë së Përgjithshme mbi grupin e vjedhësve së stabilimentin e sharrave në Pukë, 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

76. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 76. Relacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit mbi mungesa e dëmtime në sektorin e tregtisë, 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

77. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 77. Relacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit mbi dëmtimet në industrinë ushqimore, 8 (tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

78. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 78. Relacion mbi zbatimin e direktivës së ministrit të vitit 1960 mbi përpunimet në qendër e periferi, 9 (nëntë) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

79. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 79. Relacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit për dëmtimet në miniera, 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

80. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 80. Relacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit për ruajtjen e sekretit, 3 (tri) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

81. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 81. Relacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit mbi ruajtjen e pasurisë socialiste, si dhe trajtimin e mallrave të ekonomisë popullore, 20 (njëzet) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

82. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 82. Relacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit mbi dëmtime e mungesa në sektorin e bujqësisë, 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

83. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 83. Relacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit mbi pengesat në prodhimin e gurkalit, 3 (tri) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

84. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 84. Relacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit mbi mungesa e dëmtime në ekonominë komunale, 7 (shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

85. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 85. Relacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit mbi dëmtime në ndërmarrjet e përpunimit të drurit, 4 (katër) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

86. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 86. Relacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit mbi dëmtime në sektorin e ndërtimit, 31 (tridhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

87. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 87. Relacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit për dëmtimin e rezervave dhe të ndërmarrjeve të grumbullimit, 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

88. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 88. informacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit mbi disa mungesa të furnizimit të fshatarësisë me drithë, pakënaqësi të punëtorëve për pagat, 10 (dhjetë) fletë.

Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

89. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 88/1. informacion mbi disa të dhëna ekonomike industriale e të naftës të Greqisë, tepër sekret, vetëm origjinal, 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1962. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

90. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 89. Informacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit mbi dëmtime në tregti, 4 (katër) fletë. Dosja daton në vitin 1963. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

91. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 90. informacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit mbi dëmtime në gjeologji–miniera, 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1963. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

92. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 92. Relacion dërguar Komisionit të Planit të Shtetit mbi masat e dobësitë që janë bërë pengesë për realizimin e planit të shtetit në ndërmarrje të ndryshme ekonomike, 14 (katërmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1963. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

93. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 93. Relacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit në sektorin e ndërtimit, 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1963. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

94. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 94. Relacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit mbi dëmtime në sektorin e bujqësisë, 14 (katërmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1963. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

95. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 95. Relacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit mbi dëmtime në drejtim të popullsisë me energji elektrike, rezervave të shtetit, 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1963. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

96. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 96. Relacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit mbi dëmtime në drejtim të sistemit energjetik, 6 (gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1963. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

97. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 97. Relacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit mbi disa probleme të tregtisë së jashtme, të transportit tokësor e detar, 24 (njëzet e katër) fletë. Dosja daton në vitin 1963. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

98. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 98. Relacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së e të shtetit mbi dëmtime në fabrikën e tullave e të çimentos, në sistemin e ujësjellësve, 8 (tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1963. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

99. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 101. Relacion mbi dëmin e shkaktuar nga zjarret në tregti, 2 (dy) fletë. Dosja daton në vitin 1970. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

100. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 102. Detyrat funksionale të MES-it, 3 (tri) fletë. Dosja daton në vitin 1970. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

101. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 103. Relacione për disa shpërdorime në hidrocentralin "Mao Ce Dun" në Vaun e Dejës, 3 (tri) fletë. Dosja daton në vitin 1970. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

102. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-i, kutia 45, dosje nr. 104. R Relacion për dëmtimet e gjedhëve në NBSH Maliq dhe Lushnjë, 4 (katër) fletë. Dosja daton në vitin 1970. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

103. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-I (kthyer Dega 7), kutia 45, dosje nr. 105. Raport i Degës 7 gjatë vitit 1971, 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1971. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

104. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-I (kthyer Dega 7), kutia 45, dosje nr. 105/1. Raporti vjetor i Degës të 7-të, sekret, vetëm origjinal, 20 (njëzet) fletë. Dosja daton në vitin 1971. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

105. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-I (kthyer Dega 7), kutia 45, dosje nr. 106. Raport vjetor i Degës 7-të, 25 (njëzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1973. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

106. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-I (kthyer Dega 7), kutia 45, dosje nr. 108. Relacion mbi zjarret e rëna në Tiranë dhe në Qytetin Stalin, 9 (nëntë) fletë. Dosja daton në vitin 1972. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

107. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-I (kthyer Dega 7), kutia 45, dosje nr. 109. Përgjithësim mbi grupet e Gurrëzës në Krujë dhe Mallkoçit në Vlorë, 9 (nëntë) fletë. Dosja daton në vitin 1972. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

108. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-I (kthyer Dega 7), kutia 45, dosje nr. 110. Përgjithësim mbi vjedhjet në ndërmarrjen ekonomike të Fierit, 7 (shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1973. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

109. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-I (kthyer Dega 7), kutia 45, dosje nr. 110/1. Raporti vjetori i degës 7, 14 (katërmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1973. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

110. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-I (kthyer Dega 7), kutia 45, dosje nr. 110/4. Disa përfundime mbi përcaktimin e objekteve të rëndësisë së veçantë, sekret, vetëm origjinal, 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1973. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

111. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-I (kthyer Dega 7), kutia 45, dosje nr. 110/5. Përgjithësim mbi ndjekjen e goditjen e dy grupeve në Vlorë e Leskovik, 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1973. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

112. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-I (kthyer Dega 7), kutia 45, dosje nr. 111. Përgjithësim mbi zbulimin dhe demaskimin e një akti diversionist në Kombinatin e Tekstileve "Mao Ce Dun", Berat, 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1974. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

113. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-I (kthyer Dega 7), kutia 45, dosje nr. 115. Informacion drejtuar udhëheqjes së PPSH-së mbi shpërdorimet në bujqësi, sekret, vetëm origjinal, 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1974. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

114. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-I (kthyer Dega 7), kutia 45, dosje nr. 116. informacion drejtuar udhëheqjes së PPSH-së mbi shpërdorime në blegtori, 6 (gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1974. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

115. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 3 MES-I (kthyer Dega 7), kutia 45, dosje nr. 117. Plani vjetor i Degës 7 dhe protokolli i mbledhjes, 30 (tridhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1974. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

116. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 4, kutia 46, dosje nr. 41. Pasqyra statistikore të përpunimeve 2A dhe 2B të Sigurimit në vitin 1954, 8 (tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1954. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Sekret".

117. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 4, kutia 46, dosje nr. 42. Pasqyra statistikore e agjenturës të Sigurimit për vitin 1954, 1 (një) fletë. Dosja daton në vitin 1954. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

118. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 4, kutia 46, dosje nr. 47. instruksion mbi organizimin e punës agjenturiale në burgje e kampe, 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

119. Arkiva e Autoritetit, fondi nr. 4, Dega 4, kutia 46, dosje nr. 48. Temë mbi evidencën operative të Sigurimit të Shtetit, 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1955. Niveli i klasifikimit i dosjes është "Tepër sekret".

